

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration Intérimaire  
des Nations Unies  
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**T R A N S K R I P T**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,**  
**E MBAJTUR MË 23 JANAR 2003**

**T R A N S K R I P T**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,**  
**ODRŽANE 23. 01. 2003.GOD.**

---

**JANAR - JANUAR**  
**2003**



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i gjendjes së sigurisë në Kosovë
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (2002/11)
5. Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë për emërimin a një anëtari në Komisionin për Peticione dhe Kërkesa Publike
6. Parashtrimi i pyetjeve

---

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

"Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrës të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë para kohës kur duhet përgjigjur në to".  
(Rregulla 19.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Усвајање дневног реда
2. Записник од претходне седнице
3. Разматрање стања безбедности на Косово
4. Друго разматрање Нацрта закона о Менаџирању Јавних Финансијама и Одговорностима (2002/11)

# TRANSKRIPT

## NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 23 JANAR 2003

Seanca filloi punën në orën 10.

**SEANCËN E KRYESËI AKADEMIK NEXHAT DACI, kryetar i Kuvendit të Kosovës.**

**BASHKËKRYESUESE NAFIJE GASH, anëtare e Kryesisë së Kuvendit.**

### KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur në Seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës. Shpresoj se rendin e ditës me kohë e keni marrë të gjithë ashtu si është përcaktuar më parë dhe ndoshta nuk keni ndonjë vërejtje në të.

Më lejoni që pasi është në rend të ditës Shqyrtimi i gjendjes së sigurisë në Kosovë, t'ju them se për herë të parë, pas më tepër se një vit, në seancë plenare, ndihem tepër i sigurt sepse e kam në ndihmesë një femër, për herë të parë në Kryesi të punës të Parlamentit. Nga ana tjetër, ju patë që unë hyra në seancën plenare në shoqëri me përgjegjës për drejtësi e siguri Caddy dhe komisionerin Feller dhe me këtë rast iu dëshiroj mirëseardhje dhe punë të mbarë me ne në Parlament.

**(Duartrokitje)**

**Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar.** Besoj se kemi adaptuar një procedurë të mirëfillt, ata që kanë ndonjë vërejtje në procesverbal, si zakonisht, mund ta bëjnë me shkrim, por nëse ndokush ndien të nevojshme, mund edhe gojarisht ta parashtrojë. Ju falemnderit.

Kalojmë në çështjen kryesore të rendit të ditës – **Shqyrtimi i gjendjes së sigurisë në Kosovë.**

Kolegë deputetë, është një marrëveshje interne për shkak të kohës që kanë në dispozicion përgjegjësit e shtyllave kryesore për siguri të UNMIK-ut, për afërsisht do të shqyrtohet në praninë e tyre afër një orë, mund të ketë ndonjë minut më shumë apo më pak. Do të raportojnë sipas radhës zoti Kristian Caddy, që është përgjegjës i Shtyllës për drejtësi dhe siguri dhe komisioneri Stefan Feller, pastaj deputetët që kanë ndonjë pyetje, mund t'ua adresojnë këtyre. Do të ishte e preferueshme edhe sipas Rregullores sonë në fuqi që të parët t'i bëjnë shefat e grupeve parlamentare, por kjo nuk do të thotë se ata kanë obligim për këtë dhe as që përjashton deputetët tjerë, sepse në seancë plenare jemi të gjithë të barabartë. Prandaj ftoj për fjalë zotin Kristian Caddy.



## **Report on the Security Situation in Kosovo: October 2002 to January 2003**

### **Introduction**

Mr Chairman, I would like to express my thanks to you for having invited me to present this security situation report. I have asked the Police Commissioner, Stefan Feller, to join me in this presentation. I am happy to share this information and our progress with the elected representatives of Kosovo. In my presentation, I would like to cover five main points:

1. A brief summary of the security situation;
2. The progress towards establishing multi-ethnicity in police;
3. The progress towards establishing multi-ethnicity in the judiciary;
4. An increase in "mafia" type crime; and
5. The progress in the fight against organized crime and corruption

### **1. The Security Situation**

We now have the crime statistics for 2002. They show progress towards a stabilization and normalization of the security situation. This is evidenced by the drop in criminal offences, which is down by 22% in 2002 compared to 2001:

- Murder rate in 2002 is down by 61% compared to 2001;
- The number of kidnappings is down by 51%;
- The number of robberies is down by 10%;
- The number of interethnic crime is decreasing; and
- The crime clearance rate is at a very encouraging 53%, which is higher than in many western countries.

In my view, one of the main reasons for this progress is the growing numbers, and increased presence, of the Kosovo Police Service in the streets: (5200 in January 2003, compared to 4300 in December 2001), and the increasing competence of KPS officers. On 15 November 2002, Police Commissioner, Stefan Feller, handed over control of the Police station in Gracanica to a KPS officer marking the first police station to come under KPS command since the start of UNMIK's mission. And more are going to be handed over in 2003. Another important milestone, of course, has been

the establishment of UNMIK's authority in the Northern part of Kosovo, and the dismantling of the parallel police and justice structures which were functioning there and the establishment of KPS in the North.

## **2. The Establishment of Multi-Ethnicity in Police**

As you know, KPS is a multiethnic police force with 84% Kosovar Albanians, 9% Kosovar Serbs and 7% other ethnicities. UNMIK police, including KPS, are now present throughout Kosovo. More KPS of all ethnicities are being deployed in the North.

Multi-ethnicity in policing is the goal for all parts of Kosovo, and this is equally true for North Mitrovica. The KPS must reflect all the ethnicities of its communities. There is one Police school in Vushtrii through which all KPS officers from all ethnicities must graduate. On 15 January 2003, 10 K-Serbs and 10 K-Albanians began an accelerated eight week class to become instructors within the KPS. On 20 January 2003, 40 K-Serbs, 50 K-Albanians and 10 from other minorities began a twelve week training course. The KPS recruits will train together and the work together as policemen.

## **3. The Establishment of Multi-ethnicity in the Judiciary**

The establishment of a multiethnic judiciary to uphold the rule of law is also essential to the stability and security of a society. With the recent appointments of 13 judges and prosecutors of Kosovo Serb ethnicity, the judicial system in Kosovo is now truly multi-ethnic. We now have a total of 373 in local judiciary:

- 326 judges and 47 prosecutors;
- 336 Albanian judges and prosecutors;
- 17 Serb judges and prosecutors; and
- 20 judges and prosecutors of other minorities

They deal with 100% of the civil cases and 95% of the criminal cases. As multi-ethnicity is realized, we must work on the impartiality of the judiciary. Justice must be neutral. UNMIK has a system in place to monitor and address the performance of the judiciary. Since its inception on 11 May 2001 to 10 January 2003, the Judicial Inspection Unit has conducted 167 investigations and referred a total of 27 cases to the Kosovo Judicial and

Prosecutorial Council for further action. The decisions of the KJPC have resulted in removal from office in 8 cases and reprimands or warnings in 3. In 2003, UNMIK will introduce a common exam which all potential members of the judiciary must pass.

UNMIK is cognizant of the challenges in the justice system. Where we recognize that circumstances undermine the impartiality of the local judiciary, UNMIK has 27 international judges and prosecutors to take up investigations and prosecutions so that justice does not fall through the cracks. IJPs are involved in 87 cases which represent approximately 3-4% of the cases pending before the District and Supreme Courts. These cases involve war crimes, ethnically-motivated crimes, terrorism/extremism, corruption and organized crime.

#### **4. An Increase in "Mafia" type crimes:**

Though we have made progress towards establishing a multi-ethnic police and judiciary and the security situation in Kosovo has stabilized, I am, nevertheless, very concerned about the increase of certain "mafia type crimes: these being the use of bombs and execution style murders. There has also been a rise in crimes with apparent political motivation. Such high-profile crimes have a particularly negative impact on the security situation, by increasing the level of public fear and uncertainty. At least 8 incidents of this type have occurred in the last three months and emphasize the need for effective witness protection.

I refer, of course, to incidents such as the murders in last October of AAK leader Avni Elezaj and Surharke/Suva Reka Municipal Assembly President Uke Bytyki, the murder in November of prominent human rights lawyer Ibish Hoti, the car bomb which exploded in Dardania in December injuring 31 people, and the recent murder of former FARK leader Tahir Zemaj and two of his relatives, and the rocket which was fired last night at Pec/Peja UNMIK Regional Police HQ, which resulted in extensive damages to the building but cause no injuries.

UNMIK is committed to providing adequate protection to all who are threatened. Witnesses will not testify if they are subject to intimidation. We are calling on the international community to help us extend our existing witness programs as a matter of urgency. We will pursue with utmost vigour any case in which a witness or person is targeted for attack. We are

determined that no one should be deterred from coming to the police from fear of retribution, and that the rule of law in Kosovo prevails over the rule of silence. UNMIK strongly condemns intimidation tactics and I assure you that we are committed to making every effort to protect those who are threatened and to dealing justice out to those who intimidate and operate outside the law. However, it must be made clear that UNMIK Police, that is the international civilian police and the Kosovo Police Service, and KFOR are the sole providers of protection in Kosovo. No private militia can be tolerated.

## **5. Progress in fight against Organized Crime and Corruption**

As the security situation has stabilized and inter-ethnic crime has decreased, UNMIK has intensified the fight against organized crime, which gained a foothold during the more chaotic immediate post-war period. In 2002, UNMIK Police made a number of successful seizures of weapons, and drugs another contraband such as cigarettes.

One of the priorities set by the Commissioner and myself is the fight against prostitution and human trafficking. The Trafficking and Prostitution Investigation Unit in UNMIK Police carried out 353 operations in 2002, closing down 61 premises. I hope we shall achieve even more this year. With the establishment of a safe house for victims and witnesses, and the increased activity of the Victim Advocacy and Assistance Unit in the Department of Justice, we aim to make it easier for the particularly vulnerable victims of trafficking to give evidence in safety against gang-leaders and thereby to secure their conviction. Protection of witnesses from the use of intimidation or threats is one of our main concerns.

We have also begun to make significant arrests in corruption cases, such as the recent arrest of officials in the Pristina Municipal Cadastre Agency. We intend to do much more in this field in 2003. We have set up a special anti-fraud unit, the Financial Investigation Unit, which will be initially staffed with 10 experience criminal fraud investigators from the Guardia di Finanza coming from Italy. They have wide experience with mafia. They will have wide powers to investigate the activities of public institutions and publicly funded enterprises, and to carry out criminal investigations where evidence of fraud is discovered. In this area, we rely on the assistance of members of the Kosovo public to come to the police, in confidence if necessary, with any information they may have about corruption in public office.



As we can see from the examples of other countries, the fight against organized crime and corruption is long and slow. In this fight, Kosovo is still at an early stage. But UNMIK has now established the tools to work with and we are committed to engaging the battle fully.

### **Conclusion**

Mr. Chairman, these are the main features of the security situation in Kosovo. We are undoubtedly making progress, due to the very efficient involvement of the Kosovo Police Service and due to the determination of all. It is obvious, and it should be said, that security is a not only the preoccupation of Police and Justice institutions but of every Kosovar. We can achieve the objectives in our fight against organized crime and reach the goal of a peaceful society only with the full support of the entire Kosovo population and their elected officials.

## **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit zoti Caddy për fjalim të detajizuar të strukturës së gjyqësisë dhe të policisë. Ju falemnderit për fjalën shpresëdhënëse se krimi dhe në veçanti ai i organizuar me fakte të gjalla është në rënie e sipër. Ju falemnderit edhe për krijimin e atmosferës optimiste. Zoti Stefan Feller e ka fjalën.



**STEFAN FELLER:**

Mr. Chairman, Members of the Assembly, ladies and gentlemen, it is not only an obligation for me to be here and to report on some further details on the security situation, it is also a pleasure and an honor to do this in this format. I am quite familiar to report on this issue, the security situation here in Kosovo and if you allow in continuation of that what my chief and friend Jean Christain Cady reported to you, I would like to split my presentation in two parts. One part is dealing with some more recent incidents, criminal incidents which have happened and where on the one hand you might have interest to get some information on how we are handling this and the second part might be to report out of the police perspective what we did in 2002 with regard to improve the security situation in Kosovo and what the challenges and major objectives in 2003 will look like and so unfortunately I had to re-write what I intended to tell you today because yesterday approximately 19.30 in Pec/Peja a single rocket propelled rocket was shot at the police regional HQ, this rocket hit the second floor of the regional HQ Building, damaging mostly windows and the structure of this building luckily remained structurally sound although this building was staffed with Kosovo Police and by International Police Service and civilian staff we have not had to face any injuries luckily, with the police and with the assistance of the KFOR secured the scene, the streets and roads in the area of the Regional HQ have been closed. Motorists have been advised to use alternate routes, and the regional investigation unit has been investigating this incident in assistance with the diminishing capabilities of KFOR. Let me mention in this context here and it might be worth also to do it, giving you one phone number, that we call upon the public that army open with information about this incident is asked to notify the police immediately and we have a confidential phone number we are going to issue right now over all media channels, this is 039 32 327. Ladies and Gentlemen, I have a recall of what happened in Kosovo since 2000 and this is not the first time the police got attacked and is not the first attack of the serious kind, but we have to acknowledge that police officers need international officers or officers from the Kosovo Police Service are facing increased aggressive behaviour, threats, intimidations, physical attacks and now also racket attacks. This is somehow, a new type of incident we have to face and please let's not forget that a couple of weeks ago the private car of a Kosovo Police Service member got exploded by a bomb, most likely due to the fact that he was closest to finishing an investigation against serious crime. It looks like we are reaching a new state in our efforts, combat serious and organised crime and Jean Cady mentioned the appearance of what we call mafia type crime, we have had to face a number of significant incidents of this type in the past year and in the beginning of this year, Tahir Yemaj together with two of his relatives was killed on the second of January of this year and he had had summer last year to face an attack with an RPG in Pec/Peja which looked quite similar to that what has been the most recent attack against the local and the international police forces in Peja. Is this then a sign we have more success, that we are getting closer to those we would like to bring to the court, is this an attempt to strike back? Ladies and Gentlemen, allow me only to raise this question as the gossip in the street will do that, I will not do that we will not speculate, we will all the time stick to our police investigation of what has happened and find out the real background and then from there on to move together the necessary evidence, but I must in one area underscore and repeat what Mr. Cady has already

mentioned, for sure this attack yesterday in the night has been a clear attack against effective crime prevention carried out by Kosovo Police Members in assistance together with their International colleagues and I may tell you that the mood within the KPS with whose members I am communicating through my senior staff members and colleagues, is of that kind that they clearly tell me we need a request to get support by our local political leaders to be supported in that what we are doing here, when I am talking about success as far as I can with regards to arrest, to find the necessary evidence in serious incidents all over the last year it is not an international police success story it is a joint success story where in many cases the evidence has been found by brave and engaged KPS members and in two examples I will give you some view of that, this increased success with regard to combat of serious and organized crime is already a success story involving the KPS and as this so the KPS is gathering the necessary self-esteem to say then please we must be supported in this role and we must receive the help and the support and the public condemnation of that what's going to happen here by our political leaders. When it comes to incidents like those mentioned, recent murder, when it comes to the car bomb in Prishtina middle of December, 31 people got injured some of them seriously, rest assured Ladies and Gentlemen that we are investigating this crime using the best resources we have although sometimes, when reading some comments and some publications of the present media this is taking into serious doubt and as this is so and without revealing details about ongoing investigations which I beg your pardon I can not do, I am going to tell you that somehow, how we are investigating cases like this, when it came to the car bomb explosion in Dardania area in Prishtina, the scene has been cordoned for three years as in three days and a finger tip investigation from the whole scene was carried out during this period, over 100 police officers have been engaged in the immediate follow up and around 30 investigators and special police were used together in the evidence, we have had more than 300 exhibits to examine, and we have carried out house inquiries in all premises in the area and so we spoke to more than 200 possible witnesses or persons living there, we have recovered items which may contain DNA substance which is then going to be examined by specialists in forensic institutes in countries ready for to help us in this fight and we have interviewed 96 witnesses all have been interviewed and the statements have been taken but although we have extensively photographed and videographed and carried and identified all physical evidence although we have had an extensive present media coverage as a result of this press and media coverage no other witnesses came forward as a result of this press release. Let me just cover it in a similar way, but briefer with regards to the murder on the 4th of January the killing of Mr. Tahir Yemaj and two of his relatives, let me mention that the investigation has been carried out by a minimum of 9 international Police Officers, experienced officers and 14 KPS members who are doing nothing else than investigating this case. Let me tell you that we have taken 17 to 18 statements of witnesses so far trying to find out what happened there on the scene and who carried out that act and let me tell you that we are knowing during what we found out that most likely between 20 to more than 30 persons in the scene must have seen something, because they must have seen this brutal attack, no one of them showed up and gave testimony, so what should we do. I am repeating 4 sentences in this regard /to know means not to arrest/ we need evidence, investigations need time, you are expecting from the police that we are doing a professional job our international colleagues the KPS, this needs time and during this time we will not go public with details as this would disrupt our efforts. Impatience will lead to nowhere, and witness protection we require by the International

Community and have been promised to get some is one thing but witnesses have to come forward, before we are ready to say OK we will cover you and to protect you and in the meantime we will not go public with what you are telling us but it needs to tell the witnesses to come forward because we can not protect them while is not knowing them, so the door swings to two sides the police as a mandate out of the population will carry out everything to protect and to serve the population but the population must play their part there also. Mr. Chariman, Ladies and Gentlemen, just then, having covered these most recent incidents some very few remarks in addition to that where I would draw your attention where I have set up as a strategy when I came into Kosovo in March 2002 and which has been the strategic direction for the police, it has been to fold to increase support into success in combat organised crime, terrorism and other serious crime and it has been rapidly move forward towards a transition to our friends and brave colleagues of the KPS. This has been driving myself and my colleagues through the last year where with regards to increase our success to combat serious and organised crime we have set up a whole new unit with special police for to have not only the necessary intelligence about that what's going on in this field of criminality but also to have the necessary investigation mechanisms up and running. A mostly as in all areas in Europe and other parts of the World a mostly covered unit and a mostly proactive investigation and organisation so I beg your pardon again that with regard to that I will not be able to go too public with what we are doing there, but I can assure that a number of successes we had last year have been due to the fact that we increased our activities and consolidated our efforts our visible one and our hidden one in close cooperation with the justice and KFOR, and some of these successes I can not even mention publicly. The transition plan towards the KPS is even more important although in the meantime what the KPS is not in the condition to effectively combat the serious and organised crime by their own means we are doing that job more and more together with them, the most important thing is to transit to ownership of the police authority through my friends colleagues to my friends and colleagues of the KPS. This has only been done in Gracanica and in Kacanik, your Assembly here since the set of 2002 has been protected by the KPS security division and we have close protection of the KPS close protection together with our international colleagues, we have invited from while areas police services working already autonomously or together with international colleagues in areas where they are not only patrolling by foot, but also carrying out thorough and serious investigations where the KPS is engaged in areas to collect intelligence, administer the police and the set the strategic directions, this is more than you might see, because there is a linear plan where we can clearly tell you, this is going to happen in February 2003 and this is going to happen in April 2003, is an ongoing effort to move forward to push to stand still to look where we have done the right thing, to adjust and then to do the next things and so this transition plan aims to be as fast as possible but also as good as possible. With a forecast of 2003 you might expect then that it isn't not only the hand over of between 9 and 12 further stations to the KPS, but that this means also that expect by the end of 2003 nearly everywhere in Kosovo that the fundamental police duties patrolling and policing investigating on the station will be carried out nearly totally by the KPS on their own advice and monitored by some International colleagues. This does not only mean to have the KPS assuming this is authority 2003 in those fundamental, but bottom line you might or let me say you will see and increased participation of the KPS when it comes to combat organised crime but again how we are doing this please do not expect that I am ready to tell that publicly but we will do that. And when it comes to leadership, when it comes to a situation that some 10



cornals are acting as advisers to regional police commanders also to the police commissioner, also you might expect that we will change that that we will move to some kind of co-location by teams where the authority on the senior levels to have responsibility and to create and to ensure that what the police of this country should be, should be in the hands of the KPS because it is their own police, that is what I am going to do with regards to the KPS hand over next year, let me conclude with that that we will continue with the final set up with all those means to combat organised crime, we have the full support of the International Community supporting us in this regard, is a challenge because as you know, these people are specialists and we have to convince countries that they will send specialists to Kosovo is a daily challenge we are taking it and to that extent I would consider we are successful but the real thing is to have also been carried out under participation of the KPS. Thank you very much that I had the opportunity to give you this presentation, Mr. Chairman.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Dëgjuam prezentimet e mysafirëve përgjegjës kryesorë për drejtësi dhe siguri për çka i falënderoj. Kolegë deputetë do t'ju lutja që të paraqitet nëpërmjet pyetjeve esenca e asaj që na mundon të gjithëve dhe unë do të procedoja me udhëheqësit e grupeve parlamentare, vetëm nëse dojnë, dhe nuk e kanë për obligim. Zoja Nekibe Kelmendi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

### **NEKIBE KELMENDI:**

Unë, duke dëgjuar ekspozitën e dy zotërinjve të nderuar, të cilët vërtetë punojnë që gjendja në Kosovë të jetë më stabile, kam përgatitur disa pyetje që do t'ua shtroja, e këto janë:

- Sa po punohet në parandalimin e përzjerjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në veriun e Mitrovicës?
- Sa po punohet në zhdukjen e paralelizmit në sistemin gjyqësor të Kosovës, sepse dihet që vrasja ndodh në Ponesh, midis serbëve, kurse gjykon gjykata e Vranjës; akuzon prokurori i Vranjës, shkalla e dytë e Vranjës gjykon në emër të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit?
- Pse janë marrë instruktorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në Shkollën e Policisë së Kosovës e nuk janë marrë instruktorë nga komuniteti serb këtu?
- Pse nuk veprohet lidhur me kallzimet penale që u janë bërë prokurorive të qarqeve në Kosovë për krime të luftës, siç është rasti me 250 kallzime penale në Pejë lidhur me të cilat nuk veprohet asgjë dhe ato lëndë, ato kallzime penale i kanë marrë policia dhe prokuroria ndërkombëtare, e s'është vepruar asgjë dhe ka edhe raste të tjera që ka ngrit kallzime penale edhe Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe të Lirive në Prishtinë, por nuk është vepruar, dhe
- Sa është vepruar në hulumtimin dhe zbulimin e krimeve ekonomike në ndërmarrjet shoqërore të cilat janë të pakta, por janë të aktivizuara dhe punojnë në Kosovë, sepse ato kërkujt nuk i jepen përgjegjësi; i japin lokalet me qira; i merr drejtori apo dikush tjetër ato qira; iu jep punëtorëve që nuk punojnë një pagë prej 50 apo 100 euro, kurse pjesën më të madhe nuk dihet se në xhepat e kujt përfundojnë.

Dhe, për fund, kam një sygjërim që përkitazi me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dëmtuarëve të cilët gjithësesi janë faktorë kyç për zbulimin e krimeve të çfarëdo lloji në Kosovë, të formohet një ekip i cili do t'i ndihmojë ata, një ekip i ngjashëm sikur që ka Tribunali i Hagës. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit zonja Kelmendi. E ka fjalën zoti Kuqi, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

## HAJREDIN KUQI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar përfaqësues të Shtyllës së parë dhe të Policisë së UNMIK-ut,

Unë kam menduar dhe ndoshta kam drejtë morale pak më shumë se disa të tjerë nga se qysh para një viti, në prill të vitit të kaluar, kam kërkuar që në Kuvendin e Kosovës të shtrohet çështja e sigurisë dhe, me siguri ju kujtohet, apo edhe nga procesverbali mund të dihet, sidomos në kohën kur flitej se në Kosovë janë 100.000 veteura të vjedhura, dikush fliste për atë si krim të organizuar. Unë si deputet i Kuvendit të Kosovës por edhe si qytetar i Kosovës kam pasur dëshirë të dijë mbi gjendjen e sigurisë, por njëkohësisht kam pasur dhe kam dëshirë që të jap kontributin tim në këtë drejtim.

Do të ndalem në një fushë dhe ajo është fushë e jurisprudencës, të cilën, besoj pak më mirë e njoh. Ne të gjithë, besoj edhe UNMIK-u edhe bashkësia ndërkombëtare, nga ne kërkon që të bëjmë një shtet juridik por edhe të gjithë e dijmë se kjo nuk mund të arrihet pa një gjyqësi të pavarur. Unë do të konstatoja këtu se në Kosovë nuk kemi gjyqësi të pavarur dhe gjyqësia e pavarur, e dini, ajo kur i përgjigjet kushtetutës i përgjigjet ligjit dhe jo dikuj tjetër.

Ndërsa në Kosovë, që unë do t'i ngris në formë të çështjeve që mund të mirren edhe si pyetje, në Kosovë gjyqësia apo gjyqtarët nuk i përgjigjen kushtetutës, nuk i përgjigjen ligjit por i përgjigjen personave të caktuar. Pa marrë parasysh, në këtë drejtim do të përmendja urdhërin administrativ të PS të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili, mendoj se cenon rënd pavarësinë e gjykatave në Kosovë.

Një perceptim tjetër, mendoj se pavarësia e gjykatave duhet të shkojë në shkëputjen që kanë bërë ato, në harmonizimin me institucionet vendore por edhe me institucionet ndërkombëtare. Unë personalisht nuk di se ato kanë një koordinim apo pushteti gjyqësor në Kosovë ka koordinim me pushtetin ekzekutiv dhe ligjvënës në Kosovë, por njëkohësisht nuk di se kujt i përgjigjen. E di dhe kam informacione se ato i përgjigjen Përfaqësuesit Special apo Përfaqësuesit të Shtyllës së parë të UNMIK-ut dhe kanë një inspektoriat të brendshëm, por ai inspektoriat sa kam unë informacione, më shumë mirret me përgjegjësinë individuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve e më shumë me përgjegjësinë e punës së gjykatave dhe brenda kësaj nuk e di si punon përgjegjësia brenda prokurorive. Për shembull, a i përgjigjen prokurorit të Kosovës prokurorët e gjykatave të qarkut, prokurorët e gjykatave komunale dhe kështu me radhë. Apo, më ndryshe mund të them, në gjykatat tona, në sistemin gjyqësor, është krijuar përshtypja – unë duhet ta kam mirë apo t'i përgjigjem atij që më emëron, në këtë rast, përfaqësuesit të UNMIK-ut, dhe më pak të bëj dertin, të thuash, për ata të cilët juridikisht por edhe në aspektin praktik duhet t'i përgjigjemi.



Në veçanti e kemi edhe një shkëputje, mendoj te Drejtoriati për Çështje Pronësore dhe Banësore – për HABITAT-in, i cili ka marrë shumë kompetenca nga gjykatat kurse në anën tjetër nuk kemi asnjë përfaqësues të vendit, as bashkëdrejtues apo të ndonjë forme tjetër të përgjegjesisë.

Një çështje tjetër do të ngritja këtu, çështjen e politikës kadrovike në gjyqësi. Besoj se do të keni durim edhe dy minuta. Politika kadrovike a i ka plotësuar edhe kushtet mjaft fleksibile që kemi sipas dispozitave tona apo shpeshherë kemi të bëjmë edhe me gjyqtarët të cilët për shkak të hipotekës së të kaluarës nuk janë në gjendje që të merren me gjykime në të tashmen.

Këtu u përmend shpeshherë çështja e dëshmitarëve. Unë mendoj se dëshmitarët, në radhë të parë, pse nuk janë ardh deri më tani, duhet të na japin një llogari apo një përgjigje zotërinjt e mëparshëm, por mendoj se këtu nuk është bërë sa duhet në vetëdijsimin e qytetarëve tanë për dëshmi. E dyta, mendoj që nuk është bërë mjaft në sigurimin e dëshmitarëve. E treta, ne dijmë se dëshmitari në shumë vende në botë ka edhe stimulime materiale dhe besoj për rastet e rënda apo për vepra të rënda penale duhet të merren masa që të ndahen edhe mjete materiale dhe dëshmitarët që janë në gjendje të japin informacione të stimulohen. Dhe, e fundit, mendoj pse nuk kanë dhënë është edhe perceptimi politik i disa veprimeve apo veprave penale, kur automatikisht dëshmitari, që mund të ketë perceptim tjetër politik, nuk ofron dëshmi. Ndërsa, unë mendoj se ofrimi i dëshmimeve është vepër morale, njerëzore dhe kombëtare. Dhe çështja tjetër, mendoj se është mosbesimi dhe a ka menduar ndonjëherë Shtylla e parë e UNMIK-ut - pse është krijuar një mosbesim ndaj gjykatave në Kosovë. Sa i përket mosbesimit, do të përmendja rastin në Merdare, ku mbahen 9 muaj dhe lirohen të pafajshëm; rasti i Afrim Zeqirit, pastaj mund të them rastin e kompromisit politik që mund të jetë me zotin Ivanoviq apo me dikë tjetër në Mitrovicë; pastaj kompromisi politik, nuk ia di mirë, të një serbi Beshoviq, nga Peja, i cili me marrëveshje me Qeverinë e Serbisë lirohet nga arrestimi.

Dhe, në fund, do ta pyesja përfaqësuesin e Shtyllës së parë – a ka pasur parasysh çështjen e kompetencës territoriale dhe çështjen e kompetencës kohore që e kanë gjykatat në Kosovë. Unë e di se rasti i Ruzhdi Saramatit ka qenë jashtë kompetencës kohore, rasti që mund të jetë këto ditë dhe sa është shtrirë kompetenca territoriale edhe në pjesën tjetër të Kosovës, ku për momentin unë nuk di se ka gjyqtarë tanë. Ju falënderoj për vëmendje dhe ju kërkoj falje nëse e kam zgjat pak më shumë.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit zoti Kuqi. Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Dugolli e ka fjalën.

## BUJAR DUGOLLI:

Megjithatë temë e rendit të ditës është shqyrtimi i gjendjes së sigurisë dhe ka qenë kërkesë e grupeve parlamentare që kjo çështje të shtrohet e të diskutohet dhe është shumë mirë që kanë ardhur përfaqësuesit edhe nga autoritetet e UNMIK-ut dhe të policisë e t'i drejtohen këtij Kuvendi dhe përmes këtij Kuvendi t'i drejtohen edhe popullit.

Ne do t'i përmendim disa arsye që fatkeqësisht është kjo gjendje e sigurisë në Kosovë.

Numër një dhe më e rëndësishmja është mosdefinimi i statusit politik të Kosovës. Prapë autoritetet ndërkombëtare dëshirojnë ta anashkalojnë këtë çështje. Ky është problemi dhe gjeneratori i problemit për t'u bërë një gjendje e pasigurisë dhe për t'u rrezikuar siguria e përgjithshme në vend. Të them – mosdefinimi konform vullnetit të popullit. Dhe kjo shkakton të gjithë qytetarët e Kosovës një pasiguri për të ardhmen e vet, për fatin e vet.

Kufijt e Kosovës, sidomos me ato vende si është Serbia dhe Mali i Zi që 90 vjet të fundit Kosovës i kanë ardhur vetëm rreziqe, probleme, dhunë dhe formacione të ndryshme ndëshkuese në Kosovë dhe prapë mbeten të hapur, pa pika kontrolluese, të cilët vazhdimisht mund të hyjnë qytetarët e vendeve të ndryshme apo ekstremistë të ndryshëm që krijojnë pasiguri dhe dhunë në Kosovë dhe kjo po bëhet falë këtyre qëndrimeve, domethënë, që po i bën bashkësia ndërkombëtare veçantë me disa shtete, veçantë me disa shtete tjera përreth Kosovës.

Mandej, është një çështje tjetër, një partneritet shumë i theksuar, me Qeverinë e Beogradit – autoritetet e UNMIK-ut. Mungon partneriteti me institucionet e Kosovës, ndërsa ka partneritet ekstra me organet e sigurisë, të policisë së Beogradit dhe të Qeverisë së Beogradit. Marrëveshjet, qoftë transparente, qoftë të fshehta që, për mendimin tonë, s'kanë prodhuar asgjë të mirë, por vetëm kanë rritur probleme dhe tensione, duke krijuar iluzione të një shtresë e caktuar e popullsisë së Kosovës e që mund të bëhet edhe ndryshe dhe mund ndokush nga jashtë qoftë të përzihet qoftë të ndërhyjë në punët e brendshme të Kosovës.

Mosdenimi apo moskapja e kriminelëve të luftës! Zotërinj të nderuar, 40 të akuzuar për krime iu kanë ikur nga burgu i Mitrovicës dhe në takimet e përjavshme që i mbani me autoritetet e Beogradit asnjëherë nuk keni kërkuar ekstradimin e tyre dhe qitjen para drejtësisë në Kosovë për ato krime që kanë bërë në Kosovë. Nuk janë vetëm 40 por mund të jenë me qindra e mijëra të tillë që kanë bërë krime në Kosovë.

Moszbulimi i shumë vrasjeve, qoftë enigmatike, me motivacione të ndryshme. Askush nuk ka dëshirë më shumë se ne, si qytetarë të Kosovës, që t'i zbulojmë ato vrasje dhe akterët e tyre t'i qesim para drejtësisë. Ne nuk dëshirojmë as për popullin tonë, as për Kosovën të kemi një imazh të keq, por nuk kemi si të dhëmë kontributin kur nuk ka partneritet në mes nesh.

Proceset politike kundër pjesëtarëve të ish UÇK-ës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës! Me këto forma lejohet dhe dëshirohet të krijohet një përshtypje se ne paskëm qenë në luftë mes veti. Zotërinj të nderuar, këtu ka pasë dhunë sistematike dhe agresion shtetëror i një vendi ndaj vendit tonë dhe të gjitha ato krime dhe ato vrasje të fshehta kanë ndodhur nga ata të cilët e kanë pushtuar me dhunë Kosovën dhe ndaj të cilëve keni luftuar edhe ju.

Mandej – drejtësia dhe siguria me standarde të dyfishta. Nuk mund të ketë drejtësi shumëetnike, polici shumëetnike. Kjo u vërejt edhe nga diskutimi i zotit Caddy në këtë fjalim. Në rend të parë duhet të ndërtojmë drejtësi të pavarur, profesionale dhe demokratike e mandej vjen në shprehje drejtësia shumëetnike. Kjo vlenë edhe për policinë. Nuk mund t'i jipet prioritet ndërtimi një policie shumëetnike duke harruar policinë e pavarur demokratike dhe profesionale.

Për të dalur nga kjo situatë, ne kërkojmë një partneritet të plotë të institucioneve të Kosovës me faktorin ndërkombëtar. T'u jipen kompetencat e plota për siguri Shërbimit Policor të Kosovës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës, sepse ju nuk përmendët, në fjalimet tuaja, asnjëherë sa u përket Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe aktivitetin e tyre.

Partneritet të plotë në drejtësi, duke na lejuar që të kemi edhe ne ministrinë e drejtësisë dhe në bashkëpunim me ju t'i zgjedhim këto çështje.

Dhe, në fushën e marrëdhënieve me jashtë. Zëri ynë i vërtetë nuk po dëgjohej jashtë. Çak edhe kur vijnë delegacionet më të ndryshme, çohet në qiell puna e UNMIK-ut apo e autoriteteve ndërkombëtare dhe zbehet puna e vendorëve.

Mendoj se këto të arritura të deritashme i kemi të përbashkëta, jo duke u lavdëruar vetëm Misioni dhe duke u kritikuar institucionet e Kosovës.

Këto janë disa sygjerime tona dhe mendoj se pyetje do të ketë edhe nga deputetët tjerë për autoritetet që janë prezent këtu. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit, zoti Dugolli. Nëse ka pyetje shefi i grupit të minoriteteve. Ju lutem, jemi marrë vesh – 60 minuta dhe duhet t'u lëmë kohë për përgjigje në pyetje, ndërsa ne pastaj ata të cilët donë me diskutuar e me bërë pyetje, ne do ta vazhdojmë këtë dhe ta rumbullaksojmë. Urdhëroni, zoti Murati.

### **XHEZAIR MURATI:**

Prvo da pozdravim kolege, Predsedništvo i gospodu iz Medjunarodne policije. Naša lica, kažem govore koliko je ovo teška tema koje smo danas načeli. Medjutim, na česte naše primedbe da brojna ubistva, bar po našem mišljenju, nisu dovoljno brzo i kako to svi želimo, otkrivena imena i veoma često imamo po nama neopravdana objašnjenja da lokalno stanovništvo nedovoljno saradjuje u otkrivanju počinjenih dela. Medjutim, mi veoma često slušamo i na neki način kao opravdanja – istraga je u toku; mnogo toga ne možemo da iznesemo; ne želimo da se mešamo u kompetencije, i tako dalje a i mi kao predstavnici nailazimo veoma često na neprijatne situacije u kontaktu sa gradjanima kada ne možemo ni minimum informacija da pružimo. Pogotovo, bez prejudiciranja, svako ubistvo je teško po sve nas, ali refleksije, kada dodje do ubistva pripadnika manjina, odražavaju se i na pojačane odlaske. Recimo, poslednje ubistvo jednog bošnjaka u Dragaškoj opštini. 31. decembra, nije ni pomenuto ovde. Bez, kažem prejudiciranja, naš narod kaže, imamo jednu mudrost ovde na Kosovu, kada kažemo – onaj koji poćini jedno nedelo napravio jedan grijeh ili džunah, kako to kažemo. Medjutim, mi koji smo doživeli to nedelo napravimo sto takvih grehova, jeli razmišljajući ko je, šta je i tako odalje. Otkriće mi imamo...

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Zoti Murati, ju lutem pyetje, këta referuesit kanë të planifikuar kohën.

### **XHEZAIR MURATI:**

... Dakle, moje je pitanje, refleksije ubistava na pripadnike manjina, da se više računa povede o tome od predstavnika Medjunarodne policije i od Kosovske policijske službe samim tim što time sprečavamo ostvarenje onoga do čega nam je svima stalo a to je multietničko društvo. I dalje, prilikom iznošenja podataka o tome koliko je ljudi primljeno u Kosovsku policijsku službu i u pravosuđe, meni se čini da se jedna manjinska zajednica malo više forsira od ostalih manjinskih zajednica koje ulažu maksimalan napor u integraciju u kosovsko društvo. Tu imamo primedbu kao pripadnici ostalih zajednica. Hvala.

### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Profesor Sabri Hamiti dhe pyetje tjera s'ka më. T'i dëgjojmë përgjigjet e pastaj vazhdojmë.



**SABRI HAMITI:**

Unë kam vetëm një pyetje: Si është e mundur që të konsiderohet se policia dhe drejtësia ndërkombëtare në Kosovë ka suksese nëse pranon që ka pasur, vetëm në tetë muajt e kaluar, 8 vrasje me motivacion politik dhe nuk e ka zbuluar asnjë vrasje të rëndë e kriminele të përfaqësuesve të mëdhenj të partive politike, në këtë rast kryesisht të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të përfaqësuesve të zgjedhur të popullit të Kosovës, flas për kryetarë komunash, kryetarë të degëve të partisë, për deputetë të Kuvendit të Kosovës? Ju falemnderit.

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë.

**XHAVIT HALITI:**

Unë s' do të marr kohë. Të nderuar përfaqësues, dëshiroj t'ju pyes, meqenëse në media dhe nga trajtimi profesionist që është bërë në organet e juaja, janë prekur disa çështje për të cilat do të kërkoja që Parlamenti dhe qytetarët e Kosovës të jenë të informuar, do të kërkoja të dij nga informacioni juaj:

- Sa është i involvuar shërbimi i fsheht serb në Kosovë?
- Çfarë segmentesh të shërbimit sekret a informativ shqiptar veprojnë në Kosovë dhe cilat janë informatat tuaja të vërteta dhe a ekziston ky apo jo?
- Cili është implikimi i shërbimit të fshehtë maqedon në Kosovë?

Po i bëj këto pyetje meqë duhet të jemë të informuar, meqenëse në opinion qarkullojnë dezinformime të ndryshme. Ju falemnderit.

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Edhe një prej LPK-ës dhe pastaj vazhdojmë të gjithë. Ta shfrytëzojmë kohën sepse do të mbesim pa asnjë përgjigje. Ne pastaj do të vazhdojmë sa të kihet nevojë, një ditë, dy, tri.

## HASAN META:

Të falemnderit zoti kryetar, e nderuar Kryesi, të nderuar mysafirë, zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë, kur është paraqitur kjo çështje e sigurisë në Kosovë, e kam menduar, t'ju them të drejtën, disi ndryshe. E vërtetë se janë paraqitur ekspozitë të mira nga zotërinjtë që mbulojnë resoret përkatëse dhe kemi një pasqyrë të mirë për këto çështje. Mirëpo, e kam menduar këtë krejtësisht ndryshe. Kam menduar se do të kemi analiza të cilat pakashumë do t'i shtjellonim këtu për përmirësimin e gjendjes së sigurisë në Kosovë dhe cilët janë faktorët që bëjnë që në Kosovë të kemi krime, që në Kosovë të kemi krime të organizuara, mafioze, si po flitet e tjera, e tjera. Sepse, kryesisht për këto që dëgjuam tash, i kemi edhe nga mediat të njohura, që po ndodhin krime e tjera, e tjera.

Por, për mua kishte me qenë interesante – kush mund ta analizojë pakashumë këtë çështje çfarë kemi dhe të marrim disa konkluzë se si mund të veprojmë, në çfarë mënyre për ndalimin e krimeve në Kosovë. Dhe pyetjet kishin me qenë të këtilla, për mua:

- Sa ndikon në sigurinë e Kosovës mungesa e ministrive përkatëse vendore që merren me këto çështje? Pyetja një, kishte me qenë.

Po e zëmë, thirren gjithmonë të huajt, UNMIK-u e të tjerët dhe thonë se mungojnë dëshmitarët në Kosovë. Mund të pyesim:

- Sa ndikon mungesa e ministrive përkatëse dhe besimi që duhet të na jipet neve si qytetarë të Kosovës që të bashkëpunojnë me organet përkatëse? Dhe, në anën tjetër,
- Sa ndikon, për shembull, ndarja e Kosovës në dy pjesë si është bërë, një pjesë që udhëheq UNMIK-u, pjesën tjetër që udhëheq Serbia – sa ndikon në sigurinë e Kosovës?
- Sa ndikon vetë zgjidhja e statusit të Kosovës në çështjen e sigurisë. Duhet të bëhen analiza dhe të flitet për këto këtu?
- Sa ndikon gjendja ekonomike dhe sociale e qytetarëve dhe popullatës së Kosovës në krimet dhe llojllojshmërinë e krimeve që bëhen në Kosovë dhe çka duhet bërë që ato të evitohen. Duhet gjetur mënyrën që faktorët që ndikojnë në sigurinë e Kosovës të përmirësohen dhe të përmirësohet çështja e sigurisë së Kosovës.
- Sa ndikojnë shërbimet sekrete, me theks të veçantë, në ato shërbime sekrete që janë armiqtësisht të disponuara ndaj Kosovës, dhe



- Sa ndikojnë, për shembull, polarizimet e ndryshme artificiale ndërpartiake në trajtimin e krimeve që ndodhin në Kosovë  
Të gjitha këto, mendoj se duhet të diskutohen, të analizohen mirë dhe të bëhet një përmbledhje e fuqishme këtu në Kuvend dhe në institucione tjera dhe këto të bëhen të qarta për shumë qytetarë, të cilët janë të shqetësuar, të Kosovës.

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Zoti Caddy, shpresoj se jeni marrë vesh për radhën për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. E ka fjalën zoti Caddy.

**Vërejtje: Përgjigjet në pyetjet e deputetëve nuk janë bashkëngjitur në këtë transkript për shkaqe teknike. Të njëjtat do të jipen në transkriptin e ardhshëm.**

**KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Mendoj se në fund të seancës kemi planifikuar të nxjerrim disa qëndrime në të cilat është përfshirë edhe vlerësimi për këtë gjendje dhe sigurisht se do ta gjykojmë dhe ndoshta do të distancohemi, prandaj mos u nguteni. Zoti Caddy, unë i sforcova udhëheqësit e grupeve parlamentare dhe grupet parlamentare të bëjnë vetëm pyetje, do të thotë, ishte marrëveshje jona në mënyrë që të keni kohë për përgjigje, prandaj do të zë vend edhe kjo. Nëse doni, zoti Feller, mund ta merrni fjalën. Urdhëroni.

**Vërejtje: Përgjigjet në pyetjet e deputetëve, për shkaqe teknike, nuk janë bashkëngjitur këtij transkripti. Të njëjtat do të jipen në transkriptin e ardhshëm.**

## **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Të nderuar kolegë, unë do t'ju thoja sa është e ndieshme tema e filluar. Do t'i kërkoj falje atyre që në këtë fazë nuk kanë mund të kyçen. Po ju informoj se përmes 7 deputetëve janë bërë më tepër se 50 pyetje. Është hapur "Kutia e Pandorës" e quajtur siguri, si pjesë e rezervuar dhe unë do të thoja që ky është fillimi i një bashkëpunimi vërtetë të duhur në mes të institucionit të Parlamentit dhe UNMIK-ut dhe shtyllave përgjegjëse për siguri. Më lejoni t'i falënderoj edhe zotin Caddy, edhe komisionarin Feller dhe të them se ne do ta vazhdojmë bashkëpunimin e ndërmjetshëm. Ndër të tjera, falënderojmë edhe zotin Shtajner që ju ka autorizuar.

Ne tani do ta kemi një pauzë deri në ora 12,15. Lus shefat e grupeve parlamentare, që të merremi vesh për fazën e dytë të të njëjtës temë, le të vijnë te unë dhe të bisedojmë lidhur me këtë. Edhe një herë ju falemnderit për pjesëmarrje.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

## **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Besoj se jemi freskuar pak dhe mund të vazhdojmë punën, me të njëjtën pikë të rendit të ditës – çështja e sigurisë në Kosovë. Hapi debatin lidhur me këtë. Fjalën e ka profesor Sabri Hamitij.

## **SABRI HAMITI:**

I nderuar kryetar i Kuvendit, kolegë të nderuar e të çmuar, Siguria është çështje thelbësore për zhvillimet e tashme dhe të ardhshme në Kosovë në të gjitha aspektet. Formula "zero-tolerancë ndaj krimit të organizuar dhe të gjithë të barabartë para ligjit, askush nuk është mbi ligjin" janë vetëm deklarime, nëse nuk përcillen me veprime. Kuvendi, si organ i lartë bashkues e përfaqësues, duhet të inicojë e të trimërojë veprimet kundër dhunës dhe krimit të organizuar. Diskutimi i sigurisë në Kosovë sot e ka këtë qëllim dhe preokupim të parë dhe për këtë jam mëse i bindur.

Nën një. Mendoj se **siguria është kusht për caktimin e statusit politik të Kosovës**. Forcimi dhe funksionimi i institucioneve demokratike legjitime të Kosovës është një parakusht i sigurisë. Më tutje, rritja e besimit të qytetarëve të Kosovës në këto institucione, si dhe besimi i forcave politike ndërkombëtare rrit efektin e institucioneve. Vetëm kështu këto marrin forcën se mund të qeverisin vendin duke marrë në mënyrë proporcionale kompetencat dhe përgjegjësitë e veta.

Aty ku nuk ka kompetencë, është punë e vështirë të kërkohen e të identifikohen përgjegjësitë. Pamundësia e këtyre institucioneve për të shtrirë pushtetin e tyre në gjithë territorin e Kosovës ka krijuar hendikepin e madh të tyre, deri më sot. Ndërhyrja nga kushdoqoftë në çështjet sistemore e funksionale të jetës në Kosovë vetëm se prodhon tensione të brendshme. Kjo është provuar dy herë në vitin e kaluar.

Me prekje të kufijve dhe me përmendjen e Kosovës në preambulën kushtetuese të Serbisë e të Malit të Zi, në të dy rastet është paragjykuar statusi politik i Kosovës dhe ne jemi detyruar të reagojmë, siç kemi reaguar.

Situata në Mitrovicë e në Kosovë të veriut, në mënyrë të përhershme prodhon krizë. Planet që udhëheq UNMIK-u në bashkëpunim me Beogradin rreth Mitrovicës, pa asnjë pajtim e përkrahje të institucioneve legjitime të Kosovës, nuk mund të kenë sukses. Kjo është provuar para dy-tri ditësh me deklaratën për lidhje territoriale të komunave veriake, për të cilat, unë qysh tash deklaroj që Grupi ynë parlamentar është kundër tyre dhe e dënon dhe çmon të pavlefshme.

Në këtë mënyrë siguria bëhet kusht për funksionimin e institucioneve dhe kusht për statusin e Kosovës. Nga ana tjetër, pa statusin e përcaktuar të Kosovës, institucionet nuk kanë kompetenca. Ju shihni që po sillemi në rreth. Prandaj, unë konsideroj që transferi i kompetencave në të vërtetë është masë e sigurisë në Kosovë.

**Nën dy: Siguria kusht për liritë njerëzore në Kosovë.** Lëvizja e lirë e qytetarëve dhe veprimi i tyre i lirë në gjithë territorin e Kosovës janë premisa të sigurisë. Barazia e tyre para ligjit, që nuk njuh kurrfarë favorizimi politik, social, kulturor a nacional, krijon parakushtet që të jenë njësoj të lirë individët dhe kolektivitetet në vështrimin e etnive. Tani, kthimi i njerëzve në votrën e vet, në pronën e vet e në jetën e vet, merr kuptimin e lëvizjes normale të një shoqërie. Vetëm barazia, e jo favorizimi, mund të krijojnë dialogun brenda shoqërisë. Ndërhyrjet e tjera, mund të krijojnë tensione të përhershme. Çdokush në shtëpinë e vet është formula më e përshtatshme e jetës. Është provuar dhjetëraherë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar që fushatat për të ndërruar strukturën etnike të Kosovës kanë përfunduar pa sukses ose me tragjedi, pikërisht se janë mbështetur në forma të gabueshme të krijimit të etnive të favorizuara, kështu që duke u marrë me pakicën, është lënë anash shumica. Në këtë vështrim, në Kosovë kurrfarë diskriminimi qoftë ai me shenjën pozitiv apo negativ, nuk preferohet dhe nuk do të ketë sukses. Në Kosovë mund të jetojnë të qetë e në harmoni të gjithë qytetarët e saj duke i pranuar realitetet e reja politike, sociale dhe ekonomike, natyrisht, të gjithë të barabartë para ligjit që do të thotë qytetarët në punë e në shtëpi, kurse kriminelët para drejtësisë.

Teoritë e pajtimeve morale e politike të etniteteve, pa zbatuar drejtësinë, janë vetëm retorikë boshe dhe humbje e kohës.

Nën tre: **Siguria është një kusht për demokracinë në Kosovë.** Tanimë Kosova e ka pranuar demokracinë si sistem të qeverisjes dhe si sistem të vlerave. Pluripartizmi ka sjellë në skenën shoqërore alternativa politike të cilat shpallen e provohen në procesin e zgjedhjeve për të marrë qeverisjen. Të gjitha këto prova janë bërë me zgjedhjet në Kosovë, pa tensione të mëdha, nganjëherë duke harruar që demokracia nuk është vetëm sistem procedurash por edhe zbatim rezultatesh, madje-madje marrëveshje politike e shoqërore. Alternativat në Kosovë nuk do të ishin të tilla nëse do të kishin historinë e tyre të veçantë, sistemin e vlerave dhe metodën e veprimit shoqëror. Mirëpo, ende nuk është maturuar një sistem demokratik - si të bëhet kur je humbës - e si kur je fitues. Pra si të luash rolin e pakicës e si rolin e shumicës. Kërkush deri më tash nuk di apo nuk do të luajë rolin e opozitës, e cila në shoqëri demokratike, duhet të kultivohet. Duket që intoleranca politike ka kaluar në rrethin më të gjerë të militantëve. Aty ku ka alternativa politike nuk mund të zhvillohet politika e likuidimit politik, por e dialogut. Politika e likuidimit mund të shpie në dy anët: ose në anarki ose në diktaturë. Ky mes dhe ky ambient, si shumë të tjerë në lindje, i ka provuar faza tragjike të këtyre fenomeneve të së kaluarës. Prandaj, pa siguri nuk ka veprim të lirë politik, nuk ka alternativa, nuk ka konkurrencë, nuk ka as kualitet përfaqësimi.

Vrasjet e figurave të njohura politike përfaqësuese në Kosovë e kanë çuar në ekstrem dhunën deri në nivel të krimit. Përndryshe, si do të zhvillohet demokracia nëse likuidohen eksponentë të njohur ose substanca e saj.

Nën katër: **Siguria kusht për zhvillim ekonomik.** Deklarimi program apo institucional për ekonominë e hapur të tregut të lirë është vetëm një vullnet i shprehur publikisht, se pa ligje sistimore e pa studime sociale dhe pa zbatimin e tyre nuk ka dalje nga kriza. Kriza ka faqën e papunësisë rreth 60%, shumica të rinj dhe të shkolluar dhe të ndërmarrjeve shoqërore shtetërore në nivel të degradimit. Duhet ligjet për pronësinë dhe mbrojtjen e saj, duhet siguria e veprimit ekonomik. Investimet e huaja, që janë të domosdoshme për ekonominë e për punësimin, nuk do të vijnë pa ambient të pastër ligjor dhe pa mbrojtjen e tyre. Në anën tjetër, procesi i privatizimit si domosdo e ngjalljes ekonomike, është i panisur dhe askush nuk ka bërë publike format e tij. Dihet vetëm për agjencinë që ka rezervuar të drejtat për pasurinë shtetërore dhe për hapa të privatizimit. Çka nëse në faza të ngutshme të privatizimit, si fuqi e patejkalueshme, hyn në lojë mafia ekonomike, e cila është në lindje? Çka nëse punëtorët e hershëm mbeten pa asgjë, pa prona e pa punë? Pasojat do të jenë në trajtën e varfërisë së shtuar të shpërthimit social, madje edhe në forma të dhunës e të kriminalitetit, fenomene që janë në dukje edhe te ne.

Nën pesë: **Kush e bën dhunën dhe krimin?** Pa ndonjë analizë të specializuar e institucionale është thënë se, gjendja e sigurisë në Kosovë është e mirë dhe përmirësohet. Ne këtë formulë e dëgjuam edhe sot këtu. Numri i vrasjeve dhe i krimeve po zvogëlohet nga viti në vit. Edhe këtë e dëgjuam pak më parë. Po kush e bën dhunën e krimin në Kosovë? Këtu përgjigje deri më sot nuk kemi. Këtë nuk e kanë dhënë as organet gjyqësore, të dominuara nga gjykatësit ndërkombëtarë. Shpjegimet e rralla, se vrasjet e mëdha nuk mund të zbulohen lehtë, sepse janë të organizuara mirë dhe në



mënyrë implicite thonë që në Kosovë ka një rrjet të organizuar të krimit, një krim ekonomik që mban lidhje me një krim politik. Ka shpjegime që thonë se krimi dhe dhuna në Kosovë janë pasojë e daljes nga lufta, nga shkatërrimi e gjenocidi, duke parë të lidhur me një gjendje të hallakatur njësoj sociale e psikologjike. Mirëpo, është esenciale të thuhet shkoçur, a ka rrjet të krimit të organizuar në Kosovë? A prodhon krimin Kosova dhe a është e zoja Kosova të eksportojë krim? Duket që pyetja do të shtrohet krejt ndryshe. -Për shkak të pozitës, për shkak të gjendjes, për shkak të qarkullimit të pakontrollueshëm, për shkak të kapacitetit të saj Kosova nuk mund të përhapë – pra të eksportojë krimin në rajon. Por, ajo po importon, pra - po i shtrohet krimit.

Ka qenë shokante deklarata e përfaqësuesit të policisë para do kohe – se do t'i zinte vrasësit e Zemajt nëse ata ndodhen në Kosovë! Domethënë ka mundësi të pakufishme të hyrjes dhe daljes. Është evidente që dhuna dhe krimi i pandëshkuar shpejt e fuqishëm mund t'i përmbysë të gjitha vlerat, mund ta rrënojë të gjithë ardhmërinë e Kosovës.

Kush e bën sigurinë në Kosovë? Me ligjin themelor të Kosovës, të quajtur kornizë, siguria, mbrojtja, gjyqësia janë rezervuar për UNMIK-un, që dëgjuam edhe sot këtu. Në pozitë të ndikuesit, janë përshkruar detyrat e policisë së vendit, pra të SHPK-ës. Mund që kjo të ketë trimëruar gabimisht zëdhënësin e UNMIK-ut, dhe hera-herës t'i japë të drejtë vetës të paragjykojë për çka do të flasë ose do të mund të flasë ky Parlamenti ynë.

Çështja po duket shumë më e komplikuar. Në Kosovë ekziston një mendim i diferencuar kundrejt funksionimit dhe suksesit të KFOR-it në njërin anë dhe të Policisë ndërkombëtare në anën tjetër. I pari, është unik dhe i strukturuar, prandaj më funksional. E dyta, tepër heterogjene, deri më tash nuk ka arritur të ketë besimin e qytetarëve. Ajo është treguar e pazoja që të hetojë situatat dhe rastet më të ndieshme. Deri më sot, nuk është zgjidhur asnjë nga rastet e rënda kriminale të pasluftës në Kosovë. Tani kërkojnë ndihmë nga qytetarët dhe ankohen, por qytetarët për bashkëpunim duan besim dhe siguri. Çka kur krimi i prekë dëshmitarët – është pyetje pa përgjigje. Ju e patë që mbeti edhe sot.

Për të bërë parandalimin e krimit, për të ndjekur me sukses krimin duhet që strukturat vendëse të marrin kompetencat. Në Kosovë tanimë është domosdo që të krijohen e të strukturohen forcat e mbrojtjes e të sigurisë së vendit. Këto forca duhet të krijohen nga institucionet e Kosovës dhe të kenë kontrollë civile. Përndryshe, do të kemi edhe rrezikun tjetër që të bëhen ideologjike para se profesionale forcat tona të sigurisë dhe të mbrojtjes, që do të ishte tragjedi e re. Prandaj, policia vendëse, në bashkëpunim me policinë ndërkombëtare duhet të krijojnë edhe forca speciale, tash për tash po them, të zbulimit në shërbim të vendit dhe të qytetarëve.

Çka të bëjmë ne? Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues që çështjen e sigurisë në Kosovë e trajton si çështje ekzistenciale politike, do të merret me të gjithë fuqinë e kompetencave që ka dhe kërkon informim të përhershëm të strukturave të



ngarkuara për mbrojtje e për siguri, qofshin këto struktura të vendit apo ndërkombëtare. Partitë politike në Kuvend, po edhe ato jashtë tij, si organizime të mëdha politike, e kanë obligim që të deklarohen e të punojnë kundër dhunës e kundër krimit dhe për parandalimin e tij, shumë më tepër se deri më sot edhe në edukimin e anëtarëve dhe simpatizantëve të vet. Në këtë punë kërkohet edhe angazhimi i shoqatave tjera joqeveritare, e individëve e tjerë.

Qytetarët e Kosovës e kanë detyrë, por edhe domosdo të jetës, që të ndihmojnë e të bashkëpunojnë për parandalimin e dhunës dhe të krimit, të ndihmojnë me informata e dëshmi strukturat e sigurisë e të ndjekjes, sepse në këtë mënyrë sigurojnë lirinë individuale e kolektive. Një besim i forcuar ndërmjet institucioneve qytetare, do të priste hapësira të krimit dhe do të shtonte sigurinë. Shfaqjet kolektive publike kundër krimit, kur janë të mbushura afektivitet dhe nuk udhëhiqen nga toleranca, vetëvetiu mund të ndjellin krimin. Dhe, këtu duhet të kihet kujdes.

Mediat e shkruara elektronike në Kosovë, kanë përgjegjësitë e veta të mëdha për mënyrën e komunikimit lidhur me sigurinë dhe me krimin. Aq më të fortë duhet të jenë në denoncimin e dhunës e të krimit, që në shumë raste janë bërë edhe vetë viktimë e tij. Ato kanë përgjegjësi të informojnë e të mos paragjykojnë, të japin të dhëna para se të komentojnë dhe kjo është kujtoj detyra e një komunikimi të vërtetë me opinionin. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit, zoti Hamiti. E ka fjalën Fatmir Limaj.

#### **FATMIR LIMAJ:**

I nderuar zoti kreytar, të nderuar kolegë deputetë,  
Më në fund është bërë një hap i rëndësishëm dhe i mirë që përfaqësuesit e organeve kompetente për çështjen e sigurisë në Kosovë të vijnë para këtij institucioni kryesor të Kosovës dhe të informojnë mbi zhvillimet e një segmenti më të rëndësishëm për funksionimin e një shoqërie demokratike dhe ndërtimin e asaj shoqërie. Shpresoj se kjo do të bëhet një rregull dhe presim që kjo të bëhet një rregull dhe ata do të vijnë e të referojnë para organeve të Kosovës përderisa organet vendore nuk e kanë këtë kompetencë.

Segmenti i sigurisë, jo vetëm që është i rëndësishëm por është më kompleks sesa mendohet. Për institucionet e Kosovës, pjesë e së cilës jemi edhe ne, saherë të diskutojmë, duhet t'i kemi parasysh këto segmente të sigurisë:

1. Sigurimi i tërësisë territoriale të Kosovës,
2. Stabiliteti politik,
3. Stabiliteti ekonomik, dhe
4. Siguria individuale e çdo qytetari të Kosovës.

Për Partinë Demokratike të Kosovës, për Grupin parlamentar të Partisë Demokratike, këto katër shtylla jo vetëm që janë pika referimi, janë edhe qëllimi ynë i përhershëm. Padyshim se sigurimi i tërësisë territoriale të Kosovës është boshti kryesor i sigurisë brenda vendit. Nga ky segment varet stabiliteti politik, zhvillimi ekonomik dhe siguria e çdo qytetari të Kosovës.

Dështimet dhe mosbesimi i vazhdueshëm nga shoqëria në efikasitetin e policisë, nga njëra anë, dhe në anën tjetër, mosbesimi i vazhdueshëm në organet e gjyqësisë, lindja e grupeve anonime dhe deklaratimet herë-herë të pamatura politike nga institucionet zyrtare vendore dhe disa ndërkombëtare janë faktorë të mjaftueshëm për të goditur tri shtyllat më të rëndësishme të kësaj shoqërie:

1. Vetë shoqërinë;
2. Raportin ndërmjet partive politike; dhe
3. Përpjekjet tona të gjithëve të përbashkëta me komunitetin ndërkombëtar për ndërtimin e një shoqërie demokratike.

Aktorët dhe institucionet. Grupet kriminale janë dobësi e çdo shoqërie dhe shteti dhe shtetet me një demokraci të zhvilluar me një sistem shumë të zhvilluar, fatkeqësisht kanë probleme të tilla. Por fuqia vepruese e këtyre grupeve kriminale matet me reagimet dhe intervenimet e institucioneve brenda vendit. Këto grupe janë duke dëmtuar Kosovën, si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm, e sidomos që nga mesviti 1999.

Mungesa e ligjit në Kosovën e pasluftës dhe pastaj aplikimi i ligjeve të regjimit kriminal të Millosheviqit, ngecja në zbulimin e rasteve të njëpasnjëshme të dhunës, janë shfrytëzuar për veprim nga këto grupe kriminale, të cilat sot dalin edhe publikisht. Nëpër rrugët e Kosovës, fatkeqësisht, shetisin ende lirshëm shumë kriminelë të natyrave të ndryshme. Për shkak të mungesës së rezultateve në zbulimin e rasteve të korrupsionit, të kontrabandës, të veprimeve të tjera kriminale domosdo inkurajon grupet edhe për veprime të dhunshme, deri në vrasje.

Për të gjithë ne, është e njohur dhe gjithë e dijmë se Beogradi manipulon me të ashtuquajturin "argument" se pavarësia e Kosovës destabilizon rajonin. Nga këto deklaratatë të tyre fatkeqësisht mund të konkludojmë se është në interesin e tyre të vazhdueshëm një Kosovë e destabilizuar. S'ka dilemë se këto akte dhune, përfshirë edhe sulmin e mbrëmshëm në Stacionin e policisë në Pejë, i shërbejnë këtij orientimi për ta destabilizuar dhe për ta penguar Kosovën drejt ecjes dhe synimit tonë qytetar e

kombëtar. Fajtorët nuk kapen. Janë në liri, dhe çka është më keq, nuk zbulohen. Ne nuk dijmë motivet e tyre vepruese.

Në gjithë këtë proces, disa zyrtarë dalin me deklaratat politike të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në psikologjinë dhe sjelljen e grupeve të ndryshme brendapërbrenda shoqërisë sonë. Kjo gjendje, fatkeqësisht, po shfrytëzohet me mjeshtri nga disa media, të cilat me mjeshtrinë e shpifjes, akuzave, njollosjeve, duke luajtur rolin edhe të hetuesit, edhe të dëshmitarit, edhe të gjyqësisë, duke njollosur e akuzuar njerëz dhe ata shkojnë edhe më larg, bile-bile duke bërë ftesë edhe për konfrontim qytetar. Kjo është edhe një barrë e shtuar për këtë Parlament, për Parlamentin e Kosovës, që në fokusim ta ketë që të mos lejojë përçarjen ndërmjet grupeve politike dhe elektoratit. Shqetësimet e Parlamentit janë edhe rastet e vendosjes së atyre bombave në qytetet e ndryshme të Kosovës, eksplozivet në tempujt fetarë në prak të vizitave të ndryshme ndërkombëtare, deri te funksionimi i rregullit dhe ligjit në Mitrovicë, çështje këto për të cilat mungon përgjigja adekuate. Prandaj, Parlamentit i Kosovës, mendojmë në bashkëpunim me institucionin e PSP, zotin Shtajner dhe me UNMIK-un në tërësi duhet të marrë një qëndrim i cili do të mundësojë futjen në agjendë sigurinë, si angazhim i përbashkët i institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Për sigurinë Parlamenti duhet të marrë një qëndrim të ri politik.

#### **Cilat janë mundësitë e Parlamentit të Kosovës, i institucioneve tona në krejt këtë?**

Ne mendojmë se inkuadrimi i institucioneve vendore në formulimin dhe implementimin e politikave të sigurisë është çështje të cilën duhet ta shfrytëzojë zoti Shtajner si vullnet të mirë dhe gatishmëri të vendorëve për angazhim të përbashkët në këtë lëmi. Sepse, qëndrimi politik për ruajtjen e ekskluzivitetit në çështjet e sigurisë na lajmërohen si vendim jo i qëlluar. Realizimi i standardit të sigurisë është një prej prioritetëve të përbashkëta institucionale. Luftën kundër krimit duhet ta ndajmë së bashku përderisa pasojat i paguan Kosova. Aktivizimi i Qeverisë në çështjet e sigurisë së brendshme do të prodhonte rezultatet e veta pozitive.

Mundësia e dytë, për t'i afruar dhe që duhet t'a ofrojmë institucioneve ndërkombëtare është krijimi i një komisioni të veçant parlamentar, i cili do të mundëson angazhimin e deputetëve me qëllim të krijimit të kontaktit sistematik të vazhdueshëm në mes të Parlamentit dhe organeve kompetente të sigurisë.

Të nderuar kolegë deputetë, në Kosovë ka pasur shumë incidente e vrasje enigmatike, që kanë shkaktuar huti e dezorientime politike, që na kanë detyruar shpesh ta humbim arsyen, ndonjëherë duke akuzuar njëri-tjetrin edhe mbi bazën e paragjyqimeve. Politikanët e përgjegjshëm nuk guxojnë të udhëhiqen nga inatet. Ata duhet t'i peshojnë fjalët, t'i analizojnë rrethanat me gjakftohtësi e urtësi. Ne kemi detyrë t'i bashkojmë qytetarët, sepse të ndarë e të diferencuar ishim mjaft në të kaluarën, e cila është e freskët dhe tepër e hidhur. Populli ynë ende i ka varret e hapura, të rejtat nuk na duhen.

Dhe, si përfundim. Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dënon çdo formë të krimit, çdo tendencë për të politizuar nga krimi, për të përfutur nga krimi si dhe terrorin medial dhe politik që po i shërben fatkeqësisht kësaj politike të djallit.

Ne kërkojmë që bashkërisht, duke ndihmuar organet kompetente, të identifikojmë këtë qendër të krimit. Dhe, në fund, ne i bëjmë thirrje edhe qytetarëve të Kosovës, që së bashku t'i ndihmojmë organet kompetente për të krijuar një ambient të sigurtë për të gjithë ne. Kjo polici është e Kosovës dhe punon për ardhmërinë e fëmijëve tanë dhe ne si Parlament duhet të jemi të gatshëm t'i marrim përgjegjësitë tona që në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar ta krijojmë një stabilitet, ta krijojmë një ambient të sigurtë si kusht i domosdoshëm për t'i realizuar aspiratat tona kombëtare.

Shpresoj se është moment i fundit ku të gjithë së bashku, edhe ne, ta demonstrojmë fuqinë e gatishmërinë tonë për të luftuar këto krime sepse është edhe moment i fundit ku askush më nuk mund ta durojë një gjendje të tillë, pavarësisht kush dhe sa është dëmtuar. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACHI:**

Ju falemnderit. Zoti Ramush Haradinaj e ka fjalën.

#### **RAMUSH HARADINAJ:**

Zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë fjalë nuk do të përsëris ato që ju i thatë dhe për të cilat do të dakordohem. Ne jemi sot dëshmitarë kur në Parlamentin e Kosovës po diskutojmë për një çështje dhe kur para nesh prezentuan përgjegjësit institucional të këtyre temave ose të kësaj teme që ne e trajtuam, zoti Jean Caddy dhe zoti Feller, të cilët ne paraprkasht i falënderojmë për punën në institucionet që ata udhëheqin dhe kanë bërë në Kosovë dhe natyrisht meritat më të mëdha i kemi ne, populli i Kosovës, për këto të arritura të përbashkëta.

Në këtë fjalë unë do të dëshiroj në radhë të parë të prezentoj para jush pamjen e krijuar jo vetëm gjatë eksperiencës sime jetësore tash disa vjet pas konfliktit në Kosovë, por sidomos edhe nga kjo seancë. Çka bëjmë ne për vete, populli i Kosovës, njerëzit e zgjedhur dhe a domë ne me dalë prej këtu dhe a kemi ne objektiv ku domë me mbri. Dëshiroj, në radhë të parë, të theksoj që situata të përmirësohet në Kosovë dhe kjo e arritur ose ky sukses i krijuar në Kosovë, qysh u shpreh, në radhë të parë nga ne vetëm të shërbehemi në këtë realitet vetëm si themel. Pra, të ndërtojmë atë që synojmë ne, që të ndërtojmë diçka për vete në siguri dhe në rend, në radhë të parë sikur për shumë çështje që jemi ra dakord si popull, duhet ta ndërtojmë një platformë tonën vendore, e cila përfaqëson në një mënyrë interesin tonë, në këtë rast nuk po llogaris vetëm në interesin e grupeve apo të meseve politike, por edhe interesin si popull, edhe të pakicave, çfarë ne synojmë me arritur në Kosovë. Kjo platformë, më së miri dhe më suksesshëm do të ndërtohej pikërisht nga Parlamenti i Kosovës dhe një platformë e këtillë do të duhej të përmbante me vete elementet e nevojshme dhe elementet kohore, por edhe instrumentet se si ne mund të shkojmë më tutje, se si ne mund të dalim përpara.



Andaj, mendimi im është, duke përsëritur se diskutimet kanë qenë shumë të dobishme dhe që kanë ardhur në shprehje shumë çështje që na preokupojnë ne, ne nuk guxojmë të ndalemi në këtë rrafsh para vetes dhe para nesh, por duhet ta nxjerrim një objektiv tonin, të Kosovës, të Parlamentit dhe të institucioneve vendore. Cili kishte me qenë ky objektiv? Në radhë të parë, ne duhet të kompletojmë institucionet tona, edhe me ministrinë që do t'i trajtonin këto çështje. Këto ministri, do të duhej të punonin nga një platformë, pra nga një plan pune, i dalur nga Parlamenti dhe po ashtu do të duhej të mbështeteshin nga ne sikur edhe me angazhimet tjera, të cilave ne iu japim mbështetje, pa dëshiruar në këtë mënyrë me përjashtuar ose mohuar kontributin dhe ndihmën që japin bashkësia ndërkombëtare përmes mekanizmave të vet.

Do të dëshiroja që nga kjo seancë, në vend që ne edhe më tutje ose në vazhdimsi të shohim të vërtetën që po na ndodh në Kosovë, të kuptojmë në një mënyrë se a mos ne jemi vetëm spektatorë, jemi në pozita kur dëgjojmë fjalime dhe ku duhet të dënojmë dhunën dhe pse edhe ne, si popull, në rajon por edhe si njerëz që jemi nuk kemi të drejtë që të jemi pjesë e ndërtimit të një rendi dhe sigurie në Kosovë edhe më efektshëm, e jo sikur që na ka ndodh deri tani.

Pra, mendimi dhe propozimi im është se mënyra si duhet të ndërtojmë për vete, është duke patur besim në njëri-tjetrin, duke mos iu friksuar njëri-tjetri për shkak të një pakënaqësie ose partiake apo etnike në Kosovë, të ndërtojmë grupe me përbërje ose me përfaqësim të gjerë dhe të kërkojmë përgjegjësinë për këtë.

Shpresoj se Parlamenti i Kosovës edhe rendin e sigurinë do ta kuptojë edhe si një prej segmenteve, që ne kemi politikën jo aq të favorshme në Kosovë, që kemi situatën ekonomike jo aq të kënaqshme në Kosovë ose të rëndë dhe në rënie, atëherë ta kërkojmë zgjidhjen duke marrë përgjegjësinë mbi vete dhe duke pranuar për t'u përballë me sfidat që kemi, pra na funksion të daljes prej këtu. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Fjalën e ka Kolë Berisha, le të përgatitet zoti Emin Krasniqi.

#### **KOLË BERISHA:**

I nderuar kryetar dhe Kryesi, të nderuar kolegë deputetë,  
Ka një kohë relativisht të gjatë që edhe ne vendorët por edhe ndërkombëtarët jemi ngutë të konstatojmë se gjendja e sigurisë në Kosovë është e mirë. Bile kemi shkuar aq larg sa që kemi deklaruar se Kosova është vendi më i sigurt në rajon. Deklarata të tilla kemi dhënë të gjithë, ndoshta nga dëshira që vërtetë të jetë e tillë dhe ta promovojmë sa më parë para botës një të arritur shumë të madhe, një ndër standardet më të rëndësishme, dhe mos më i rëndësishmi, sigurinë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Kujtoj se të gjithë pajtohem me konstatimin se në Kosovë, në krahasim me vitet e mëparshme, viti 2002 shënon shkallë të rënies së krimit në 50%. Por mos.... nuk hyn,

thotë populli. Statistikat zyrtare thonë se gjatë kësaj periudhe katërvjeçare të pasluftës në Kosovë janë vrarë rreth 900 njerëz, që do të thotë se kemi ardhur tani në pikën ku edhe po të donim nuk mund të fshehim realitetin tragjik.

Nuk jam njeri i aferave ose i alarmeve, por në kohë paqeje, në një vend kaq të vogël, por të lirë siç është Kosova, me rreth 10 mijë policë ndërkombëtare dhe vendorë, pothuajse për çdo kilometër katror nga një polic, me mbi 40 mijë ushtarë të KFOR-it, me institucione vendore dhe ato ndërkombëtare – të dy niveleve, me kaq shumë parti politike, me plotë gojën demokraci, ligj, rend e qetësi dhe me kërkesën aq të natyrshme për pavarësinë e vendit të vriten rreth 900 njerëz në një periudhë prej katër vjetësh është më tepër se shokante. Vetëm brenda pak më shumë se 2 muajsh u vranë 6 vetë. Më 27 tetor të vitit të kaluar vritet një personalitet i njohur publik, kryetari i Komunës dhe i Degës së LDK-ës në Therandë dhe dy përcjellësit e tij. Ndërkaq, dy muaj më vonë, më 4 janar të këtij viti, vritet një tjetër figurë, gjithashtu publike, bashkë me të birin dhe kushëririn e tij. Një veprimtar i anës së Dukagjinit, këto ditë deklaroi se nga vrasja e fundit në Pejë, fshatra të tëra të atij rajoni jetojnë në ankth të plotë dhe panikë të thellë. Dhashtë zoti të mos jetë ashtu. Por, me këtë trend tragjik, Kosova po e humbë lirinë e fituar me gjak. Kosovës po i vritet liria dhe nëse vazhdon kështu Kosovës po i vritet e tashmja dhe ardhshmjia e saj. Në Kosovë po vriten njerëzit e thjeshtë, por po vriten edhe personalitete të njohura publike. Po vriten veprimtarë të paepur të çështjes kombëtare, po vriten edhe kryetarë komunash, po vriten ata që nuk morën pjesë në luftë por po vriten edhe ata që, jo vetëm morën pjesë në luftë, por edhe udhëhoqën një pjesë të saj ose krejt luftën. Po vriten ish ushtarët e lirisë, por po vriten edhe ushtarakë, po vriten gazetarë, publicistë, shkrimtarë, arqitektë të rrallë, si dhe shumë të tjera figura publike. E mbi të gjitha, në Kosovë po vritet njeriu.

Heminguei thotë “Vdekja e secilit njeri mua më zvogëlon” andaj edhe këto raste të vrasjes, edhe këto vrasje që ndodhën gjatë kësaj periudhe të pasluftës, ku në shumicën absolute të rasteve, viktimat janë shqiptare, jo vetëm që na shqetësojnë por edhe secilin prej nesh, edhe si individ, edhe si shoqëri kosovare, na zvogëlojnë dhe na turpërojnë tejmase në çdo aspekt.

Në një tjetër kohë dhe në rrethana krejtësisht tjera, ndoshta nuk do të ishte me rëndësi se si do të kualifikoheshin këto vrasje, sepse këtë do ta bënin organet e ndjekjes dhe do të mjaftoheshin vetëm me konstatimin e dhembshëm se në Kosovë ka krim. Por, në rrethanat që i trashëguam si pasojë e okupimit klasik, si dhe në këto që u krijuan më vonë, çdo veprim, çdo dukuri dhe çdo fenomen, deshëm ne apo nuk deshëm, gjithësesi merr ngjyrimë politike dhe prodhon efekte po ashtu politike. Në këto rrethana të krijuara në Kosovë, edhe veprimet e Nënës Terezë po të ishte gjallë – do të merrnin konatacione politike, edhe me vrasjen e 900 njerëzve, një pjesë e të cilëve ishin personalitete publike në Kosovë.

Më duhet të them se pamundësia për t'i kapur dhe vënë para gjyqit, para drejtësisë ekzekutuesit e përmes tyre pastaj edhe vendimmarrësit dhe urdhërdhënësit, po pse jo

edhe financuesit e tyre, jo vetëm që ka krijuar kushte solide që kjo orkestër kriminelësh të vazhdojë edhe më tutje me vrasje të njëpasnjëshme por edhe të krijojë hapësirë të bollshme për dyshime, për sypozime, për spekulime, për paragjykime, për prejudikime, për këmbim akuzash dhe kundërakuzash ndërmjet grupeve dhe grupacioneve të caktuara politike, madje edhe me kërcnime ndaj individëve të caktuar e deri në thirrje të hapta në Kanun ose në nxitje të qytetarëve për të dalur në rrugë.

S' domend duke qenë se problemi për të cilin po debatojmë sot në këtë Kuvend është shumkompleks dhe shumdimensional dhe si i tillë ai reflekton nga shumë aspekte, na obligon që sot ne, pa kurrfarë ngarkesash, pa kurrfarë paragjykimesh, pa kurrfarë kompleksesh dhe pa kukrrfarë pretendimesh se po e themi fjalën e fundit aq më pak të ndikojmë në punën e organeve të ndjekjes, të debatojmë haptas për këtë dukuri tragjike, për këtë gangrenë që po dëmton substancën tonë kombëtare, që po zhvarrit proceset zhvillimore të cilat shoqërojnë pjesën tonë edhe ashtu të brishtë drejt realizimit të aspiratave shekullore, pra drejt pavarësisë së vendit.

Së këndejmi, diskutimet tona sot, të cilat në fakt paraqesin pikëpamjet tona, ose këndvështrimet tona mbi këtë dukuri, duhet kuptuar jo si adresim i fajit në njërin apo tjetrin individ apo subjekt politik, sepse këtë herët a vonë fjalën përfundimtare do ta japin organet kompetente por si përpjekje që, duke iu qasë kësaj dukurie edhe nga aspekte të ndryshme, të japim kontributin tonë sado mosdest në ndërprerjen ose së paku në rënien respektivisht në zvogëlimin e përmasave të këtij trendi që ka sot kjo mortajë e zezë.

Pajtohem me atë se vërtetë ne duhet të jemi të matur dhe nuk duhet të ngutemi në kualifikime apriori se këto vrasje janë politike. Por, unë kujtoj se ne gjithashtu duhet të jemi të matur e të mos ngutemi as me kualifikimin gjithashtu apriori se gjoja asnjë prej këtyre vrasjeve nuk është politike. Edhe njërit edhe tjetrit kualifikim mund t'u bëhen vërejtje nga aspekti i efektit që prodhojnë, nga reflektimet që kanë por edhe moshtuarja për trajtim i këtij problemi ose këtij fenomeni tragjik në strukturat politike dhe shtetërore të Kosovës me motivacionin se duhet pritur rezultatet e organeve ndjekëse e pastaj të ulemi dhe bisedojmë për këtë problem si dhe ngurrimi që këto vrasje të quhen me emrin e tyre të vërtetë ka për pasoja trimërimin dhe stimulimin e krimit, ndërkaq kryerësit e këtyre veprave kriminale nuk do ta andiejnë vetën fare të rrezikuara.

Prandaj, unë kujtoj se pavarësisht nga ajo se për ndriçimin e këtyre vrasjeve janë duke u zhvilluar hetimet nga organet kompetente të ndjekjes, strukturat politike dhe ato shtetërore të Kosovës siç është ky Kuvend, pastaj Qeveria dhe Presidenca, kanë jo vetëm të drejtë por edhe obligim që të debatojnë, të analizojnë dhe pastaj të japin kualifikime dhe të marrin qëndrime lidhur me këtë dhe me dukuri të tjera që shfaqen në shoqërinë tonë kosovare.

Ne edhe si Kuvend, edhe si Qeveri, edhe si subjekte politike nuk bëjmë kualifikime juridike, nuk nxjerrim aktgjykime dhe nuk do të provojmë të jemi prokurorë, avokatë apo gjykatës, por të mirremi me një segment mjaft të rëndësishëm të politikës së gjithmbarshme, me segmentin e sigurisë në Kosovë ose në aspektin politik të sigurisë në Kosovë.



Arsyetimet se duke ua dhënë karakterin politik këtyre vrasjeve po inkriminojnë Kosovën dhe po ia japin një imazh të keq Kosovës para botës nuk qëndrojnë, nga se imazhin e Kosovës nuk mund ta ruajmë duke fshehur realitetin sepse bota është këtu dhe ajo sheh, vëren, inçizon, regjistron, fotografon, nënvizon dhe vlerëson çdo gjë, madje edhe atëherë kur ne fare nuk dijmë ose nuk i njohim fenomenet që rrjedhin pas nesh. Në të vërtetë imazhi i Kosovës ruhet duke i luftuar këto dukuri të shumtuara të realitetit tonë. Ne nuk mund të themi se nuk është vrarë kryetari i Nëndegës dhe anëtari i Kryesisë së Degës në Skenderaj, profesori Haki Ymeri; ne nuk mund të themi se nuk është vrarë njëri ndër themeluesit, kryetari shumvjeçar i Degës së Burimit e anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Shaban Maraj; ne nuk mund të themi se nuk është vrarë këshilltari për informim i kryetarit Rugova Xhemajl Mustafa; se nuk është vrarë kryetari i Degës së LDK dhe i Komunës së Klinës Ismet Raci; apo komandant Drini, apo Komandant Murrizi, gazetari Shefki Popova, kryetari Ukë Bytyqi dhe dy përcjellësit e tij, komandanti i UÇK e njëherit edhe deputet në Parlamentin e Kosovës Smajl Hajdaraj, koloneli Tahir Zemaj bashkë me të birin dhe kushëririn e tij dhe të tjerë si këta. Madje, ata nuk vdiqën në ndonjë incident komunikacioni, nuk u vranë në ndonjë kafene të dehur nga alkooli, apo duke u kacafytur me ndonjë qytetar të zakonshëm, nuk u vranë as për megjë, as arë, as për livadh, as për ujë të pijës apo të ujitjes, as për dru mali, por u vranë ose duke hyrë në banesë, ose duke dalë nga banesa, ose u kidnapuan në mënyrë më qyqare dhe u dërguan në ekzekutim e pastaj në djegie të kufomës, ose duke kremtuar fitoren në zgjedhje, ose duke i kryer punët e përditshme dhe u vranë në kohën kur kryenin funksione publike. Ata ishin figura publike të cilët ose kishin fituar besimin e popullit nga vota e lirë dhe demokratike – pra ishin deputetë, kryetarë komunash atje, ose ushtarakë apo luftëtarë të lirësë – pra ishin përfaqësues të pushtetit ose të subjektit politik apo ushtarak. Fundi i fundit, ata ishin njerëz.

Edhe diçka. Është vërtetë cinike të shërbehemi me numra e edhe më shumë cinike është të merremi me statistikë në aspektin e përkatësisë politike apo ideologjike të të vrarëve. Por, në trajtimin e këtij fenomeni tragjik realiteti na imponon edhe këtë aspekt të vështrimit të tij. Dhe, në këtë kontekst, duhet kuptuar edhe disa paraqitje publike sepse kur humb malli humb edhe shpirti, thot populli. Dhe, nëse duhet të flitet se kush ka pësuar më së shumti nga këto vrasje, realisht duhet të thuhet se, pos familjarëve të të vrarëve, dhe vetë Kosovës, respektivisht imazhit të saj në botë, – këto vrasje më së shumti e kanë goditur LDK-ën si parti sepse humbi disa nga shtyllat më të forta të strukturave të sajë organizative.

Prandaj, ne sot dhe pas sotit, duhet të angazhohemi sa më tepër, jo vetëm që të bjerë ky numër i vrasjeve por të eliminohet krejtësisht. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI NEXHAT DACI:**

Ju falemnderit. Zoti Emin Krasniqi, le të bëhet gati Naim Maloku. Një lutje, janë më tepër se 20 të paraqitur dhe në qoftë se nuk e respektojmë bile Rregulloren, sipas të cilës



2 deri në 5 minuta, do të zgjasë 3 ditë kjo dhe pa qëndrime do të dalim. Prandaj, ju lus të keni konsideratë. Urdhëroni Emin.

### **EMIN KRASNIQI:**

I nderuar kryetar dhe Kryesi, të nderuar kolegë, ju përshëndes.  
Duke pasur parasysh vetë formulimin që është bërë – Shqyrtimi i situatës së përgjithshme të sigurisë në Kosovë, na jep të drejtë secilit për t'iu qasur nga këndi i aspekteve të ndryshme e tjera. Kam parasysh edhe vërejtjen e kryetarit tani që bëri.

Disa kahje aspektore për sigurinë në Kosovë:

#### **1. Siguria si aspekt jetik jetësor**

Në terminologjinë e të shprehurit, asnjë nocion tjetër nuk krijon asociacion sa nocioni siguri, madje edhe pa atributete të mundshme që përkufizojnë objektivat e interesave në konstelacionet ekzistuese të kontekstit global rajonal e vendor. Problematika e vënë në spikamë për debat publik kërkon nga të gjithë ne qasje me përkushtim të lartë moral, intelektual, politik e profesional. Sepse, fillet e ndërtimit dhe të zhvillimit stabil politik, ekonomik, kulturor e tjerë jo vetëm në shoqërinë tonë moderne por në të gjitha etapat e zhvillimit të shoqërive të secilit popull dhe popull shtet varen kryesisht jo nga raportet e drejta të ndërsjella por nga interesat e përkufizuara qartë për zhvillimet e brendshme dhe nivelet e konstelacionit global, rajonal e vendor.

Prandaj, duke qenë se është interes yni, i Kosovës, i rajonit dhe më gjerë, në këtë aspekt me rëndësi jetike edhe për jetën tonë institucionale të jemi joimplikues infantilë por participues në kontekst të sigurisë së Kosovës dhe rajonit. Dihet pra se edhe popujt që kanë shtete të tyre të forta nuk mund të krijojnë kushte dhe rrethana krejtësisht të pavarura sigurie për shtetasit e vet jashtë konteksteve rajonale e vendore.

#### **2. Siguria si segment (institucional) – në kllapa.**

Siguria si njëri prej segmentëve më të ndjeshëm dhe njëkohësisht më të rëndësishëm të çdo shoqërie qoftë shtet, qoftë administrim ndërkombëtar çfarë është Kosova përkohësisht, në kontekstin tonë e mbetur jashtë kompetencave të institucioneve vendore si e drejtë e rezervuar e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara me Rezolutën aq-kaq dhe Kornizën kushtetuese, duke pasur parasysh edhe vlerësimet për situatën në Kosovë të diplomatëve evropian e amerikan dhe kërkesat e tyre për transferimin e kompetencave, duke u mbështetur në kriteret e qëndrueshme të partneritetit për paqë e siguri e me anën e një kooperimi subordinues, gradualisht duke qenë bashkëpjesëmarrës aktiv në ndërtimin dhe zhvillimin e institucioneve - të jemi edhe bashkëpërgjegjës për këtë segment institucional.

Akseologjitë dhe revalorizimet që rrjedhin pas respektimit të procedurave hetimore të policisë dhe gjyqësore të gjykatave, nuk kanë arritur të krijojnë preventivë parandalimi të krimit e as tregues stimulativë për ndriçim të rasteve të jashtëzakonshme të krimit.

Prandaj, për ndriçimin, evitim dhe marginalizimin e çdo lloj krimi në Kosovë, parapëlqejmë këto:

### REKOMANDIME

1. Që, sikur në segmentet tjerë të jetës sonë institucionale, edhe në këtë fushë, të jemi përgjegjës a bashkëpërgjegjës në vjeljen, përpunimin dhe vlerësimin e informacionit;
2. Që në kuadër të Kuvendit të Kosovës të krijohet një komision parlamentar që nuk bie ndesh me Rezolutën 1244 dhe Kornizën kushtetuese, i cili për angazhimet, natyrës dhe rezultatet e punës do t'i referohej Kuvendit;
3. Që në kuadër të Qeverisë të krijohet një zyrë-dhomë e cila do të duhej t'i përgjigjej Qeverisë – kryeministrit, ose
4. Që pranë Zyrës për siguri të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të propozohet një grup këshilltarësh, i cili do të koordinonte levat me Zyrën për siguri të Përfaqësuesit Special dhe institucioneve përkatëse. Ju falemnderit.

### KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Naim Maloku.

### NAIM MALOKU:

Zoti kryesues, të nderuar deputetë,  
Seanca e sotme është një seancë e veçantë ku ne si Parlament dhe si deputetë të këtij Parlamenti debatojmë për një çështje që na intereson të gjithëve dhe neve si Parlament, si deputetë por edhe qytetarëve në përgjithësi. Më lejoni të them se nuk është e tepërt nëse konstatoj se në bazë të mënyrës, formës dhe natyrës së kryerjes së krimeve në kohën e fundit, e kam fjalën për vrasjet enigmatike, tentimvrasjet, rrëmbimet dhe montimet e bombave, krimi në Kosovë po merr një formë tjetër, po merr formën e krimit të organizuar, sepse këto veprime dhe këto akte kriminele në këtë formë dhe mënyrë nuk mund të kryhen pa pasë një bazë të fortë të organizimit dhe pa qenë krim i organizuar. Pra, Kosova po hyn në një fazë e cila duhet të na shqetësojë edhe si Parlament, por që është fazë shqetësuese edhe për krejt qytetarët e Kosovës. Këtë desha t'ia kundërvëj statistikave që ne i dëgjuam për uljen e vrasjeve, krimeve dhe të tjerat në Kosovë. Pra, fakti se në Kosovë po ndodhin forma shqetësuese të krimit, të cilat duhet të jenë shqetësuese edhe për organet dhe institucionet përgjegjëse që kanë marrë mbi vete luftimin e krimit dhe që kanë marrë mbi vete sigurinë në Kosovë.

Çka mund të bëjmë ne si Parlament? Duhet t'i drejtohem si Kuvend qytetarëve të Kosovës për ndihmë. Ndihma më e madhe mund të vjen nga vetë qytetarët e Kosovës. Të

vetëdijësohen dhe kurrë mos ta marrin që një akt kriminal që i ndodh dikujt nuk mund t'i ndodhë edhe atij nesër. Pra, të jemi të shqetësuar të gjithë dhe të jemë unik në izolimin e pistave nga të cilat kryhen këto krime. Duhet t'i dënojmë fuqishëm, jo si kryesues të Parlamentit, por tani si Parlament të gjitha aktet kriminale që kanë ndodh qoftë ndaj qytetarëve të Kosovës, pronës së tyre apo së fundi, që është edhe shumë tragjike, ndaj pjesëtarëve të policisë së UNMIK-ut, pjesëtarëve të atyre shteteve të cilat kanë ardhur këtu në Kosovë për të na ndihmuar që ne të kalojmë këtë fazë të paskonfliktit më lehtë dhe të krijojmë një shoqëri të sigurtë.

Më lejoni të propozoj që ky Parlament të autorizojë Kryesinë e Parlamentit, Qeverinë e Kosovës dhe Presidencën që në kontaktet me UNMIK-un dhe bashkësinë ndërkombëtare dhe të gjitha qendrave vendosëse për Kosovën të punojnë në këto fusha për marrje më të shpejtë të kompetencave të vendoret, pra të institucionet e Kosovës edhe në këto lëmi: për sigurinë në Kosovë dhe luftimin e krimit; që të punojmë që faktori ndërkombëtar të na konsiderojë, edhe Parlamentin, edhe Qeverinë, edhe Presidencën, si partnerë edhe në kryerjen e atyre kompetencave që i kanë marrë si të rezervuara. Nuk mundemi në Kosovë të kemi kompetenca paralele ku një palë apo një pjesë e institucioneve nuk ka fare të bëjë me atë pjesën tjetër, sepse këto ndërlihen. Mos të hyj tash në shpjegimin se si ndërlihen edhe zhvillimi ekonomik edhe siguria, atë që thanë parafolësit para nesh. Pra, t'i ofrohem institucioneve të Kosovës si partnerë institucioneve të UNMIK-ut dhe atyre që kanë rezervuar këto kompetenca për luftimin e krimit.

Më lejoni ta them edhe një fakt se Shërbimi Policor i Kosovës deri më tani është aftësuar vetëm për veprimet pas ndodhjes së konfliktit, pas ndodhjes së aktit kriminal. Pra, të gjitha ato veprime që çojnë deri te arrestimi dhe dorëzimi para drejtësisë të aktorëve të këtyre krimeve. Janë një mori veprimesh tjera që quhen parandaluese që Shërbimi Policor i Kosovës nuk është duke u aftësuar dhe as segmentet vendore të Kosovës nuk janë duke u aftësuar për veprimet që parandalojnë krimin, pra parandalojnë aktin kriminal e ato veprime janë kompetenca, qysh doni quani – shërbime intilegjente, shërbime informative, shërbime sekrete e tjera e tjera, por në segmentet e tilla në Kosovë nuk janë duke u ngritë në vendore. Pa ato shërbime nuk mundet një shoqëri t'i zbulojë pistat nga të cilat organizohen këto krime. Thash, jemi në fazën e fillimit të shfaqjes së krimeve të organizuara në Kosovë, e kjo duhet të na shqetësojë. Pa segmente të tilla të sigurisë nuk mundemi t'i zbulojmë ato pista nga të cilat organizohen, nuk mundemi me të hulumtimin dhe parandalimin e këtyre veprave kriminale, që janë veprime të cilat i duhen shoqërisë sonë. Përndryshe, në qoftë se vendorët nuk janë këmbëngulës për t'i bindë faktorët ndërkombëtarë se kjo kompetencë e krijimit të kësaj shtylle të rëndësishme për shoqërinë tonë nuk ka të bëjë me statusin final të Kosovës. Kam përshtypjen se kjo shtyllë nuk u lejua për shkak se këtë e kanë vetëm shtetet e pavarura, pra për mos ta prejudikuar statusin përfundimtar të Kosovës. Kemi të bëjmë me sigurinë e qytetarëve të Kosovës dhe kjo nuk ka të bëjë me statusin. Pra duhet të krijohet ky mekanizëm, përndryshe qytetarët e Kosovës do të lajmërojnë segmente të ndryshme të cilat do t'i marrin vetë në duart e veta këto punë dhe pastaj do të shkaktojnë edhe më tepër huti dhe komplikime në vetë shoqërinë tonë.

Dhe, në fund, kam përshtypjen që segmentet që merren me luftimin e krimit, pra segmentet e UNMIK-ut po hezitojnë të thonë edhe të vërtetën. Më lejoni të them, kjo është përshtypje imja personale. Pra, ekzistimi i 39 shërbimeve inteligjente në Kosovë, nga 39 shtete që janë në kuadrin e KFOR-it dhe të mos zbulohen pistat e këtyre krimeve apo veprimeve, më duket e palogjikshme.

I bëj thirrje Kryesisë së Kuvendit, Qeverisë, Presidencës që të kërkojnë nga organet e UNMIK-ut që pavarësisht ku gotitet në Kosovës, qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të jenë drejt të informuar dhe të dijnë të vërtetën. Pra, të mos ketë hezitime apo fshehje të fakteve në mënyrë që mos të dëmtohet apo ku ta dij unë mos të prishet ndonjë qetësi politike apo ekuilibër politik në Kosovë.

Dhe, në fund, ndoshta e zgjata pak më tepër por kisha dashur të them edhe një – bërja me gisht pa argumente të fuqishme dhe drejtimi i gishtit kujtdoqoftë si individ apo parti politike, në njëfarë mënyre është edhe krim. Çka në qoftë se nuk është ashtu. Pra, çka në qoftë se nuk është e vërtetë e nëse e drejton dikush gishtin nga dikush. Duhet të jemi përgjegjës edhe për këtë. Akuzimi pa bazë, akuzimi pa fakte, akuzimi pa argumente – edhe ajo është krim dhe mos të bëjmë ne vetë krime. Akuzimet duhet të shkojnë te organet e drejtësisë dhe së bashku me ta të merremi vesh se çka duhet të dalë opinion. Ju falemnderit.

## **NË VAZHDIM SEANCËN E KRYESOI BAJRAM KOSUMI, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT.**

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit zoti Maloku. Të nderuar deputetë, para se ta marrë fjalën folësi i ardhshëm, t'ju njoftoj me dy fakte. Së pari, unë këtu kam listën prej mëse 20 folësve që kanë kërkuar fjalën dhe nëse shkojmë deri në fund ne nuk mund të arrijmë ta kryejmë sot. E dyta, kryetarët e grupeve parlamentare, në takimin që kanë pasur me kryetarin e Kuvendit, janë marrë vesh që të përgatisin një dokument nga ky diskutim. Prandaj, unë po ju ftoj – ata që kanë të shkruar fjalimin, mund ta dorëzojnë këtu dhe ajo pastaj të mirret në shqyrtim gjatë përgatitjes së dokumentit dhe të mos diskutojnë fare. Ose, ndonjë që nuk ka ndonjë ide të re të shtojë, të heqë dorë prej diskutimit. Ju falemnderit. Në radhë është Alush Gashi, le të përgatitet Sabile Basha.

### **ALUSH GASHI:**

I nderuar kryesues,  
Dhuna është në kundërshtim të plotë me përcaktimin e qytetarëve të Kosovës dhe për këtë besoj nuk ka dyshim. Gjendja e sigurisë, e shëndetit dhe arsimit janë një nga preokupimet kryesore në çdo shoqëri, ashtu edhe në atë kosovare. Shumica dërmuese e qytetarëve të Kosovës është zotuar për mbrojtje dhe garantim të të drejtave njerëzore dhe



fuqimisht e kundërshton shkeljen e tyre. Andaj, dhuna është në kundërshtim të plotë me përcaktim të qytetarëve të Kosovës. Me këtë rast përkujtoj se qytetarët e Kosovës dhe institucionet demokratike i janë shumë mirënjohës Aleancës Veriatlantike dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për ndalje të gjenocidit, si dhe për kontributin e dhënë për ndërtim të institucioneve demokratike, transparente dhe të përgjegjeshme. Por krahas falënderimit, është edhe kërkesë e fuqishme për angazhim më të theksuar në lëmitë e rezervuara deri në transformimin e plotë të tyre te institucionet vendore.

Qytetarët e Kosovës janë të përcaktuar fuqimisht për kultivim të paqës, lirisë, shtetit juridik dhe prosperitetit ekonomik në Kosovë të pavarur dhe demokratike dhe shpresoj se këtë do ta bëjmë sipas normave demokratike të kohës në të cilën jetojmë. Andaj, mirëkuptimi i bashkësisë ndërkombëtare për njohje të rezultateve tona demokratike është me rëndësi të posaçme. Është dashur shumë punë dhe mençuri për të arritur që Kosova të kuptohet më mirë aty ku ekziston vullneti për dëgjim. Pra, ende janë dyert e hapura për gjetje të mundësive për vetëvendosje dhe sovranizim vendor të Kosovës. Por prania e dhunës në Kosovë dëmton besimin në aftësi për marrjen e përgjegjësive vendore dhe atyre të jashtme. Indiferenca eventuale ndaj dhunës paraqet vështirësi në komunikim me përfaqësues të botës së lirë, pavarësisht se nga kush bëhet dhe ndaj kujt bëhet dhuna në Kosovë. Nga ne kërkohet që mos të jemi indiferentë ndaj proceseve e në veçanti ndaj atyre proceseve të cilat e vënë në pikëpyetje ardhmërinë politike dhe ekonomike. Andaj edhe nuk jemi indiferentë ndaj dhunës. Jemi shumë të angazhuar për të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të paqës në këtë pjesë të botës. Por çuditërisht demonstrimi ynë për angazhimin tonë në këtë proces jorrallë interpretohet si konflikt e jo si vullnet për marrje të përgjegjësive.

Kërkojmë që të na jipet mundësi që në rrugë institucionale të bëhemi pjesë e komunikimit me jashtë që edhe ne të kontribuojmë në shpjegim të nivelit të dhunës. Është koha që nga tretmani i objektit të bëhemi subjekt në siguri dhe politikë të jashtme.

Është e nevojshme që përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës të jenë pjesëmarrëse në të gjitha takimet të cilat Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i zhvillon në emër të Kosovës, në mënyrë që të ushtrohemi dhe të jemë dëshmitarë të korrektesisë së interpretimit të realitetit dhe të synimeve të qytetarëve të Kosovës. Ju falemnderit zoti kryesues.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit zoti Gashi. Në radhë është Sabile Basha, le të përgatitet Sabit Rrahmani.

### **SABILE BASHA:**

E nderuar Kryesi, të nderuar deputetë,  
Me orë të tëra ne mund tani të diskutojmë, mund të sypozojmë, mund edhe të akuzojmë. Por historikisht po qe se ndalemi dhe bëjmë një analizë të shkurtër të vrasjeve të mëhershme të shqiptarëve të Kosovës në veçanti, e të shqiptarëve të tjerë në përgjithësi, lirshëm mund të vijmë në një konkludim se ata që i vranë shqiptarët, personalitetet e shquara historike dhe të kombit në të kaluarën, ata edhe sot hedhin gurin dhe mëshehin dorën duke dashur që në këtë mënyrë të fusim përçarjen dhe urrejtjen ndërshqiptare.

Të nderuar deputetë, thënia e Makiavelit asnjëherë nuk ka qenë e panjohur dhe jo më aktuale se tani, se qëllimi arsyeton mjetin dhe pas kësaj të gjitha janë të qarta. Ata që nuk ia deshën dhe nuk ia duan të mirën këtij populli liridashës, edhe më tutje duan që botës së civilizuar t'ia paraqesin Kosovën dhe shqiptarët në tablot më të errëta dhe më të zeza. Donë që edhe shqiptarët t'i paraqesin si popull që nuk dijnë të organizojnë jetë shtetërore; nuk janë të aftë të gjejnë një gjuhë të përbashkët; nuk dijnë të mbajnë rend e qetësi, duke na ngjyrosur me llojloj ngjyra ideologjike. Kur ishte nevoja për të na dënuar, na quanin properëndimorë. Tani na quajnë majtist e çka jo tjetër. Sepse, kanë nevojë ashtu. Kur të gjitha këto u treguan të pasuksesshme, si gjithmonë okupuesi shkoi në një ekstrem tjetër që ka karakterin e terrorizmit për të finalizuar efektet politike. Dhe, të gjithë ata njerëz hije i lëshon toka, treten e pastaj nuk mund t'i zbulojë as policia e UNMIK-ut, as KFOR-i, as SHPK-ja. Pas ngjarjeve të kobshme, jipen deklarata nga zyrtarët se e tërë ajo ishte e përgatitur në mënyrë shumë profesionale. Edhe ne besojmë se ishin shumë profesionale, nga se u bënë 3 vite dhe ende nuk kemi ndonjë zbulim të akterëve. Dhe, vetëvetiu shtrohet pyetja – athua vallë kujt i shërben një Kosovë e destabilizuar, me vrasje dhe me netë me plotë ankth e pasiguri. Më duket shumë e lehtë që të gjejmë përgjigjen, nga se ata që deri dje e mbajtën të robëruar Kosovën dhe në një apartheid ekstrem - janë ata që deri dje e vranë dhe e burgosën, ata që edhe sot trumpetojnë se Kosova nuk e meriton lirinë, pavarësinë dhe shtetësinë.

Dhe krejt në fund, mendoj se okupuesi vështirë e ka që të pajtohet se njëherë e përgjithmonë e ka humbur Kosovën, andaj edhe luan në këtë letër, duke u munduar që të futë përçarjen në popull. Me një fjalë, po i referohem të së kaluarës se vrasjet e likuidimet e njerëzve që po ndodhin në Kosovë mund të organizohen nga shërbimet e ndryshme të ish okupuesve, nga se planet e programet shfarosëse të tyre populli shqiptar i ka të njohura qysh herët. Ju falemnderit për vëmendje.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit. E ka fjalën Sabit Rrahmani, le të përgatitet Lulzim Zeneli.

### **SABIT RRAHMANI:**

Ju falemnderit zoti kryesues, të nderuar deputetë,  
Së pari dhashtë zoti që ky Parlament të jetë pak më transparent herave tjera, meqenëse ka kolegë deputetë atje në fund nga jemi ne që kërkojmë fjalën qysh kur kanë qenë përfaqësuesit e Shtyllës së parë të UNMIK-ut dhe përfaqësuesit e Policisë.

Si pikë e parë, unë besoj se në Parlament duhet të flitet dhe ndoshta është koha të flasim edhe pak pa politikë dhe më konkretisht. Prej vitit 1999, konkretisht prej 21 korrik të vitit 1999 deri më 20 tetor të vitit 2001 nga komuniteti që unë përfaqësoj janë vrarë 26 persona, prej të cilëve njëri ka qenë edhe akt barbar, një fëmij 11 vjeçar në Ferizaj, që është djegur mizorisht dhe deri më tash policia e UNMIK-ut dhe as Shtylla e parë e UNMIK-ut nuk ka asnjë rast që ka mund me zbuluar deri më tash. Ky, domethënë, është një akt i cili nuk mund të tolerohet jo vetëm nga komuniteti që përfaqësoj por edhe nga gjithë qytetarët e Kosovës.

Nën dy. Unë besoj se fjalën kryesore sa i përket ndalimit të krimit e kanë qytetarët e Kosovës. Këto dy vite mund të them se situata në Kosovë ka qenë solide për të gjitha komunitetet, edhe pse ka ndodhur diçka që e ka dëmtuar në parti politike apo një individ.

Sa i përket situatës politike në Kosovë, unë besoj se zërin duhet ta ngrisin subjektet politike që qytetarët e Kosovës të jenë sa më tolerantë dhe ta njohin realitetin e ri në Kosovë. Një gjë që kam dashur ta ceku edhe para Policisë që ishte prezent këtu, edhe para Shtyllës së parë të UNMIK-ut, kur e kam cekur në këshillin transitor të Kosovës, me sa më duket ka qenë më 17 janar të vitit 2001, që në fshatin Dobratin të komunës së Lipjanit qysh atëherë kanë qenë të arrestuar nga bandat paramilitare serbe dy qytetarë të komunës së Ferizajit dhe janë liruar me kusht – që brenda 24 orëve të mos tregojnë asgjë në lidhje me këtë. Që të dy tash gjenden në Suedi. Edhe pse policia e UNMIK-ut i ka marrë në deklartë që të dy, nuk ka marrë asnjë hap konkret që ta zbulojë këtë pistë të krimit. Ka qenë fjala për fshatin Dobratin. Domethënë, në këtë rast Kuvendi i Kosovës si organ ekzekutiv më i lartë i shtetit duhet të dalë me një deklaratë që policia e UNMIK-ut në këto raste të jetë sa më transparente dhe t'i marrë në shqyrtim dëshmitarët, sikur thanë ata që nuk dëshmitarë për këto raste. Dëshmitarët kanë qenë gjallë, kanë shkuar, kanë raportuar për atë pistë të krimit në fshatin Dobratin, i cili ka qenë nën kontrollin e serbëve dhe policia e UNMIK-ut nuk ka marrë asnjë rast nën hetim. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit zotëri Sabit. E ka fjalën Lulzim Zeneli, le të përgatitet Ismajl Kurteshi.

## LULZIM ZENELI:

I nderuar zoti kryesues, të nderuar deputetë,  
Rëndësia për diskutimin rreth çështjes së sigurisë qëndron në argumentet e saja për vetë faktin se Parlamenti i Kosovës, si institucion më i lartë në vend, nuk mund të qëndrojë karshi ndaj këtij segmenti i cili padyshim se ka zgjuar reagime nga më të ndryshmet në të gjitha nivelet e organizimit të jetës në Kosovë.

Dëgjuam paraprakisht nga parafolësit, po dëgjuam edhe nga referuesit në seancën e sotme se në vitin e kaluar gjendja e sigurisë në Kosovë kishte shënuar përparime të dukshme, madje u referua sipas asaj që Kosova të shquhej edhe si ndër vendet më të sigurta në rajon. Sot, me fillimin e vitit, kur po diskutojmë për çështjet e sigurisë në Kosovë, siç dukej gjendja reale faktike e saj ka qenë argument i cili ka shpie deri në një debat të tillë në Parlament. E tash vetëvetiu lind pyetja se mos ekziston një qasje pak sa më ndryshe nga ajo se çfarë ne të gjithë ishim bind në vitin e kaluar. Nuk do mend fakti se tash i sërëpërsëritur se kushtet kryesore që duhej t'i plotësonte Kosova për të ecur tutje drejt zgjidhjes përfundimtare të statusit të saj është pikërisht siguria dhe liria e lëvizjes dhe e qarkullimit të lirë për të gjithë qytetarët e saj. Ne si institucione të Kosovës por edhe si shoqëri kosovare në përgjithësi, padyshim se kemi për detyrë dhe obligim ta përbushim këtë detyrë thelbësore të funksionimit të ligjit, të rendit dhe demokracisë së mirëfilltë në vend.

Tash gjithësesi shtrohet pyetja se kush është përgjegjës për sigurinë në Kosovë. Përgjigja në dukje të parë është fare e thjeshtë kur dihet se, sipas Rezolutës 1244 dhe Kornizës kushtetuese, përgjegjës për sigurinë në Kosovë është bashkësia ndërkombëtare me mekanizmat e saj, në këtë rast, KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut, por pa anashkaluar edhe përgjegjësinë e Shërbimit Policor të Kosovës, megjithëse me kompetenca të cinguar. Në anën tjetër, përgjegjës në një formë apo tjetrën për gjendjen e sigurisë jemi të gjithë ne si qytetarë të këtij vendi. E në këtë mes, ashtu edhe një herë, faktori mbetet pa adresë. Por krejt kjo çka është me rëndësi, mendoj se duhet të potencohet fakti se bashkësia ndërkombëtare që është përgjegjës për gjendjen e sigurisë në vend, është e obliguar të marrë më shumë masa në drejtim të parandalimit të dhunës, krimit të organizuar, kontrabandës dhe në këtë drejtim, kompetenca shtesë sa edhe u takon duhet ta kenë edhe Shërbimi Policor i Kosovës në mënyrë që të bëhet luftë kundër krimit, të luftohet krimi në mënyrë që kjo të rezultojë pozitivisht.

Dikujt mund t'i mos i pëlqente një konstatim se në Kosovë rastet e vrasjeve dhe të krimeve kanë klasifikimet e veta. Në Kosovë ka pasur dhe ka vrasje me motive politike. Për këtë nuk ka dyshim, por për këtë ne të gjithë jemi edhe dëshmitarë. Natyrisht se një konstatim i tillë do të sforconte edhe më shumë dhe do të hapte shtigjet dhe mundësitë e parandalimit të vrasjeve tjera me motive të tilla në qoftë se do ta thonë fjalën e vet edhe organet kompetente të drejtësisë. Por për këtë duhet më shumë punë, angazhim dhe mbi të gjitha edhe guxim nga të gjithë faktorët relevantë, vendorë dhe ata ndërkombëtarë në mënyrë që njëherë e përgjithmonë t'u thomi stop vrasjeve në Kosovë.



Të nderuar kolegë deputetë, një segment tjetër që ndërliidhet dora-dorës me gjendjen e sigurisë është edhe prezantimi i mediave dhe krijimi i një opinionit lidhur me këtë dukuri të caktuar. Gjuha e disa mediave tejet urrejtëse, nuk do të thojë vrasjenjtëse, është e papranueshme dhe shkon në dëm të të arriturave tona të përbashkëta. Krejt kjo nxitje e urrejtjes nga disa media është tepër një keqpërdorim i fjalës së lirë dhe të mediave në Kosovë si një ndër vlerat më subline të demokracisë dhe të lirisë. Kosovës po i krijohet një imazh negativ para opinionit ndërkombëtar. Dikujt kjo i konvenon. Janë qarqet e caktuara të cilat dojnë që gjithëçka që është arritur për këtë kohë, me shumë mund dhe sakrificë dhe me ndihmën e vazhdueshme të miqve tanë ndërkombëtarë, ta shlyejnë nga kujtesa dhe historia.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ne jemi këtu por duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe me këtë rast u bëjmë thirrje faktorëve relevantë vendorë dhe atij ndërkombëtarë për angazhimin maksimal në krijimin e një klime të sigurtë dhe demokratike në Kosovë, sepse ajo çka është duke ndodhur në Kosovë është hiq më pak se një tentim për vrasjen e lirisë, demokracisë dhe një goditje ndaj pavarësisë së Kosovës. E tash paramendoni se ku mund të na çojë kjo. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Tëfalemnderit. Ismajl Kurteshi, le të përgatitet Ramadan Kelmendi.

### **ISMAJL KURTESHI:**

Kryesi e nderuar, deputetë të nderuar,  
Fjalën time do ta dorëzoj të shkruar por pyetjet që i kisha përgatitur për përfaqësuesit e Shtyllës së parë të UNMIK-ut, edhe pse ata nuk janë këtu, do t'i bëj publikisht dhe shpresoj se ata publikisht edhe do të përgjigjen.

Pyetjet që i kam përgatitur janë këto:

- Sa përqind të vrasjeve janë zbardhur. Do të thotë sa përqind të autorëve të vrasjeve janë kapur.
- Pyetja e dytë është – shpesh kemi dëgjuar nga policia se ankohen në dëshmitarët. Por kemi raste kur nuk ka nevojë për dëshmi sepse janë shumë vepra që janë pothuaj publike por jo të ligjshme, siç është prostitucioni dhe gati të gjithë qytetarët e Kosovës e dijnë nga një shtëpi publike që ekziston nëpër qytetet tona; kontrabanda dhe dihen edhe qendrat e kontrabandës siç është kufiri Mal i Zi dhe Kosovë; organizatat paramilitare, siç ishin “rojet e urës” e të tjera dhe paralelizmi në administratë siç ndodh në disa qytete të Kosovës dhe në enklava.
- Dhe pyetja tretë imja është – sa-kontrollohen hyrje-daljet në kufij të Kosovës?

- Pyetja e katërtë është për Kryesinë e Kuvendit – pse nuk është ftuar këtu edhe Përfaqësuesi i KFOR-it, pasi që KFOR-i është përgjegjës, po ashtu, shumë i rëndësishëm për sigurinë në Kosovë.

Dhe, më lejoni vetëm një konstatim. Zoti Shtajner, vitin e kaluar kishte deklaruar se për tolerancë për krimin do të ketë zero-tolerancë. Është përshtypje imja dhe besoj edhe e shumë qytetarëve të Kosovës se ky deklarim nuk është përmbushur dhe mendoj se as që do të përmbushet me organizimin e këtillë çfarë e kemi. Ne dëgjuam nga përfaqësuesit e UNMIK-ut se brenda një viti rastet e vrasjes janë zvogëluar për 61% dhe si arsytim u dha se është rritur numri i policëve vendorë. Shpresoj se dhënia e kompetencave në këtë drejtim vendorëve do ta rritë shkallën e sigurisë në Kosovë.

Dhe, edhe një gjë do ta thoj. Kualifikimet çfarëdoqofshin ato, nëse janë të paargumentuara, nuk do t'i ndihmojnë sigurisë në Kosovë, por vetëm do ta komplikojnë situatën dhe do të jenë të dëmshme.

Dhe, në fund, mendoj se në shënjestër të krimit në Kosovë nuk janë veç e veç LDK-ja, PDK-ja, AAK-ja, nuk janë as minoritetet por jemi të gjithë së bashku, është Kosova dhe e ardhmja e saj, prandaj mendoj se bashkërisht do të duhej të angazhohemi në luftë kundër krimit. Ju falemnderit.

#### **(Më tutje diskutimi i bashkëngjitur me shkrim)**

#### **(Pa)Siguria në Kosovë**

Bazuar në raportet e UNMIK-ut shkalla e sigurisë në Kosovë, krahasuar me vitin 1999, tani është rritur dukshëm dhe mesatarja e akteve të dhunës nuk është në asnjë mënyrë më e lartë se në vendet evro-perëndimore. Por, për shkak të politizimit të shumë rasteve, madje edhe atyre aksidentale, me qëllim të përfitimeve politike ose etnike, fitohet përshtypja se në Kosovë ushtrohet dhunë në një shkallë shumë më të lartë se që ndodh në realitet. Kur dihet se eksagjerimi i dhunës e dëmton Kosovën, është e domosdoshme që realiteti kosovar të prezentohet ashtu siç është në të vërtetë. Megjithatë, në Kosovë, rastet e dhunës e të krimit janë prezente dhe shumë prej tyre mbeten të pazbuluara.

Fakti se dhuna ushtrohet në Kosovë, me të drejtë i shqetëson qytetarët e Kosovës dhe kërkon angazhim të të gjithëve që ta luftojnë këtë dukuri të shëmtuar duke i zbuluar aktorët e krimit dhe vënien e tyre para drejtësisë.

#### **Çfarë pasoja i sjell Kosovës mungesa e sigurisë?**

Mungesa e sigurisë në Kosovë krijon imazh negativ për Kosovën në botë; krijon pasiguri në mesin e qytetarëve të Kosovës; i dekurajon investitorët; krijon përshtypjen se misioni i OKB në Kosovë po dështon dhe se kosovarët nuk janë të aftë të organizojnë pushtetin. Si pasojë Kovova mbetet vend pa investime, pa zhvillim ekonomik, vend i pasigurt për

qytetarët e saj, i izoluar dhe i paperspektivë. Shtrohet pyetja, kujt i nevojitet një Kosovë e tillë? Sigurisht se nuk i nevojitet qytetarëve të Kosovës, të cilët Kosovën e përjetojnë si atdhe të tyre dhe as udhëheqësve të cilët janë sinqerisht të interesuar të punojnë për të mirën e Kosovës.

### **Dëmet që sjellin akuzat dhe kualifikimet e paargumentuara**

Nuk janë të rralla rastet kur pas vrasjeve enigmatike (që fatkeqësisht po ndodhin në Kosovë), personalitete të rëndësishme të jetës politike në Kosovë, para se të sigurojnë çfarëdo argumenti, dalin me vlerësime për natyrën e krimit dhe i fillojnë akuzat kundër individëve, grupimeve politike, madje akuzohen edhe shtete.

Këto personalitete, duke u shërbyer me të pavërteta e paragjykime, krijojnë pasiguri në mesin e qytetarëve, i përfaqësojnë qytetarët, rrisin tensione dhe paraqesin një pasqyrë ireale duke i ndarë qytetarët e Kosovës në dy krahe, njërin krah si viktimë e tjetrin shkakhtar të dhunës.

### **Çfarë duhet ndërmarrë për ta rritur shkallën e sigurisë në Kosovë?**

Udhëheqësit politikë duhet të punojnë me qytetarët dhe t'i vetëdijësojnë ata për dëmet që krimi ua sjell Kosovës.

Qytetarët duhet kuptuar se ata munden dhe duhet të angazhohen në luftë kundër krimit. Ata duhet ta kuptojnë se respektimi i të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, të drejtës së lëvizjes së lirë dhe të pronës si dhe lufta kundër korrupsionit, sidomos brenda institucioneve shtetërore, janë elemente të rëndësishme të sigurisë dhe kusht për integrimin e Kosovës në strukturat e botës demokratike.

Minoriteti serb duhet ta kuptojë se është në të mirën e tij zhbërja e enklavave dhe e strukturave paralele, bashkëpunimi dhe njohja e institucioneve të Kosovës, integrimi në shoqërinë kosovare si dhe mospengimi i kthimit të banorëve shqiptarë nëpër shtëpitë e veta që gjenden në pjesën e kontrolluar nga serbët. Kjo e ndihmon edhe ngritjen e shkallës së sigurisë në përgjithësi në Kosovë.

Institucionet përgjegjëse për sigurinë në Kosovë duhet të mobilizohen për rritjen e shkallës së sigurisë. Ata duhet ta fillojnë riorganizimin në këtë drejtim duke i ngarkuar me përgjegjësi më të madhe por edhe duke ua rritur kompetencat segmenteve vendore si SHPK, TMK dhe mekanizmave të tjerë që do të vepronin në kuadër të Qeverisë së Kosovës si këshill i sigurisë kombëtare ose ministri e rendit.

Rëndësi të veçantë për ngritjen e shkallës së sigurisë dhe garantimin e saj ka gjyqësia e cila duhet të jetë efikase, profesionalisht e përgatitur, moralisht e pasur, e pa ndikuar politikisht dhe e emëruar nga Kuvendi i Kosovës.

UNMIK-u duhet sinqerisht të angazhohet në zhbërjen e strukturave paralele, zhvlerësimin e rregulloreve diskriminuese si dhe kapjen e kontrabandistëve e të kriminelëve dhe dorëzimin e tyre në organet e drejtësisë.

Siguria e çdo vendi nisë me mbikëqyrjen e kufijve. Në Kosovë hyhet e dilet pa asnjë kontrollë. Kontrollimi i kufijve dhe regjistrimi i çdo hyrje-daljeje nga mekanizma të kontrollit të kufijve si dhe moslejimi i hyrjes së personave të dyshimtë, duhet të jenë një ndër masat e ndërmarra për ngritjen e shkallës së sigurisë.

Të huajve duhet t'u caktohet afati i qëndrimit në Kosovë dhe të mos u lejohet punësimi pa leje për punë.

Në Kosovë duhet të bëhet regjistrimi i popullatës dhe të dihet saktësisht adresa e secilit shtetas të Kosovës.

### **Pse gjendja e sigurisë paraqitet më e rëndë se që është?**

Në mes dy luftërave botërore, propaganda serbe i paraqiste shqiptarët si njerëz të egër e me bishta, me qëllim të arsyetimit të dëbimit të tyre për në Turqi.

Në dy dekadat e fundit të shekullit të 20-të, Beogradi zyrtar situatën e sigurisë në Kosovë e vlerësonte si shumë të rëndë me qëllim të arsyetimit të heqjes së autonomisë, represionit, burgosjeve, dhunës, vrasjeve dhe ekzodit masiv që ushtroi mbi shqiptarët.

Edhe tani, nga e njëjta kuzhinë dezinformohet për situatën e sigurisë në Kosovë me qëllim të pengimit të proceseve demokratike, të realizimit të pavarësisë dhe të integritetit të Kosovës në Evropë.

Po këtij qëllimi po i ndihmojnë, për qëllime të ulëta, të përfitimeve personale a grupe, qoftë politike ose ekonomike, me vetëdije ose pa të, edhe disa personalitete me përgjegjësi politike-publike që, me sa dihet, nuk kanë atdhe tjetër përveç Kosovës. Çfarë të themi për ta, përveç të lutemi që t'u kthjellat mendja dhe ta kuptojnë se çfarë dëmi po i sjellin Kosovës dhe vetëvetes njëkohësisht.

Zhurma mediale, deklaratimet e pamatura, ekzagjerimet, akuzat dhe vlerësimet e pabaza, organizimi i strukturave ilegale, nuk e zgjidhin problemin e sigurisë, përkundrazi, e komplikojnë atë duke e dëmtuar rëndë Kosovën dhe të ardhmen e saj. **(Pason nënshkrimi)**

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit zotëri. Ramadan Kelmendi, le të përgatitet Halil Ahmeti.



## RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryesues, të nderuar deputet dhe të pranishëm,  
Kur ne sot shtrojmë dhe diskutojmë çështjen e sigurisë në Kosovë, së pari duhet dhënë përgjigje në dy çështje:

- E para, sa dhe si mundemi ne dhe cilat janë metodat, mënyrat dhe instrumentet juridike e politike dhe shtetërore që qytetarët tanë, pa dallim social, politik, gjinor, kombëtar e tjerë të sigurojmë dhe garantojmë qetësinë, lirinë, të drejtën e jetës, me rëndësi ekzistencën ekonomike, të drejtën e lëvizjes dhe të shprehjes së mendimit të lirë?

- Dhe e dyta, sa e vlerësojmë ne sot si Kuvend shkallën e rrezikshmërisë, të pasigurisë në Kosovë pas tërheqjes së Shërbimit Policor të Kosovës nga Mitrovica e veriut dhe nga tërë hapësira veriore e Kosovës ku nuk kemi shërbim policor dhe kërkesat permanente të partive politike serbe dhe të Beogradit për ndarjen e Kosovës dhe formimin e unionit të komunave serbe në Kosovën veriore?

Duke u mbështetur në këtë, unë kam edhe propozim konkret që Kuvendi i Kosovës të miratojë një deklaratë gjegjësisht rezolutë me të cilën do të shpallë inekzistente unionin e komunave serbe.

Tërë këtë që e thash do ta argumentoj me disa fakte. Na është e njohur se kompetencat rreth sigurisë i ka bashkësi ndërkombëtare gjegjësisht UNMIK-u, ka suksese por në anën tjetër siguria individuale, në veçanti siguria politike dhe ajo ekonomike gjithnjë e më shumë po vijnë duke u keqësuar. Natyrisht, në një shoqëri të tillë ku flitet për parregullsi, për padrejtësi, ku ka shkelje të të drejtave të qytetarëve, ku ka ryshfet, korrupsion dhe vrasje nuk mund të jemi të kënaqur. Në anën tjetër, të gjithë i gjykojmë këto të këqia, por mungojnë veprimet konkrete të organizuara institucionale dhe në veçanti partiake për t'i ndalur këto dhe pikërisht këtu qëndron problemi i pasigurisë në Kosovë. Duhet të theksoj në veçanti se pasiguria, veçanërisht është shumë e madhe në Kosovën veriore e cila përfshin 18.83% të territorit të Kosovës dhe ku 26.800 qytetarë shqiptarë me theks të veçantë se nuk gëzojnë sigurinë politike, ekonomike dhe sigurinë e qarkullimit të lirë. Kam shumë fakte por do t'i tejkaloj. Çdo ditë mbi këta qytetarë në 47 fshatra të kësaj zone veriore të Kosovës ka kërcnime, rrahje, provokime, maltretime dhe forma të ndryshme nga qytetarët serbë dhe militarët që akoma janë atje. Pastaj u bënë 3 vjet dhe asnjë qytetar shqiptar nuk ka mundësi të qarkullimit të lirë përtej urës së Ibrit në pjesën veriore për të shkuar në shëpi, banesa dhe prona të tyre e po ashtu, as studentët në fakultet, në shkolla të larta, në spital e tjera e tjera. Në veçanti për spitalin regjional të Mitrovicës në mënyrë të pasigurtë nga ky Kuvend është miratuar 1.8 milion euro që do të administrohen nga një militar i cili çdo ditë popullatës së atjeshme, kuptohet shqiptare, i sjell probleme. Problem në veçanti janë faktet: ndarja e qytetit në pjesën jugore dhe veriore dhe krijimi i bashkësisë së komunave serbe krijon pasigurinë më të madhe te qytetarët e pjesës veriore dhe është pasiguri për tërë Kosovën; marrja e kompetencave kuvendit komunal legjitim për qeverisjen në pjesën veriore të Mitrovicës; pastaj tërheqja

e shërbimit policor nga veriu i Mitrovicës, kërkesat permanente për ndarjen e Mitrovicës, qarkullimi i lirë i automjeteve pa targa të Serbisë dhe me targa të Serbisë dhe pa targa të Kosovës në tërë veriu të Kosovës; lejimi i kontrabandës dhe i tregtisë së ndaluar në aksin rrugor Mitrovicë – Zveçan – Mitrovicë Rudar; heqja e mbishkrimeve shqipe në rrugët që çojnë për fshatrat e zonës veriore të Shalës dhe të Mitrovicës Boletin – Zhazhë – Kelmend e tjera dhe në veçanti heqja e flamurit kombëtar nga Kulla e Isa Boletinit, heroit tonë kombëtar; vënia e shenjave simbole serbe në veri të kalasë në Zveçan me “cccc” atë e dini dhe po ashtu kishën ortodokse në malin Sokolicë; sjellja huligane para shkollave tona dhe para profesorëve tanë; lirimi nga burgu i Mitrovicës dhe mosgjykimi i kriminelëve serbë të cilët kanë bërë krime dhe janë identifikuar nga qytetarët e Mitrovicës dhe në veçanti angazhimi në shkollim të mëtutjeshëm i kriminelëve të “rojes së urës” në shërbimin policor gjegjësisht në Akademinë policore në Vushtrri; ndarja e mjeteve financiare nga qeveria, është e re, e Beogradit për blerjen e shtëpive, banesave dhe pronave shqiptare në veri, me çmimin dyfish që e kanë ato dhe ka oferta të shumta; mospranimi i asnjë shqiptari në punë në komunën që unë e quaj komunë tipike – komunën veriore të Mitrovicës dhe atë pranimi i “rojeve të urës” në punë për të shërbyer në pjesën veriore; ndalimi i qarkullimit në aksin rrugor dhe fiks s’ka shqiptar që ka qarkulluar në tri vjet Mitrovicë-Zveçan, Mitrovicë-Boletin, Mitrovicë-Kelmend, Mitrovicë-Zveçan, Mitrovicë-Vidimriq, Mitrovicë-Suhodoll, Mitrovicë-Gushavc, Mitrovicë-Bistricë-Cerajë-Koshtovë dhe aksi rrugor Mitrovicë-Rozhajë; ndërprerja e telefonave qytetarëve shqiptarë të cilët janë rrezik permanent dhe kurrë nuk mund të thërrasin ndihmë në pjesën veriore apo pjesë tjera të Kosovës. .

Të gjitha këto dhe shumë fakte tjera flasin për pasigurinë e shqiptarëve në regjionin e Mitrovicës nga se atje nuk ka pushtet të mirëfilltë as të UNMIK-ut as qasje të Qeverisë së Kosovës. Akoma vlejné rregullat e deleguara të militarizmit nga Beogradi, andaj atje kemi pasiguri dhe krim të organizuar, krim që kundërshton çdo gjë që vjen nga shqiptarët dhe bashkësia ndërkombëtare për stabilizimin dhe sigurinë në Kosovë.

Ta përfundoj. Aty ku ka pushtet, gjyqësi, polici, e drejtësi nuk mund të ketë pasiguri, por kjo për regjionin e Mitrovicës nuk vlenë. Prandaj, duhet të organizohemi e të angazhohemi për një siguri qytetare duke luftuar të gjitha format e krimit në funksionilizimin e institucioneve të Kosovës në shërbim të të gjithë qytetarëve duke kërkuar që të funksionojnë organet e ndjekjes ant krim, ant krim ekonomik, ant krim politik duke u përkrahur nga vendorët dhe ndërkombëtarët dhe në veçanti nga aspekti politik i Kosovës për t’i identifikuar, zbuluar dhe klasifikuar krimet politike, ekonomike, individuale dhe grupe si dhe për të dhënë shkallën e rrezikshmërisë së tij që ekziston sot në Kosovë dhe në veçanti në Kosovën veriore. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Kisha lutur deputetët që ta kenë parasysh sepse është edhe një pikë e rendit të ditës, e cila duhet të kryhet sot – Miratimi i ligjit për financa. Halil Ahmeti e ka fjalën, le të përgatitet Berat Luzha.

## HALIL AHMETI:

Të nderuar deputetë,

Qytetarët e Kosovës janë të vetëdijshëm për ndihmën e miqve ndërkombëtarë për progresin dhe të arriturat e gjertanishme si në aspektin e sigurisë ashtu edhe në ndërtimin e institucioneve demokratike të Kosovës, krijimin e një klime të volitshme për qytetarët e Kosovës, për lëvizje të lirë në territorin e Kosovës, për paqe dhe ecje përpara dhe për një jetë normale në perspektivë për brezin e ri dhe të ardhmen e Kosovës. Siguria, si një segment i ndieshëm dhe i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës por edhe më gjerë, edhe pse kohëpaskohe në rënie dhe ngritje nuk është arritur qoftë nga institucionet ndërkombëtare e vendore, këto të fundit bazuar në kompetencat të cilat i kanë.

Rastet e njëpasnjëshme të vrasjeve qoftë të dimensionit politik apo çfarëdo lloji qofshin, kanë bërë që qytetarët të shqetësohen dhe me shumë arsye t'u drejtohen institucioneve ndërkombëtare dhe vendore, me kërkesën për rend, qetësi dhe luftë kundër krimit, dhunës së çfarëdolloji, kontrabandës, prostitucionit etj.

Më vjen mirë që sot patëm përfaqësuesit kompetentë dhe përgjegjës të cilët para Kuvendit raportuan për gjendjen e sigurisë në Kosovë, praktikë e cila duhet të jetë vazhdimësi në të ardhmen. Ne dëgjuam disa shifra dhe fakte lidhur me këtë. Shqetësimi kryesor i qytetarëve të Kosovës është siguria territoriale e Kosovës, prezenca e SHPK-ës në tërë territorin e Kosovës, aspekti i sigurisë kolektive dhe siguria individuale, zbulimi i autorëve të krimit të çfarëdolloj qofshin dhe efikasiteti i sistemit gjyqësor. Në Kosovë, pas luftës, sipas të dhënave jozyrtare ka kaluar shifra mbi 900 vrasje, nga më të ndryshmet. Policia e UNMIK-ut, KFOR-i dhe SHPK-ja, e para dhe e dyta e pasur me teknikë tejet profesionale, nuk kanë arritur të zbulojnë shumë nga rastet për një kohë të gjatë. Prandaj, kërkesës së qytetarëve për efikasitet dhe zbardhje të rasteve të krimit me dimension politik apo çfarëdolloji qoftë duhet dhënë përgjigje. Shtrohet pyetja – a ka në Kosovë agjentura të cilat lëvizin nëpër Kosovë veprojnë, hyjnë dhe dalin nga katër anët e kufirit të Kosovës. Fatkeqësisht në Kosovë ka edhe të atillë që bëjnë shërbimin e atyre të cilët kanë punuar dhe po punojnë për realizimin e planeve të errëta të

qarqeve serbe para luftës, gjatë luftës dhe sot. Por kemi shpresën se institucionet ndërkombëtare dhe vendore do t'i bashkërendojnë veprimet e tyre konkrete për të parandaluar krimin në përmasa tragjike që për Kosovën dhe Ballkanin në tërësi, në Kosovë pas lufte, para lufte dhe gjatë lufte, historia nuk i njeh. Raste konkrete kemi djegiet e kufomave në disa mese të Kosovës.

Më lejoni që unë personalisht edhe disa kërkesa të qytetarëve t'i përcjell në vërejtjet, dobësitë dhe mangësitë në punën e institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare. Kuptohet, këto të fundit në bazë të kompetencave që kanë, të cilat mendohet se do të ndikojnë pozitivisht në të ardhmen dhe kjo është një domosdoshmëri e kohës.

- Mungesa e ligjeve për policinë,



- Mungesa e kompetencave të SHPK-ës,
- Emërimi i eprorëve konform shteteve demokratike si polici civile,
- Bashkëveprimet në vijën vertikale dhe horizontale, përgjegjësitë nga niveli qendror dhe lokal,
- Zëvendësimi i thirrjeve policore konform shteteve demokratike,
- Mbrojtja e të drejtave ligjore të policëve të SHPK-ës. Kemi raste konkrete të vrasjeve, lëndimeve të rënda në krye të detyrës,
- E drejta e mbrojtjes dhe përkujdesjes ndaj familjes dhe e drejta e shërimit. Kemi raste kur pas dy javësh janë detyruar familjet të kujdesen për personelin policor të SHPK-ës,

Dhe, lidhur me këtë ligj që do t'i jepte forcë morale për t'u ballafaquar me krimin. Pastaj kemi infrastrukturën. Në disa komuna kur është vendosur policia ndërkombëtare dhe SHPK-ja janë kushtet minimale për punë. Objektet në të cilat punojnë sidomos nëpër disa komuna të mëdha. Përkrahja logjistike, objektet ose postkomandat të cilat kanë qenë në viset rurale që menjëherë aty ku ekziston mundësia të bëhet organizimi i postkomandave dhe në këtë rast, megjithëse është përgjegjësia edhe e gjithë qytetarëve, mendoj se policia duhet të jetë sa më afër qytetarëve për një bashkëpunim dhe për t'i ofruar mundësi të bashkëpunimit.

Vrojtimi dhe stacionimi i postkomandave policore në vendet publike ose në vendet kyçe, siç janë: stacioni i autobusëve, shkollat. Kemi raste kur para syve tanë, lëvizin e qarkullojnë dhe kemi raste, pra nuk po them kriminele, por të armatosur dhe janë zënë në masa të ndryshme, domethënë, me sasi të drogës.

Pastaj edhe një gjë që duhet të mendojmë për të ardhmen, meqë këtu u fol shumë për SHPK-ën. Formimi i akademisë policore si shkollë e mesme dhe profesionale, e cila do të prodhonte kuadra për të ardhmen e Kosovës dhe të mirën e saj. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit zotëri Halil. E ka fjalën Berat Luzha, le të përgatitet Blerim Baruti.

#### **BERAT LUZHA:**

Të nderuar deputetë,  
Së pari, nuk ka se si të mos shprehu keqardhjen time të thellë për sulmin e djeshëm në Stacionin e Policisë në Pejë, por njëherit edhe kënaqësinë që nuk kishte pasoja në njerëz, në stafin policor ndërkombëtar dhe në atë vendor. Edhe ky rast tregon se gjithçka në Kosovë nuk është në rregull. Kosova është bërë një vend eksperimentimi nga shumë aspekte, edhe nga ajo e sigurisë, duke tentuar që ajo të kriminalizohet sa më shumë që të jetë e mundur dhe nuk është e rastit kur u zgjodh pikërisht koha e parambajtjes së mbledhjes së Kuvendit ku siguria do të vëhej për herë të parë në diskutim dhe në shqyrtim. Ju e dini se siguria është nën kompetencat e rezervuara të ndërkombëtarëve të cilët, sipas mendimit tim, nuk janë sa duhet të gatshëm t'i dalin përballë kësaj të keqeje



që po e brenë Kosovën, me tentim të rritjes së vazhdueshme. Ju e dini se në Kosovë i kanë futur gishtat por edhe interesat e tyre shumë shtete të botës. Ju e dini gjithashtu se disa shtete, sidomos ato fqinje, nuk ia duan të mirën Kosovës, por duan që me çdo kusht ta mbajnë nën etheet e pasigurisë, të pastabilizuar politikisht dhe ekonomikisht, dhe ju e dini se njerëzit tanë ende po dënohen me ligjet e ish Jugosllavisë, të një shteti që sot nuk ekziston fare.

Megjithkëtë, jam i bindur se Kosova ka bërë një progres të madh këto tri vitet e fundit, edhe sa i përket çështjes së sigurisë dhe të stabilitetit politik. Këtë e kanë pohuar të gjithë, edhe vendorët edhe ndërkombëtarët. Por, si duket gjendja e pasluftës po gjeneron ende probleme shoqërore duke përfshirë edhe eksceset dhe konfliktet e ndryshme. Këto probleme lindin në ato shoqëri ku nuk ka prosperitet ekonomik, ku varfëria thellohet, ku nuk sundon ligji dhe ku shoqërinë e mbajnë pezull qarqet mafioze, që janë ndonjëherë më të fuqishme se vetë shteti.

Do t'i qasem pak problemit të minoritetit serb. Kur e kemi rasatin me serbët e Kosovës, për të cilët bota na akuzon se po bëjmë presion mbi ta, se nuk po u krijojmë atyre siguri të mjaftueshme, se ata nuk mund të qarkullojnë lirshëm si qytetarë të lirë, se ata nuk mund të kthehen nëpër shtëpitë e veta, e tjerë, duhet të kemi një qasje paksa më reale. Është fakt se gjendja e serbëve është e rëndë, por jo edhe ashtu siç përshkruhet. Problem i tyre është më shumë problem politik, madje ndoshta është edhe krejtësisht politik. Është fakt gjithashtu se serbët, për dallim nga komunitetet tjera, nuk duan të integrohen në shoqërinë e re demokratike kosovare. Ata duan një Kosovë ndryshe, të futur në Serbi, kurse serbët në të kishin pozitën dominante. Megjithkëtë, ne kemi bërë atë që kemi mund ta bëjmë kundrejt tyre – të jemi tolerantë dhe t'u krijojmë hapësirë demokratike në shoqëri. Por ata do të duhej që para se gjithash vetë t'ia hapnin rrugën vetës kah integrimi në shoqërinë kosovare, duke i zbutur raportet e ngrira me komunitetet tjera në Kosovë, sidomos me shumicën shqiptare. Ata nuk do të duhej t'i përkrahnin, t'i mbronin e t'i strehonin kriminelët e luftës, ata të cilët kanë bërë krime gjatë luftës dhe para luftës në Kosovë. Kthimi i popullsisë së shpërngulur serbe në Kosovë nuk do të thotë se me ta duhet të kthehen edhe kriminelët. Serbët e Kosovës nuk do të duhej të instrumentalizoheshin edhe më tutje nga Beogradi, si deri tash, në mënyrë që gjendjen e tyre të përkeqësuar qytetare ta shfrytëzojë regjimi serb për qëllime ekskluzivisht politike. Ata nuk duhet ta kishin votuar, sidomos në zgjedhjet e pasluftës, kriminelin Millosheviq dhe pas rënies së tij, kriminelin tjetër Sheshel. Serbët nuk do të duhej të barikadoheshin nëpër enklava sepse në këtë mënyrë nuk fitojnë gjë, pos që e dëmtojnë vetëveten dhe Kosovën. Nuk duhet të lëvizin me makina të tyre me regjistrime jozyrtare, sepse kjo mund të shihet si një provokim nga shumica e popullsisë. Ata duhet të deklarohen qartë për luftën, për krimin, për gjenocidin mbi popullin shqiptar dhe të distancohen nga regjimi që bëri krime dhe jo në të kundërtën të identifikohen me atë regjim. Nuk do të duhej të formonin institucione paralele apo t'i bartin ato gjëja përkohsisht në Serbi, sipas tyre, deri në çlirimin e Kosovës. Dhe, ata duhet të luftojnë realisht për të drejtat e tyre njerëzore, qytetare dhe kombëtare e jo të bëhen mollësherri në mes shqiptarëve dhe serbëve. Serbët nuk duhet t'i akuzojnë shqiptarët apriori për eksceset ndëretnike që ndodhin në Kosovë edhe atëherë kur nuk kanë asnjë fakt në dorë, sepse është provuar tashmë se

ekscetet ndëretnike mund të krijojnë edhe qarqet e huaja, siç është "sigurimi serb" për tua lënë pastaj fajin shqiptarëve dhe për t'i akuzuar ata te bashkësia ndërkombëtare dhe jo vetëm ekscese ndëretnike por edhe ekscese ndërpartiake me qëllim të futjes së konflikteve brendakombëtare duke na nxitur që gishtin akuzues t'ia drejtojmë njëri-tjetrit. Ne nuk kemi dilema për ekzistimin dhe veprimin e rrjetit të "sigurimit shtetëror serb" në Kosovë i cili vazhdon të mbajë dosje dhe lista të zeza për çdo shqiptar jo të ndershëm, sipas tyre në thojza. Si duket këtë karem ne e kemi hëngër dhe, pa një pa dy, gishtin akuzues ia kemi drejtuar tjetrit duke e akuzuar në mënyrën më të vrazhdët për disa nga vrasjet që janë bërë edhe kur nuk dihen as autorët dhe as motivet e tyre. Në këtë drejtim po bëhet një fushatë e shfrenuar në të cilën janë përfshirë, pos mediave për fat të keq, edhe disa bartës të papërgjegjshëm të institucioneve të Kosovës.

Kam disa propozime dhe ato janë:

- që të organizohen shërbimet vendore profesionale për hetimin e krimit në kuadër të Policisë së Kosovës;
- të barten kompetencat, sa më shumë që është e mundur, në SHPK dhe jo ato të kufizohen në disa stacione stacione të policisë;
- në kuadër të Kuvendit të formohet komisioni për krimin dhe në fund;
- edhe pse zoti Feller tha se çështja e bashkëqeverisjes është çështje e kryer, mendoj se UNMIK-u duhet ta shqyrtojë më seriozisht që sigurimi dhe drejtësia të kenë bashkëqeverisje. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Para se ta marrë fjalën folësi, atëherë më duhet ta shfrytëzoj të drejtën sipas Rregullorës ta kufizojë fjalimin në 5 minuta, sepse çdo fjalim po zgjatë rreth së paku 10 minutave. Urdhëroni, zoti Blerim Baruti, le të përgatitet Bislim Hoti.

#### **BLERIM BARUTI:**

E nderuar Kryesi, të nderuar deputetë,

Po debatojmë çështjen e sigurisë në Kosovë e cila pas 3 vjet e gjysmë liria ende nuk është në nivel. Pas sundimit shekullor, apartheidi dhjetvjeçar, gjenocidi tremujor mbi Kosovën ende janë duke qaluar në siguri me segmente të ndryshme. Mungon lëvizja e lirë në territorin e Kosovës, funksionojnë sisteme paralele, tendenca e hapur e separatizmit serb të përhershëm e tjera, e tjera. Nga lagjet veriore të Mitrovicës janë të dëbuar dhjetëra mijëra banorë të popullatës joserbe, të cilët janë të privuar nga e drejta elementare për jetë nga se nuk lejohet që të jenë në shtëpitë e tyre, në pronat e tyre, në bizneset e tyre, në shkollat e tyre duke filluar nga kopshti i fëmijëve parashkollorë, tri shkolla fillore, dy shkolla të mesme, Fakulteti Xehstaro-metalurgjik, Shkolla e Lartë Teknike, në lokalet e të

cilave sot punon i ashtuquajtur universiteti serb njënacional. Pastaj, nga Spitali i Përgjithshëm Rajonal në të cilin për një kohë të shkurtër nga ana e administratorit rajonal zotit Stefan Denistura u ngrit flamuri i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, por nga të tjerët u hjek. Pastaj nga Enti Shëndetësor Pediatrik, Varrezat stërgjyshore, pjesa e kompleksit industrial "Trepça" si dhe nga pjesa tjetër e ekonomisë së qytetit. Sot në atë pjesë punon vetëm gjykata, në të cilën punëtorët shkojnë nën kushtet shumë të vështira të përcjellur nga ndërkombëtarët. Shkaktarë të këtyre gjërave keqdashëse të cilat nuk e dëshirojnë stabilitetin e Kosovës nga se janë të instrumentalizuar nga të tjerët janë ekstremistët, fuqizimi permanent i formacioneve "rojat e urës" dhe sistemi paralel nga Beogradi me të cilat sot ende e mbajnë Kosovën peng.

Këtyre ditëve, përveç tjerash, në shesh ka dalur unioni i katër komunave të Kosovës veriore. Habit fakti se nuk pengohet nga askush ky union njënacional i formuar. Mirëpo, në të inkorporohet edhe Mitrovica, mirëpo nuk e dijmë për cilën Mitrovicë bëhet fjalë, e cila është edhe në kundërshtim me rregulloren për shtrirjen e pushtetit lokal, Rregulloren 2000/45, pastaj, me deklarin për një Kosovë multietnike, me Rezolutën 1244 dhe me Kornizën kushtetuese. Në muajin prill të vitit të kaluar është bërë shkëputja e sistemit të telefonisë legale dhe futja e dhunshme e sistemit të telefonisë së Serbisë. Deri tani në tri shkresa të drejtuara nga ministria përkatëse, sipas informacioneve drejt përgjegjësve nuk ka përgjigje. Mirëpo, as nuk kemi njohuri se çka është ndërmarrë nga PSSP për Kosovën zoti Shtajner, megjithë premtimet se do të formojë një komision lidhur me këtë çështje, si dhe do ta bëjë rikthimin e gjendjes së mëparshme brenda një kohe të caktuar. Është shqetësim i madh i atyre banorëve sepse vetëm për një thirrje telefonike në qytetin e Mitrovicës nga pjesa jugore në atë veriore, shih absurdin, duhet të përdoret prefiksi ndërkombëtar 9938128 për qytetin e Mitrovicës. Këtyre ditëve tërhiqet SHPK nga lagjet veriore të Mitrovicës, edhe pse nuk ka pasur asnjë veprim kontradiktër, përkundrazi janë mirëpritur nga të gjithë banorët atje, bile kanë bashkëbiseduar për hallet e tyre e nganjëherë janë thirrur në kafe që të rrinë së bashku. Mirëpo, nuk shohim arsyen e tërheqjes së tyre dhe sygjerojmë që të kthehen sa më shpejt që të bëhet një siguri më e madhe në atë pjesë.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Zoti deputet, përpuni ta përmbyllni diskutimin tuaj, ju lutem.

#### **BLERIM BARUTI:**

...Në rregull, vetëm edhe dy-tri fjalë. Deri më tani, megjithë deklaratat e shkruara posaçërisht më 1 shkurt të vitit 2001 nga pala vendore dhe ndërkombëtare, pastaj paraqitja e dokumentit të mirëbesimit nga ana e kryeadministratorit Shtajner, kemi fituar përshtypjen si popullatë e qytetit të Mitrovicës se koha nuk ka punuar në zgjidhjen e problemit të Mitrovicës, por Mitrovica, Kosova dhe realiteti kërkon unifikimin e qytetit të Mitrovicës dhe të Kosovës.



Në fund, e gjithë popullata kosovare, pa dallim, duhet t'i kthehet realitetit duke qenë me tërë qenien mendore e fizike për një të ardhme të Kosovës më të begatshme e më stabile dhe këtë e kemi obligim si qytetarë kosovarë të gjithë duke respektuar rendin, ligjin dhe institucionet e zgjedhura në Kosovë. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Bislum Hoti. Sabit Rrustemi dorëzon diskutimin e vet me shkrim dhe heq dorë prej fjalimit. Le të përgatitet pastaj Lirak Çelaj.

### **BISLIM HOTI:**

I nderuar zoti kryesues, të nderuar kolegë deputetë,  
Ndoshta paksa të lodhur, unë nuk dua të jam i gjatë. Pyetjet të cilat pata ndërmend t'i parashtroj përfaqësuesve Cadyy dhe Feiler nuk dua t'i bëj tani për arsye se po shoh se s'kemi kompetenca, por desha të lidhem në çështjet e sigurisë pasi që kjo është një çështje mjaft me rëndësi kur kemi parasysh mbrojtjen territoriale të Kosovës, kur kemi korrupsionin, kur kemi vrasje të fundit, e sigurisht edhe të atyre personave të maskuar që kohëve të fundit në rajonin e Hasit janë paraqitur me të madhe, kur në fshatin Pnish familja Pnishi jo vetëm që pati të lënduar, që përjetoi maltretime por përjetoi edhe vrasje, prandaj me këtë shohim qartë se në Kosovë ende nuk mund të krenohemi me një ligj të fortë të sigurisë, ligj ky i cili i jep prioritet veprimi atyre ekstremistëve të cilët janë të përcaktuar që ta shkatërrojnë ardhmërinë e Kosovës, njëherit që ta dëmtojnë dhe pengojnë ndërtimin e institucioneve tona shtetërore.

Unë këtu dua të them, sepse faktor kryesor për të gjitha problemet këtu, ndoshta është e hidhur për bashkësitë ndërkombëtare, por unë dua t'i fajësoj ata për arsye se duke pasur parasysh mëse një mijë të vrarë pas luftës, edhe një numër shumë të madh të atyre të cilët ende nuk dihet fati i tyre, këtu kuptoj se mëshihet diçka. Prandaj, rastet e pazbuluara nga ana e Policisë së UNMIK-ut apo të zbuluara por të fshehura jo vetëm që sjellin huti te popullata jonë, vëllezër, por me këtë kuptojmë se fusin edhe urrejtje në mes të partive tona politike, në mënyrë që pajtimi politik dhe ndëretnik në Kosovë mos të jetë stabil ashtu sipas parashikimeve tona dhe veç ka fituar të ndodhë një gjë e tillë.

Ju lutem durim edhe pak, sepse të gjitha rastet të cilat kanë ndodhur në Kosovë, Policia e UNMIK-ut gjithmonë, prej fillimit e deri më tani, është shprehë vetëm me fjalën – hetimet vazhdojnë. Dhe, nëse nuk e bëjnë transparente një gjë të tillë dhe kryesit t'i qesin në vepër me emër dhe mbiemër, mendoj se vrasjet në Kosovë ende do të vazhdojnë.

Prandaj, kërkoj që ne si parti politike të jemi parti të ofruara, të jemi parti të cilat do të mundohemi që pajtimi politik dhe ndëretnik të zëjë rrënjë fuqishëm në Kosovë dhe bashkërisht t'i luftojmë ata të cilët janë të përcaktuar ta dëmtojnë ardhmërinë tonë dhe të Kosovës dhe të na fusin përçarje politike. Në këtë drejtim ne duhet të bashkohemi dhe



ta bëjmë një strategji politike të përbashkët dhe të nxjerrim një rregullore që në Kosovë të mbizotërojë paqja dhe siguria. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Falemnderit zotë deputet. Lirak Çelaj, le të përgatitet Edita Tahiri. Ka kërkesa për pauzë, por pauza do të bëhet kur të përfundojnë diskutimet.

### **LIRAK ÇELAJ:**

E nderuar Kryesi, të nderuar kolegë,  
Ndodh që saherë të flitet për sigurinë apo pasigurinë në Kosovë, faktorët ndërkombëtarë menjëherë e mendojnë vetëm problemin e sigurisë së minoritarëve dhe në përputhje me interesat politike të vendeve që përfaqësojnë e dramatizojnë ose e minimizojnë atë, sikundër edhe disa liderë forcash politike vendore të cilët ata e përdorin si mjet për marketing politik, duke prezentuar veten në rolin e viktimës. Megjithatë, Kosova është vendi me më siguri në rajon. Por pavarësisht nga ky fakt, ai paraqet njërin nga problemet më shqetësuese për vendin, meqë me të lidhet jo vetëm e sotmja por edhe e ardhmja e saj, shijimi i lirisë, e pritur aq gjatë dhe e arritur me aq sakrifica për të arëdhmen sepse me të lidhen zhvillimi politik e ekonomik, të drejtat dhe liritë njerëzore, bazat e demokracisë, atij synimi dhe ideali universal njerëzor.

Nga ky kënd i vështrimit duhet të bëj një përpjekje që para jush të parashtoj shqetësimet e mia dhe shprehëj të gjithë brezit tim, që ishte brez pa fëmijëri, pa gëzime rinore dhe që u rrit nën kamxhikun e një regjimi policor tepër çnjerëzor. Dua të bëj përpjekje të identifikoj po nga këndi i brezit tim shkaqet e një gjoje të tillë.

E para, nuk e konsideroj si një problem që mund të jetë brengë e vetëm një partie a grupesh të tyre, as si vetëm i një force politike siç pretendohet, jo pa sukses, të prezentohet ai para opinionit. Pasiguria godet njësoj mbi të gjithë. Pa i amnistuar... pasojat që i la dhuna e regjimit që shkaktoi luftën, mendoj se fillimin e të keqës duhet ta lypim nga ditët e para të pasluftës kur asgjë nuk funksiononte, pos spekulantëve të njohur para e gjatë luftës, të cilët ndoshta edhe për interesa të shërbimeve sekrete serbe ose të forcave të errëta politike vendore s'lanë gjë pa bërë madje në emër të atyre që kishin vënë jetën në rrezik për lirinë e popullit dhe të vendit të vet, pra në emër të UÇK-ës. Të tillët as s'u ndoqën, as s'u penguan. Më vonë, ato që i bënë ata, do të përdoren për demonizimin e luftëtarëve të lirisë dhe natyrisht për marginalizimin e rolit të tyre në ringritjen e institucioneve të sistemit. Në ndërkohë heronjt e luftës përmes arrestimeve, sipas akuzave nga njerëz me të kaluar kriminale e të dyshimtë, që do t'i përbuzë çdo regjim qëllimshëm, shndërrohen në të mallkuar. Tërthorazi ose drejtpërdrejtë kush u vra – u vra krenaria e dinjiteti kombëtar. Në anën tjetër, kriminelët, flas edhe për ata ordererë, vazhduan të veprojnë thuaj të lirë, askush ata s'kishte kush t'i ndejë. Të huajt as s'i njohin ata as s'e njohin mentalitetin vendas, kurse vendorët të cilët me aftësinë e tyre profesionale intelektuale do të mund të ndihmonin, u panë me dyshim ose më vonë iu besuan role epizodike. Do të mund të përmendim këtu një listë të gjatë kuadrosh policorë, të

dëshmuar me aftësi profesionale dhe me nivel arsimor, të cilët nuk mund të përparojnë në hierarkinë e SHPK-ës pikërisht për shkak të pjesëmarrjes së tyre në luftën për lirinë e vendit e të popullit, sikur kjo të ishte një krim anipse të tillëve çdo popull dhe vend u këndon. Kam bindjen se po të ndodhte e kundërta, sot do të flasim me fjalë më pozitive për sigurinë në Kosovë. Në favor të këtij pohimi është Policia e komunikacionit, e përbërë kryesisht nga vendorët, të cilëve më herët u dhanë kompetencat prandaj tani mund të flasim për një gjendje shumë më të mirë në këtë fushë. Krimi në Kosovë me përmasa më të mëdha a më të vogël nuk ka pushuar që nga mbarimi i luftës...

### (Vërejtje e kryesuesit lidhur me zgjatjen e diskutimit)

...S' di si do ta rrumbullaksoj në atë mënyrë. Fatkeqësisht ai nuk u çrrënjës vetëm me deklaratat, akuza pa adresë ose me adresa të gabuara, zorra çorre nuk mjekohet me aspirina. Ndonjëherë madje kriminelët duken edhe më të organizuar se vetë mekanizmat që duhet ta pengojnë. Kur e sheh sjelljen praktike indiferente ndaj shfaqjeve dhe formave të krimit, që nuk janë tipike vetëm për Kosovën, s'ka si të mos lindë dyshimi për implikimin e strukturave më të larta në punë të pista, trafikimin me njerëz, me narkotikë, me karburantë, me duhan dhe mallra të tjera të cilët me zhurmë përpiqen ta shmangin dyshimin nga vetëvetja. Këtu nuk mendoj vetëm në strukturën ndërkombëtare që ushtrojnë të drejtën në këtë fushë, por edhe figurat tona politike të cilët asnjëherë nuk kanë bërë përpjekje që t'i bashkojnë forcat me të tjerët për të luftuar kundër krimit, por vetëm akuzojnë. Është folur për kontrabandimin e karburantëve me përmasa të mëdha. Megjithatë, por nuk e kam dëgjuar, të jenë ndëshkuar kontrabandistët e pra autobotët nuk janë xhiltë aq të padukshme sa të mos mund të shihen nga të gjithë ata pjesëtarë të KFOR-it dhe gjitha ato forca policore ndërkombëtare e vendore. Dihet edhe rrugët nga ato kanë mund të hyjnë në Kosovë. Me Malin e Zi vetëm një rrugë; me Serbinë sa diç unë 6 pika kalimi, me Maqedoninë 2 dhe me Shqipërinë deri tash 2 rrugë. Miliona pako me cigare kanë hyrë kontrabandë në Kosovë, prap të pahetuara dhe sikundër edhe karburantët e padoganuara.

Buxheti i Kosovës kështu ka humbur miliona euro, që kanë pasur në xhepat e tyre dhe që kanë vjedhur shtetin në këtë mënyrë. Gjithëato bordelë që veprojnë në Kosovë, po ashtu është e habitshme se nuk kanë mund të mbyllën dhe pronarët të ndëshkohen. Kosova nuk është aq e madhe dhe komunikimi në mes njerëzve e lokaliteteve aq i pamundshëm sa të mos u bihet në fije. Vazhdimisht flitet për ndërtimin pa leje, për uzurpimet banesash e lokalesh dhe për mostrazimin e autorëve, gjithnjë me arsyetimin se korrupsioni i ka fajet.

Kanë ndodhur pas lufte edhe forma të tjera më të rënda të krimit. Më shqetësueset kanë qenë vrasjet. Në vend që ato të luftoheshin me veprime të përbashkëta të forcave politike vendore në ç'mënyrë do të mund të sigurohej edhe bashkëpunimi i popullit me forcat kundër kriminelëve nga forcat e stërvitura për zhurmë në favor të marketingut politik janë përdorur me efikasitet për të kapur majet e pushtetit. Kush e ka pushtetin ka edhe paratë dhe anasjelltas dhe gjithnjë me gisht në drejtim – si vrasje politike, anipse sot e kësaj dite asnjë sosh nuk është argumentuar si e tillë. Por krimi është krim dhe nuk ka përkatësi

politike. Ai nuk mund të quhet ndryshe dhe si i tillë duhet të ndiqet e të ndëshkohet. Megjithatë, mungoi vullneti i koordinuar i forcave politike që bashkërisht të veprohet kundër tij.

Këto i përmenda për arsye se ato prodhojnë pasiguri dhe errësojnë perspektivën e Kosovës dhe në përgjithësi të shoqërisë kosovare që synon Evropën. Me krimin nuk shkohet atje, pavarësisht nga fakti se siguria është e drejtë e rezervuar për kryeadministratorin, pra për UNMIK-un, konsideroj se do të ishte e padrejtë që për gjendjen dramatike në këtë sferë të fajësojmë vetëm faktorin ndërkombëtar, i cili është këtu të ndihmojë ngritjen e një pushteti sipas standardeve të përparuara perëndimore, të ndihmojë zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës, gjithësesi për ne, me ndihmën tonë, e cila fatkeqësisht ose ka munguar ose ka qenë e pamjaftueshme. Duke qenë të përaçarë, të barikaduar në mentalitete që pretendon se “me mua fillon historia”, në fakt i ndihmohet krimit të pandëshkuar, të padëmkosur, i ndihmohet korrupsionit, i ndihmohet thellimit të varfërisë, errësimit të perspektivës. Fundja, cili do të ishte ai guximtar i mençur që do të investonte në një vend të pasigurtë. Bashkëpunimi pa paragjykime e kalkulime politike, i të gjitha forcave politike dhe pushteteve që kanë forcë vendimmarrëse zor të përmirësoj gjendjen. Fundja, kjo është për të mirën e ne të gjithëve. Falemnderit për durim.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Shpresojmë se të tjerët nuk do ta zgjasin, Lirak. E ka fjalën Edita Tahiri, le të përgatitet Agim Krasniqi.

#### **EDITA TAHIRI:**

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë,  
Jo rrallëherë jemi ballafaquar me probleme të rënda, mirëpo çështja me të cilën po merremi sot – gjendja e sigurisë në Kosovë na vë para një përgjegjësie të veçantë, duke na detyruar që të maksimalizojmë përpjekjet tona për të gjetur zgjidhje të drejta dhe urgjente.

Agjenda e sigurisë në Kosovë është rënduar me një spektër aspektesh komplekse. Mkrëpo, në diskutimin e sotëm, unë do të kufizohem vetëm në dimensionin e krimit, sepse ky është një problem që ka shkaktuar dhe po shkaktton shqetësime të mëdha tek qytetarët dhe institucionet e Kosovës. Përkundër faktit se në përgjithësi ka rënie të krimit në Kosovë nga mbarimi i luftës e këndeje, falë angazhimit të KFOR-it, UNMIK-ut dhe faktorit vendas, Kosova, për fat të keq, po vazhdon të vuajë nga fenomenet e krimit politik, etnik dhe krimit të organizuar. Është veçmas shqetësues fakti se një formë e krimit që po mbijeton këtu po gëlltit në heshtje personalitete të rëndësishme të Kosovës. Ky fenomen i trishtueshëm, që po e ndjek Kosovën, po qe se nuk luftohet me më shumë vendosmëri, rrezikon të shndërrohet në një kancer të shoqërisë sonë.

Siç dihet, angazhimet e institucioneve të sigurisë deri tash nuk kanë dhënë rezultate të duhura. Është e pashpjegueshme që asnjë rast nga krimet e rënda nuk ka arritur të



zbardhet. Përballë aq forcash të mëdha policore në Kosovë, mungesa e ndëshkimit të krimit, duket se ravigon para nesh paradoksin e krimit. Një konstatim i tillë flet më së mirë për gjendjen në Kosovë. Kjo lloj situatë shpjegon ankthin që është prezent. Ka një të keqe të tmerrshme, të cilës duhet kundërvënë. Mendoj se duhet bërë luftë për të penguar padrejtësinë dhe vrasjen. Vetëm një ndërhyrje energjike mund ta presë rrugën e këtij fenomeni, për ta lënë Kosovën të qetë, të ecë drejt demokracisë, pavarësisë dhe prosperitetit. Gjithë filozofia politike moderne mbështetet mbi shtetin ligjor, demokracinë dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve. Kosova dhe UNMIK-u kanë po këto synime. Mirëpo, arritjet e deritashme duken të pamjaftueshme, sepse efikasiteti i institucioneve të sigurisë ka mbetur pas realiteteve që po i krijojnë krimet enigmatike. Për një kohë fillestare mbase vetë vështirësitë e transicionit kanë mund të shërbejnë si justifikime për mosefikasitet. Mirëpo, sot, pas gati 4 vjetësh, si dhe pas investimeve të mëdha në ngritjen e kapaciteteve të policisë ndërkombëtare dhe asaj vendore, ato justifikime duken të paqëndrueshme.

Në fakt, mbase çështja duhet shtruar ndryshe. Përkundër asaj se çështjet e sigurisë janë kompetencë e rezervuar e PS të Sekretarit Gjeneral, ngecjet në këtë fushë, vetëvetiu nxisin nevojën e një partneriteti me institucionet vendore në luftë kundër krimit. Dikush edhe mund të pyet se çfarë kuptimi ka një mbledhje parlamentare për të diskutuar për sigurinë, derisa ne nuk kemi kurrfarë kompetencash dhe në të njëjtën kohë kemi votën e qytetarëve të Kosovës. Vërtetë është një situatë absurde, për të cilën jemi të gjithë të vetëdijshëm. Por, megjithatë, mendoj se zëri ynë do të duhej të dëgjohet. Madje, mendoj se ka qenë momenti i fundit që kjo çështje të dalë nga kornizat e diskutimeve joformale, respektivisht të bisedave e polemikave qytetare për t'u trajtuar institucionalisht aty ku e ka vendin në Kuvendin e Kosovës. Do të ishte e pafalshme që të lejojmë të humbasim kohë derisa Kosova është vënë në gjunjë nga krimi dhe vrasjet enigmatike.

Mendoj që sot për sot nuk ka prioritet më të madh për Kosovën sesa krijimi i sigurisë së mirëfilltë për të gjithë qytetarët e saj. Janë tre arsye kryesore që na detyrojnë për këtë:

- Së pari, sepse Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u janë të obliguar të garantojnë jetën, lirinë dhe pasurinë e qytetarëve të Kosovës,
- Së dyti, sepse pa një siguri të mirëfilltë Kosova nuk mund të ketë zhvillim ekonomik, respektivisht investime të huaja që janë bazë për hapjen e vendeve të reja të punës,
- Së treti, sepse siguria e mirëfillt në Kosovë është një shtyllë e fortë e sovranitetit dhe e pavarësisë së Kosovës.

Pra, kemi nevojë për një ndërgjegjsim të ri, jo me deklarata, por me veprime konkrete. Kjo do të thotë, në radhë të parë, zbritje në thellësi për të gjetur rrënjët e së keqës. Kemi nevojë për një bashkëpunim dhe vendosshmëri më të madhe në të gjitha nivelet relevante në mënyrë që lufta jonë kundër krimit të jetë e suksesshme. Duhet të gjejmë mënyrat se si të dillet nga ky paradoks i krimit në Kosovë. Mendoj dhe pres që ky debat i sotëm t'i shërbejë këtij qëllimi. Kemi nevojë për ide dhe propozime që do të ndihmojnë në



ndërtimin e një strategjie të re për çështjet e sigurisë në Kosovë. Në këtë kuadër, më lejoni që të paraqes para jush disa nga observimet e mia për këtë çështje dhe lus kryesuesin të mos më ndërprej meqë ishte tolerant edhe me kolegun e mëpëarshëm.

Gjykuar nga rrethanat e gjithanshme në Kosovë, mendoj se janë tri drejtime strategjike ku mund të përqëndrohet puna jonë në të ardhmen. Këto janë:

1. Rritja e efikasitetit të institucioneve të sigurisë;
2. Adresimi i qartë i përgjegjësive, dhe
3. Kultivimi i kulturës demokratike.

E para, për rritjen e efikasitetit të institucioneve të sigurisë, mendoj se duhet të ndërmerren këto hapa:

1. Të forcohet roli i Shërbimit Policor të Kosovës, për arsye të përparësive të saj ndaj policisë ndërkombëtre, e cila përballlet me pengesa objektive që kanë të bëjnë me gjuhë, kulturë apo mentalitet të ndryshëm;
2. Të krijohet këshilli për çështjet e sigurisë në Kosovë. Një trup i ngjashëm apo këshill për sigurinë nacionale vepron në vende të ndryshme. Ky trup do të bahkonte krerët e UNMIK-ut, KFOR-it dhe institucioneve vendore rreth çështjes së sigurisë. T'ju përkujtoj se një trup i këtillë ka vepruar në Kosovë deri para zgjedhjeve nacionale dhe është e çuditshme pse është shuar;
3. Të avancohet më tej puna e institucioneve të gjyqësisë në kuptim të pavarësisë së mëtejme si dhe të ndalet veprimi i strukturave paralele. Sa i përket çështjes së adresimit të përgjegjësive, kujtoj se këtu kemi të bëjmë qartë me përgjegjësinë e UNMIK-ut sepse ajo mban kompetencat e plota në fushën e sigurisë. Mirëpo, nuk mendoj se faktori vendor mund të lirohet tërësisht nga kjo përgjegjësi përkundër absurditetit të kompetencave.

Së fundit, kujtoj se duhet të punojmë më shumë në kultivimin e kulturës demokratike dhe kjo punë në radhë të parë i takon partive politike të Kosovës, të cilat kanë për detyrë që të rrisin angazhimin dhe përkushtimin e tyre për një bashkëpunim më të madh mes veti dhe me anëtarësitë e tyre. Po ashtu mendoj se si vend që kemi dalë nga lufta, është esenciale të ndërtojmë një proces të konsensusit apo pajtimit kombëtar rreth historisë së dhjetëvjeçarit. Pra, ky Kuvend duhet të nxjerrë një rezolutë të pajtimit kombëtar, të cilin e kanë bërë shumë vende që kanë dalë nga lufta. Këtë rrugë pra e kanë ndjekur edhe popuj tjerë që kanë dalë nga lufta dhe në këtë çështje unë shoh përgjegjësinë e subjekteve politike, të intelektualve të Kosovës, të mediave, të shoqërisë civile dhe të gjithë qytetarëve.

Të nderuar deputetë, jam e bindur se si edhe në sfidat tjera, ne edhe këtë rrugë të vështirë do ta përballojmë. Ju falemnderit.

## KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Ju falemnderit Editë. Gani Koci e ka dorëzuar me shkrim diskutimin. Agim Krasniqi, le të përgatitet Mevlyde Saraçi.

### GANI KOCI: (Diskutim i paraqitur me shkrim):

Kur flasim për sigurinë, kemi parasysh këto dimensione:

1. Siguria e integritetit të Kosovës,
2. Shtetet fqinje në raport me Kosovën,
3. Siguria kolektive e popullit të Kosovës,
4. Siguria e individit.

Sigurimni i integritetit territorial sipas Rezolutës së KS për Kosovën – 1244, është e garantuar nga NATO dhe KFOR-i. Sa dhe si është siguruar kufiri i Kosovës sot? A nuk jemi dëshmitarë se pjesë të Kosovës janë shkëputur arbitrarisht. A nuk jemi dëshmitarë se sot në Kosovë hyjnë dhe dalin të pakontrolluar kontingjente e mallëra të kontrabanduara. Hyjnë njerëz e grupe njerëzish me dhe pa dokumente identifikimi. Kanë ndodhur edhe rrëmbime e vrasje të qytetarëve të Kosovës mu në kufi ose nga matanë kufirit përgjatë gjithë vijës kufitare të Kosovës. Kanë ndodhur granatime të fshatrave kosovare (në Han të Elezit).

Moskontrollimi i Mitrovicës veriore dhe dy komunave të Leposaviqit dhe të Zubin-Potokut.

Granatimi i fshatit kufitar afër Hanit të Elezit. Shkëputja e 2500 hektarëve tokë në Debelldoi dhe plagosja e dy qytetarëve të këtij fshati, nga maqedonasit.

Përzjerja e fshatrave nga tokat e tyre në komunën e Dardanës duke mos i lejuar të punojnë, nga ushtgarët serbë.

Vrasja e fshatarëve duke prerë dru në pyll (Skenderaj)

Zënia peng e patrullës policore nga pala malazeze si dhe shumë shkelje të hapësirës kufitare të Kosovës, na bëjnë të kuptojmë sa mbrohet dhe sigurohet Kosova.

Unë konsideroj se mospasiguri i kufirit dhe tërësisë territoriale të Kosovës, domosdo prodhon edhe pasiguri politike, ekonomike, publike dhe individuale.

Situata dhe rrethanat tek fqinjt, raportet dhe qëndrimet e tyre ndaj Kosovës si dhe veprimi i hapur dhe i papenguar i agjenturave të tyre krijojnë jostabilitet në Kosovë. Mosnjohja e realitetit të krijuar nga lufta e këtij, përpjekjet qëllimkëqia për destabilizimin dhe

ripushtimin e Kosovës, ishin dhe janë evidente edhe në Serbi edhe në Maqedoni, edhe në Mal të Zi.

Ndikimi i hapur në etnitë joshqiptare nga fqinjët për veprime destruktive dhe jokooperuese me institucionet ndërkombëtare dhe vendore, të gjitha këto krijojnë vetëm pasiguri.

Për shkak të kundërthënieve dhe antagonizmave politike, për shkak të qëllimeve dominuese, për shkak të ruajtjes dhe krijimit të privilegjeve, duke e marrë dhe ruajt me çdo kusht pushtetin, vetëm që të mos zbulohet destruktiviteti dhe veprimet qyqare kolaboracioniste gjatë kohës së luftës së lavdishme të UÇK, në një kategori njerëzish përdoren forma dhe veprime të pajustificueshme për të njollosur dhe dënuar luftëtarët e lirisë.

Të tjerët, duke gjetur hapësirë, përkrahje dhe bashkëpunim me agjencitë e ndryshme të fqinjeve, sidomos nga Serbia, në radhët e UNMIK-ut ndikojnë që edhe dënimet t'u caktohen, bazuar në ligjet e ish Jugosllavisë e të Serbisë së Millosheviqit. Dëshmitarë të rrejshëm dhe të paguar u ofrojnë prokurorëve dëshmi mbi bazën e të cilave ngriten aktakuza dhe shpallen dënimet nga gjykatat e UNMIK-ut për luftëtarët e lirisë. Udhëroni, ju lutem nëpër burgjet e Kosovës, nuk ke të tjerë vetëm ish pjesëtarë të UÇK. Kjo dëshmon se atë që nuk mundi ta bëjë Serbia me tërë makinerinë ushtarake po e bën dikush tjetër sot në një formë tjetër.

Kështu inskenohen procese të burgosjeve dhe gjykimeve, siç janë: procesi i Merdarit, procesi "Drini", procesi i Llapit, procesi i Dukagjinit, si dhe burgosjet e qindra luftëtarëve e të komandantëve të UÇK. Shembull: Ruzhdi Saramati, Gani Imeri, Afrim Zeqiri, Alush Shala e shumë të tjerë që janë arrestuar e që nuk dihet përse janë arrestuar, janë kushtëzuar, iu janë ofruar shuma të mëdha të parave, për të bashkëpunuar e shpifur kundër pjesëtarëve të burgosur të UÇK dhe kundër atyre eprorëve që akoma janë në liri. Ruzhdi Saramati, torturohet nga se nuk pranon bashkëpunim në dëm të të tjerëve. Alush Shala kushtëzohet me lirim nga burgju dhe i ofrohet një shumë e madhe parash që të shpifë kundër gjeneral Sali Veselit; Halil Çadrakut i ofrohen 400 mijë DM për të dëshmuar kundër Sali Veselit. Po ashtu arrestohet dhe kushtëzohet si dhe ofrohen shuma të parave për të dëshmuar rrejshëm edhe Fazli Neziri. Gani Imerit i ofrohen shuma të mëdha parash si dhe strehim ku të dëshironte vetëm të dëshmojë kundër ish udhëheqësve të shtabit të UÇK.

Por, këta dëshmitarë ishin të guximshëm dhe këtë e deklaruan edhe publikisht. Shtrohet pyetja: sa e sa të tjerë nuk kanë guximin qytetarë dhe kombëtar për të treguar për presionet, shantazhet dhe kërcnimet që iu bëhen nga organet e hetuesisë për të dëshmuar rrejshëm.

Përse i dënon ata që do t'i dënonte Serbia, pse në UNMIK ka njerëz që punojnë në interes të Serbisë. Sa ish bashkëpunëtorë shqiptarë të UDB-ës jugosllave punojnë dhe janë të inkuadruar në organet e UNMIK-ut. Sa dëshmitarë të rrejshëm dezorientojnë zbulimin e

kriminelëve dhe përfitojnë privilegje dhe joshje nga UNMIK-u, si dhe mbrojtje, para, armë pa leje si dhe benificione tjera.

Këto dhe çështje të tjera të kësaj natyre le të jenë objekt i analizave dhe shqyrtimeve të mekanizmave përkatës. Unë konsideroj se moslejimi, nënçmimi dhe mosbesimi në faktorin vendor dhe në institucione vendore, të merren dhe të mbajnë përgjegjësitë bashkë me ndërkombëtarët në të gjitha aspektet e mbrojtjes dhe të sigurisë të Kosovës vetëm se mund të prodhojnë pasiguri të përgjithshme. **(Pason nënshkrimi).**

### AGIM KRASNIQI:

E nderuar Kryesi, të nderuar deputetë,

Unë materialin tim do ta dorëzoj me shkrim, mirëpo diçka nga ky material do të provoj ta lexoj.

Kur të gjithë angazhohemi për ngritjen e institucioneve demokratike sot dhe kur insistojmë t'i realizojmë synimet tona për ndërtimin e shoqërisë demokratike dhe integrimin e Kosovës në bashkësinë e shteteve demokratike dhe në organizmat ndërkombëtarë, Kosovës i nevojitet më shumë se asnjëherë më parë një siguri stabile, individuale dhe publike, meqë mungesa e sigurisë publike mund ta rrezikojë demokracinë në Kosovë, për të cilën bashkësia ndërkombëtare dhe shoqëria kosovare kanë investuar shumë.

Në krahasim me periudhën e pasluftës, përkatësisht pas vitit të parë, mund të konkludohet se situata e përgjithshme e sigurisë në Kosovë ka njohur trendet e fillimit të stabilizimit, falë angazhimit të jashtëzakonshëm të forcave të KFOR-it dhe më pas në një masë edhe të Policisë ndërkombëtare si të vetmet forca zyrtarisht kompetente dhe të autorizuar. Mirëpo, për shkak të shumë rrethanave, ky trend nuk është zhvilluar në përputhje me nevojat e dinamikës së filluar të transformimeve të përgjithshme në Kosovë nën udhëheqjen e UNMIK-ut dhe mbështetjen e faktorëve tjerë relevantë vendorë e ndërkombëtarë.

Megjithë përpjekjet e faktorit ndërkombëtar dhe atij vendor në drejtim të stabilizimit të rendit dhe të sigurisë, me shqetësim mund të konkludojmë se përkrah të arriturve të caktuara pozitive, duket se gjendja e sigurisë në Kosovë, në disa segmente, ka marrë trende të tilla negative të cilat kërkojnë që të ndërmerren masa urgjente parandaluese para se këto zhvillime të rrezikojnë dinamikën e transicionit në Kosovë. Këtu e kam fjalën për vrasjen e figurave emblematike të jetës publike në Kosovë, personaliteteve që vërtetë kanë kontribuar dhe kanë dhënë shumë dhe sot nuk janë në mesin e të gjallëve. Për këtë u fol me të madhe, madje edhe pati kualifikime rreth motiveve të vrasjes dhe likuidimit të tyre.

Ndër faktorët influencues për shkallëzimin negativ të gjendjes, përveç tjerash, desha t'i numëroj edhe këto që në të gjitha diskutimet dhe angazhimet e tjerëve që folën edhe më



parë, do t'ishin krimi, pastaj krimi i organizuar, kriminaliteti ekonomik, trafiku me njerëz, prostitucioni, kontrabanda, madje edhe aktet terroriste sikur që ishte autobomba në Prishtinë dhe disa të tjera. Pastaj, posedimi ilegal i armëve, cenimi i stabilitetit politik, institucional dhe ekonomik e social në Kosovë; ndikimi negativ nga ndëryhryet sistematike të Serbisë, në mënyra të ndryshme, mungesa e juridiksionit të plotë në tërë territorin e Kosovës; cenimi i integritetit territorial të Kosovës dhe situata përgjatë kufirit; çështja e Mitrovicës dhe enklavave; çështja e sigurisë së pjesëshme të disa minoriteteve; mungesa e institucionit të mirëfillt që ishte një kërkesë edhe këtu që ta kemi ministrinë e drejtësisë dhe disa ministri tjera që neve na duhen.

Desha, po them në mënyrë fragmentare të nxjerr nga përgatitja me shkrim që kam bërë një konstatim se kur është fjala për krimin e organizuar disa herë është cekur, madje edhe publikisht, se faktori ndërkombëtar pa bashkëpunim të ngushtë dhe pa ndihmën e institucioneve dhe faktorëve tjerë vendorë nuk mund të zhvillojë luftë të suksesshme. Në këtë drejtim, nga ndërkombëtarët janë marrë hapa të cilët në një masë kanë ndikuar në një përqindje të caktuar të uljes periodike të krimit të organizuar dhe faktorëve tjerë që cenojnë sigurinë por defektet që kanë përcjell këtë proces më shumë kanë sjellur në shprehje strukjen se sa zhdukjen e krimit të organizuar në Kosovë.

### **Siguria në Kosovë nga prizma e funksionimit të sistemit gjyqësor të Kosovës**

Barra kryesore për ruajtjen e kësaj sigurie, përveç KFOR-it dhe shërbimeve policore, bie edhe mbi organet gjyqësore, andaj funksionimi i mirëfillt dhe shtrirja e juridiksionit të tyre në tërë territorin e Kosovës është sine qua non për sigurinë dhe realizimin e barabartë të të drejtave të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Aq më tepër kur pa u mbushur një vit nga përfundimi i luftës, u bë rindërtimi i tërë sistemit gjyqësor, të rrënuar gjatë viteve të nëntëdhjeta.

Duke u nisur nga fakti se Kosova po përballet me llojet e ndryshme të krimeve, është i domosdoshëm forcimi i judikaturës penale, që do të krijonte kushte më të mira sigurie për qytetarët e Kosovës. Por, edhe judikatura civile, e cila gjithashtu merret me zbatimin në jetë të ligjeve, duhet forcuar, sepse jo rrallherë shumica e krimeve janë të lidhura me çështje civile, siç është prona dhe të drejtat e tjera që derivojnë nga ajo, marrëdhëniet e punës e tjera.

Për të funksionuar më mirë dhe për të arritur ynimet e veta, sidomos në krimin e sigurisë dhe luftimin e çfarëdo krimi, organet e judikaturës, puna e të cilëve është punë publike, e vështirë dhe e lidhur me rrezik, duhet ta kenë ndihmën e të gjithë qytetarëve dhe mbështetjen e institucioneve të Kosovës, por mbi të gjitha, siguri i infrastrukturës adekuate ligjore nga fusha e judikaturës penale dhe lidhur me pronën.

Ndihma e qytetarëve organeve të ndjekjes dhe atre të judikaturës nënkupton paraqitjen e keqbërësve për vepra penale. Por ky bashkëpunim mund të realizohet nëse u garantohej mbrojtja e efikase dëshmitarëve dhe të dëmtuarve dhe nëse hartohet një plan detaj për mbrojtjen e tyre.

Me mbështetje të instituconeve të Kosovës nënkuptojmë respektimin e organeve të judikaturës, respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve dhe sigurimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

Ajo që më së shumti do t'i bënte efikase organet e judikaturës në ushtrimin e funksionit të tyre është siguria e vet bartësve të funksioneve të organeve të juridikaturës, që të mos përsëritet kërcnimi serioz dhe likuidimi i tyre, siç kemi pasë rastin me disa gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë. Po, për efikasitet më të mirë nevojitet edhe siguri i pavarësisë ekonomike dhe i pavarësisë në aspektin e mosinterferimit të pushtetit ekzekutiv në punën e tyre.

Natyrisht, kur flitet për sigurinë ublike e individuale dhe për relaizimin e të drejtave individuale të qytetarëve të Kosovës, në mënyrë të barabartë, duhet të potencohet se kjo mund të realizohet vetëm përmes sundimit të ligjit dhe funksionimit të shtetit ligjor.

### **Roli i mediave në aspektin e sigurisë**

Për të ndihmuar në arritjen e një sigurie më të mirë në Kosovë, si në marrëdhëniet ndëretnike po edhe brfenda një etnie të vetme, apo thënë më drejtë, edhe brendashqiptare, masmediat në Kosovë mund të luajnë dhe do të duhej të luajnë rol edhe më të madh pozitiv.

Nëse vlerësohet ndihmesa e deritashme e këtyre masmediumeve, mbetet shumëçka për t'u dëshiruar, sidomos ndihmesa e mediave dhe kontributi i tyre në raportet brendashqiptare, po pse jo, edhe të shqiptarëve me bashkësitë e tjera.

Masmediat në Kosovë, me një argumentim të saktë dhe profesional, mund të ndihmojnë shumë procesin e sigurisë në Kosovë, duke iu shmangur kështu sypozimeve, mbështetjeve në burime të padefinuara dhe spekulime, e edhe duke iu përmbajtur ligjeve apo rregullave të komunikimit publik. Megjithëse para këtyre ligjeve ekziston kodeksi i gazetarisë, që është kod moral, po edhe profesional edhe i masmediumeve tona, ani se fatkeqësisht kjo nuk është zbatuar dhe nuk po zbatohet në masën e nevojshme.

Ato e kanë edhe obligim për t'i ndihmuar këto procese, gjithnjë në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe të avancimit të proceseve demokratike, transparencës dhe zhvillimeve integruese në rajon dhe në Evropë.

Po e tejkaloj një pjesë, pasi që kam vërejtje nga kryesuesi. Në fund më lejoni t'i propozoj rekomandimet për mbrojtjen dhe ngritjen e shkallës së sigurisë në Kosovë.

- Ngritja në nivel më të lartë të stabilitetit të përgjithshëm politik, si faktor shumë i rëndësishëm për stabilitetin edhe në pikëpamje të sigurisë;

- Përsheptimi i konsolidimit dhe avancimit të institucionit të drejtësisë, që më herët përmenda ministrinë e drejtësisë;
- Përsheptimi i ndërtimit, plotësimit dhe dhënies së përgjegjësive dhe kompetencave SHPK-ës duke korrigjuar paraprakisht disa devijime sistematike me rastin e procesit të seleksionimit të kuadrove policore si dhe menjanjimin e disa dobësive në organizimin dhe sistemin mbi bazat e përgatitjes dhe aftësive profesionale. Pastaj nuk do të ishte një kërkesë e pabazë nëse eventualisht edhe pse u fol për shërbimet e ndryshme, për shërbimin inteligjent të Kosovës, që megjithatë ose në formë të një këshilli për siguri që u propozua më herët edhe prej Editës, ose me një emërtim tjetër, por megjithatë një trup i cili do të ishte gjithashtu nën kontroll të faktorit ndërkombëtar por në masë të madhe të përbëhej edhe nga ata vendorë në mënyrë që të jepë kontributin e vet në luftimin e krimit dhe krimit të organizuar në Kosovë;
- Bartja më e shpejtë e shumë kompetencave me prioritet nga ndërkombëtarët në vendorët;
- Krijimi i kushteve për sigurinë e lëvizjes për të gjithë qytetarët e Kosovës;
- Kontrolli i kufirit, lëvizjes së njerëzve dhe mallrave;
- Parandalimi i aktiviteteve negative informative nga jashtë;
- Aplikimi i ligjit për ambajtje pa leje;
- Informimi sistematik i Kuvendit të Kosovës për gjendjen e sigurisë, e tjera.

(Diskutimi është paraqitur pjesërisht me gojë dhe pjesërisht me shkrim)

**KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Deputeti Mahmut Bakalli, heq dorë nga diskutimi dhe i dorëzon me shkrim konkluzat të cilat do t'i ketë parasysh grupi, Mevlyde Saraçi, le të përgatitet Sanije Alijaj.

## MAHMUT BAKALLI (Diskutim i paraqitur me shkrim)

Në konkluzë duhet të hyjë:

1. Me qëllim të parandalimit të krimit në Kosovë është e domosdoshme koordinimi i të gjitha shërbimeve sekrete që veprojnë në Kosovë dhe krijimi i një qendre efikase koordinuese e shërbimit informativ;
2. Të ndalohen sulmet dhe akuzat e pabaza për krime në mediat dhe deklaratimet publike, sepse edhe kjo është krim apo nxitje e krimit;
3. Në çështjet e sigurisë dhe të luftës kundër krimit nevojitet partneriteti i institucioneve kosovare, të UNMIK-it dhe KFOR-it, pa marrë parasysh se kompetencë e cilit janë në këtë moment. **(Pason nënshkrimi)**

## MEVLYDE SARACI:

E nderuar Kryesi, të nderuar kolegë deputetë,

Tema e cila po trajtohet sot është mjaft e gjerë dhe komplekse. Sidoqoftë, unë do të ndalem në trajtimin e këtij problemi në media. Jemi të vetëdijshëm të gjithë se kjo temë nuk ka pasur qasje të drejtë në të gjitha mediat. Po hyjmë në vitin e katërt të lirisë së Kosovës, në të cilën periudhë u vranë dhjetëra figura politike. Vrasjet dhe dhuna politike nuk u ndalën. Përkundrazi, po vazhdojnë dhe nuk janë duke dhënë shenja të ndërprerjes së tyre, fatkeqësisht.

Si deputete e Parlamentit të Kosovës, më brengos fakti se shkrimet në gazetën tona, apo transmetimet e lajmeve në mediat elektronike, sikur janë duke shkruar në drejtime të ndryshme kundrejt njëra-tjetrës. Dhe, njeriu duhet të përcjellë disa nga emisionet e lajmeve apo të lexojë disa nga gazetën e ndryshme për të gjetur ndonjë informatë të vërtetë për ngjarjet që ndodhin në Kosovë dhe gjetiu. Nuk jam nga ata që dëshirojnë një dorë të fortë mbi fjalën e lirë, por gjithësesi kam të drejtë të kërkoj që së paku mediat dhe vetë gazetarët të kenë një përgjegjësi më të madhe ndaj fjalës publike dhe të sillen konform kodeksit të gazetarit. Po ashtu jemi dëshmitarë se shumë gazetarë të paformuar dhe të pakualifikuar bëjnë shkrimet tendencioze dhe të njëanshme. Duke fryer shkrimet e tyre të ndryshme me insinuata dhe tendenca po iritohet edhe vetë masa.

Dua të nisem nga fillimi i pasluftës. Dhuna filloi mbi veprimtarët e LDK pikërisht, në mënyrë të ndryshme, por jo vetëm mbi ata. Ajo u përcoll edhe mbi familjarët e tyre dhe pasuan pastaj vrasjet mbi veprimtarët politikë të LDK. Një pjesë e mediave nuk theksoi asnjëherë ngjarjen ashtu siç ishte. Tendencat nga qarqet e ndryshme ishin dhe janë që dhuna politike të mos prezentohet si e tillë por vetëm si rast dhune dhe pavarësisht nga



mediat popullata është dëshmitare e drejtpërdrejtë dhe po e sheh dhe gjykon vetë këtë dhunë mbi veprimtarët politikë e sidomos të LDK. Sidomos thuhet e konstatohet se kishte dhe ka dhunë politike në Kosovë dhe kjo nuk pritët të thuhet vetëm nga mediat. Konsideroj se sikur të gjitha informacionet dhe mesazhet të përcillen në mënyrë të drejtë gjer tek lexuesi apo shikuesi, atëherë edhe nuk do të kishte nxitje të dhunës mbi njerëzit apo veprimtarë të caktuar por secili qytetar do të kishte informata të drejta dhe vetë do t'i gjykonte këto ngjarje.

Gjatë fushatës parazgjedhore të zgjedhjeve lokale të vitit 2000 u shtrua dhunë ndaj aktivistëve politikë dhe kjo gjë sikur kaloi në heshtje apo aty-këtu u publikua vetëm shkurtimisht. Pasuan krimet politike mbi veprimtarët politikë në pikë të ditës dhe në mes të rrugës. Disa nga mediat këto krime i prezentuan me emër, ndërkaq disa nga to dhanë edhe kualifikime nga më të ndryshmet. Shumherë nga autorë dhe media të ndryshme rastet e krimeve u gjykuan nga ana e gazetarëve në bazë të përcaktimeve të tyre politike.

### KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

I lus deputetët të kenë konsideratë. Juve ju kam toleruar 7 minuta, 2 minuta tejkalim. Pasi e keni më shkrim, dorëzoni më shkrim dhe grupi këtë do ta ketë parasysh. Atëherë, ju kisha lutur ta rrumbullaksoni.

### MEVLYDE SARACI:

Ju lutem, ne atje në fund, edhe nuk po kemi mundësi të prezentohemi dhe kur po dalim, po na merret e drejta e fjalës: Unë konsideroj se gjithçka duhet të fillojë nga parlamenti, toleranca, sepse ne ishim dëshmitarë në fillim, 10 minuta ishin vetëm për parashtrimin e pyetjeve, prandaj të lutem është e drejtë. Unë do të vazhdoja. Disa nga mediat këto krime i prezentuan me emër, ndërkaq disa nga to dhanë kualifikime nga më të ndryshmet. Sigurisht se kodeksi gazetaresk nuk lejon këtë komoditet pa kurrfarë përgjegjësie. Ne të gjithë e dijmë se çështja e sigurisë bie drejtpërdrejt në kompetencat e UNMIK-ut e të KFOR-it, andaj edhe nga të gjitha këto media do të duhej të pasqyrohej sukcesi apo mossuksesi i aktivitetit të këtij sektori kaq të rëndësishëm. Po ashtu jemi të vetëdijshëm se është shtuar numri i policëve në kuadër të SHP të Kosovës, por gjithnjë me kompetenca mjaft të cinguara, ndërkaq Policia e UNMIK-ut akoma nuk po mund t'i zbulojë asnjë nga rastet, përkundër kompetencave të tyre të plota.

Konsideroj se përmes mediave duhet inkurajuar qytetarët për një bashkëpunim më të madh me Policinë e Kosovës e cila ka për qëllim mbrojtjen dhe integritetin e qytetarit dhe të pasurisë. Ndoshta përmes pasqyrimeve të ndryshme, opinioni do të bindej se vërtetë duhet një bashkëpunim më i madh me policinë. Çështje tjetër që u mungon mediave të

ndryshme është edhe mosrespektimi i institucioneve demokratike të Kosovës dhe personaliteteve që udhëheqin këto institucione.

Nuk mendoj se dikush është i paprekshëm, por edhe nuk e kuptoj se me çfarë të drejtash disa sish shkojnë aq larg sa mendojnë se ata janë edhe gazetarë por edhe prokurorë e gjyqtarë. Këto probleme dalin në mungesë të një ligji të mirëfilltë mbi mediat, i cili do të duhej aprovuar në Parlament dhe në bazë të të cilit edhe do të duhej të bëhej një informim sa më i drejtë dhe sa më i përgjegjshëm qoftë i gazetarëve qoftë i institucioneve. Nëse për asgjë tjetër, për hirë të mbrojtjes së profesionalizmit dhe vetë gazetarëve të cilët njëri nga ata, për hirë të së vërtetës, ka rënë edhe viktimë. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Sanije Alijaj, le të përgatitet Nimon Alimusaj.

### **SANIJE ALIJAJ:**

I nderuar kryesues, të nderuar kolegë,  
Në prezentimin tim do të bëj përpjekje t'i theksoj disa gjëra që konsideroj i ndihmojnë sigurisë në Kosovë. Mirë është që sot në Parlament po flitet për sigurinë e Kosovës, sepse duke bërë përpjekje për t'u luftuar dhuna, korrupsioni dhe krimi i organizuar njëkohësisht afirmohet funksionimi i shtetit ligjor, paqja dhe ndërtimi i demokracisë së mirëfilltë në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Çështja e sigurisë në Kosovë, marrë në përgjithësi, është e mirë. Mirëpo, duke u nisur nga incidenti që ndodhi mbrëmë në Pejë, konsideroj se këto akte janë kundër institucioneve të Kosovës dhe kundër ndërkombëtarëve në Kosovë. Mirëpo, duke ditur se në Kosovë veprojnë dhe funksionojnë institucione demokratike vendore dhe ato të UNMIK-ut e KFOR-it, duhet bërë përpjekje që Kosova të jetë shembull i rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik, e kjo arrihet vetëm nëse me të gjitha energjitë dhe dijet tona angazhohemi për një sabilitet dhe siguri për qytetarët tanë.

Konsideroj se në Kosovë sigurisë i paraprinë afirmimi dhe përkrahja e institucioneve shtetërore të dala nga vota e lirë e qytetarëve, si rrugë e vetme e ndërtimit dhe funksionimit të shtetit demokratik, në radhë të parë nga të gjitha mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë.

Partitë politike, rolin e tyre ta ushtrojnë përmes metodave universale të udhëheqjes bashkëkohore dhe demokratike për krijimin e shoqërisë dhe shtetit mbi bazat e lojës fer dhe korrekte për luftën për pushtet. Ashtu siç veprojnë popujt e përparuar që kanë rend shoqëror, pluralist dhe demokratik, që politikën e tyre nacionale e shtetërore e konceptojnë, krijojnë dhe zbatojnë përmes mekanizmave përkatës institucionale e jo

përmes filozofive politike të cilat nuk garantojnë kurrfarë perspektive. Partitë politike, përmes mekanizmave të shtrirjes dhe organizimit të tyre, duhet të lancojnë filozofinë e tyre politike drejt zvogëlimit të kundërshtimeve dhe urrejtjeve në të gjitha rrafshet brenda strukturave të ndryshme të shoqërisë nga ato rurale, deri te ato urbane, për afirmimin e vetëdijes që secili t'i kryejë obligimet e detyrat e veta për ndërtimin e shoqërisë demokratike, brenda së cilës gjërat qo të funksionojnë mbi bazat e ndërgjegjes kolektive dhe me përmbajtje kombëtare si interes i përbashkët, siç kanë vepruar shumë popuj të përparuar e demokratik, sidomos Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Duke i falënderuar rrezistencës sonë dhe përkrahjes së botës demokratike dhe intervenimit të NATO-s në Kosovë, Kosova në shekullin e 21-të hyri e lirë dhe me institucionet demokratike. Mirëpo, disa veprime të pamira dhe krimet që po ndodhin pas luftës në Kosovë, e prishin imazhin e mirë të saj. Vetëm pas luftës në Kosovë janë vrarë rreth 20 intelektual dhe veprimtarë politikë, shumica e të cilëve janë veprimtarë të Lidhjes Demokratike. Kjo është dhembje dhe humbje e madhe për qytetarët tanë. Dhembja është edhe më e madhe se asnjë rast deri më tash nuk është ndriçuar. Kryesit e krimit nuk kanë dalur para drejtësisë. Për këtë një pjesë të përgjegjësive e kanë ndërkombëtarët që e bëjnë sigurinë e Kosovës, por faji çdoherë nuk duhet mbetur jetim. Ai ndodhet edhe në radhët e shoqërisë sonë. E jona në Parlament është ta zvogëlojmë këtë faj, duke zvogëluar fyrtet dhe akuzat ndërmjet subjekteve politike.

**Propagandën mediale të mjeteve të informimit.** Mediat e shkruara dhe elektronike në radhë të parë moto të punës e kanë lirinë e shkrimit, por nuk duhet harruar se është nderë dhe detyrë kombëtare t'i afirmojnë vlerat e mirëfillta të shoqërisë sonë, të afirmojnë punën e institucioneve e jo kryesisht të merren me lajmet e ditës që ndonjëherë janë të paargumentuara.

SHPK-ja të jetë e papolitizuar dhe së bashku me Policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in dhe institucionet vendore të luftojnë më efektshëm krimin e organizuar të të gjitha formave dhe ngjyrave.

Shërbimet në dogana, të kryejnë detyrën në nivel të lartë në mënyrë që të zvogëlohet tregtia ilegale sepse kjo dëmton buxhetin dhe perspektiven e Kosovës. Për këtë jam e bindur se mund ta bëjmë nëse do të kemi vullnet dhe përgjegjësi. Kjo përpjekje është e gjatë dhe e ngadalshme, por kur problemet shtrohen sikur sot në Parlament, fillojnë të zgjidhen dhe zvogëlohen. Për ta bërë Kosovën shtet duhet kryer me nderë detyrën profesionale secili në vend të vet, duke çelë sytë për t'i larguar veprimet e pamira nga prakti ui shtëpisë dhe radhët tona sepse ashtu siç thotë një fjalë e urtë "në errësirë duhet dritë, e në liri duhet mendje dhe ligj". Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Nimon Alimusaj, le të përgatitet Fadil Geci.

## NIMON ALIMUSAJ:

I nderuar kryesues, të nderuar kolegë,  
Nga diskutimet paraprake që nuk ishin të pakta, mendoj se mund të nxirret një konstatim se të gjithë jemi të një mendjeje se krimi i organizuar e sidomos vrasja e atyre që quhen figura publike, madje figura eminente publike, është dukuria më e rrezikshme që e dëmton të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës. Por akoma më i sakt është konstatimi se kjo dukuri është shqetësimi më i madh i popullatës shqiptare në përgjithësi. Ata që kanë marrë pjesë në tubimet mortore të këtij viti të fundit, që nga Smajl Hajdari e deri te anëtarët e familjes Zemaj, duke parë disa dhjetëramijëra qytetarë të marrin pjesë në tubimet mortore, nxjerrim konstatimin se popullatës shqiptare i ka ardhur mbi krye kjo dukuri dhe këto tubime kaq të fuqishme unë i marr si mesazh i të gjithë atyre që janë të obligueshëm të merren me këtë dukuri që ta kryejnë detyrën e vet.

Këtij shqetësimi gjithpopullor i vijnë si ngushëllim e i erdhën edhe sot nga përfaqësuesit e jashtëm statistika me të dhëna se dukuria e vrasjeve është në rënie dhe se siguria e qytetarëve është gjithnjë e më e mirë. Kjo është e vërtetë por akoma më e vërtetë është edhe konstatimi se vrasja e një shtrese, që unë e quajta në fillim, figura publike vazhdon të jetë me kontinuitet, madje ndonjëherë edhe në rritje.

Duke pasur parasysh emrat e këtyre figurave – udhëheqës partiakë, kryetarë komunash, këshilltarë liderësh, figura aushtarake, gazetarë, e tjerë, duke pasur parasysh kohën, rrethanat, mënyrën e vrasjeve, përjashtimin e mundësisë së hakmarrjes së konflikteve individuale familjare, të përjashtimit të mundësisë së fitimeve materiale, na lejohet të konstatojmë se këto vrasje nuk mund të kenë motiv tjetër përveç motivin politik. Disa nga këto figura, siç është Xhemajl Mustafa, Smajl Hajdaraj, Ukë Bytyqi e tjerë, në jetën e tyre, ne që i njohim, nuk kanë nxjerrë ndonjë fjalë të trashë apo nuk kanë bërë ndonjë veprim të trashë që të mund të kërkohet diku një motiv tjetër për vrasjen e tyre.

Çështje tjetër që shtyn të mendosh është edhe kjo – këto vrasje përgjithësisht në pritë, nuk janë të përsosura si u dëgjua nga shumë diskutues. Në anën tjetër, dihet se krimi i organizuar ndiqet nga ekipe ekspertësh, me teknikë të përsosur, megjithatë asnjë rast nga këto për të cilat unë e kam fjalën nuk është zbuluar. Kjo na jep të drejtë të nxjerrim edhe një konstatim se faktori i caktuar të ndjek këto krime nuk ka kryer si duhet barrën e vet. Aludoj menjëherë te Policia e UNMIK-ut. Një pjesë e fajit i është adresuar edhe qytetarëve për mosbashkëpunim me Policinë e UNMIK-ut. Është e vërtetë kjo. Që të mos jetë kështu, punën e mirë do të mund ta bënim ne aktivistët e partive politike në terren që të kultivojmë ndjenjën e asaj që quhet trimëri moderne apo, si e paska quajtur Klintoni me një kurajo civile. Do të thoshim se e kemi arritur këtë trimëri moderne ku do të diktojmë me gisht nga vrojtësit kriminelë që vret, atëherë kur vrasësit e figurave politike siç ishin këto që i përmenda nuk do të manifestohen as me një të shtëne pushke në shenjë shenjllaku, në shenjë festimi për vrasjen e tyre. E këto i kemi pasur.



U adresua shumëherë edhe moskryerja efektive ose ana negative e mjeteve të informimit. Edhe këtu lypset një adresim i sakt i këtyre përgjegjësive. Unë do të kujtoj se do të kemi shtyp të mirë që do të luftojë krimin e organizuar atëherë kur nuk do të kishim ndonjë shkrim siç ishte ai për vrasjen e Smajl Hajdarajt i cili thotë se “vrasja u krye sepse gjatë një seance të Parlamentit ky deputet ndejti me një deputet të një partie tjetër” dhe si rezultat pësoi vrasja e tij. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. E ka fjalën Fadil Geci, le të përgatitet Bajrush Xhemajli.

#### **FADIL GECI:**

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë,  
Për të diskutuar për këtë çështje gjithësesi është dashur që të jeshë prezent në rrjedhat e Kosovës gjatë luftës dhe pas luftës. Është një temë shumë komplekse dhe është koha e fundit që, unë mendoj, duhet të flitet haptas dhe të ndëshkohet krimi i organizuar kundër institucioneve, kundër njerëzve të cilët janë të zgjedhur nga vota e popullit. Këtu vlejnjë t'i bëjmë disa pyetje: kush janë njerëzit që bëjnë krime; kur ka filluar; ku e ka mbështetjen dhe kush janë njerëzit që qëndrojnë pas këtij krimi? Sigurinë e jashtme të Kosovës e ka KFOR-i, në krye me SHBA-të. Lidhur me këtë, këtu nuk kemi ndonjë problem. Problemi kryesor i Kosovës është siguria e brendshme. Sigurinë e brendshme e ka UNMIK-u mbi supë, por ne si deputetë gjithësesi duhet të ndalemi në këtë pikë pas ndodhive të pasluftës në Kosovë.

Unë për fillim dua të nisem nga Rezoluta 1244 dhe Komiza kushtetuese e Kosovës, të cilat le njohin Kosovën si të pandarë dhe unike. Problemi i parë është problemi i Mitrovicës, i cili rrezikon sigurinë territoriale të Kosovës, sepse disa banda serbe, të quajtura “roje të urës” kanë rrezikuar sigurisht sigurinë në Kosovë. Për ta dëshmuar këtë tregojnë faktet se pas luftës janë një numër dhe pëmbi 32 të vrarë dhe 26 pjesëtarë të Policisë së UNMIK-ut të plagosur. Sipas Këshillit për mbrojtjen dhe të drejtat e lirive, mbështetur në dëshmi në Mitrovicë, Ivanoviqi është përgjegjës për “rojet e urës” e ai është këtu, në mesin tonë, në Parlament. Sot ndoshta nuk është, por e dijmë kush është. Gjithashtu edhe në pjesët tjera të Kosovës kemi vrasje që kanë dëmtuar rënd dhe po e dëmtojnë imazhin e Kosovës para bashkësisë ndërkombëtare. Gjatë tërë luftës, një numër i madh i njerëzve që morën këtë detyrë, që më tepër luftuan, i quajshin “të Ibrahim Rugovës – Lidhjes Demokratike” sesa okupatorin serb. Sepse kjo ishte edhe detyra e tyre. Për këtë ishin të paguar dhe të gjithë ata që i mbrojnë institucionet ishin armiq për ta. Kështu, një gjë të tillë e bënte edhe Serbia, por vetëm ishin disa role të ndara. Kështu, dalngadalë vijmë edhe tek rasti i Qerezit, kur disa deputetë dhe intelektual që kishin votën e popullit të kidnapohen dhe maltretohen si bashkëpunëtorë të armikut. Por, fati i shpëtoi nga më e keqja. Ata që i arrestuan dhe maltretuan janë të pranishëm këtu në

Parlamentin tonë. Por edhe ata tjerët që u maltretuan janë këtu. Prandaj, unë pyes të dy palët – pse ka ndodhur kjo? Është me rëndësi për ne dhe për opinionin, për qytetarët e Kosovës të dijnë. A është e vërtetë se kanë qenë bashkëpunëtorë të armikut, apo është e vërtetë se kanë luftuar një mekanizëm me krejt fuqinë institucionet e Kosovës. Gjeneza e të gjitha këtyre problemeve mendoj se ka këtu zanafillën. Njerëzit, që veten e quajnë “të dalur nga lufta” festojnë në këto raste dhe presin vdekjen me breshëri plumbash në shenjë gëzimi. Andaj, për t’i sqaruar vrasjet enigmatike të pasluftës duhet të fillojmë nga gjeneza e tyre. Ne do të marrim vetëm një shembull, se unë do të nisem nga kjo dhe këtu po flas vetëm nga vrasjet të cilat kanë ndodhur në Drenicë. Kryesisht gjatë luftës merret kryetari i degës së LDK-ës Sejdi Koca. Dhe, ja çka e pyesin, thotë: “patriot je numër një, por të kemi marrë se je përkrahës i institucioneve të Kosovës dhe i disa individëve të Lidhjes Demokratike dhe i shtatë vëllazërve”. Kjo ishte arsyeja që shtatë ditë Sejdi Koca mbahet në arrest, gjatë luftës është fjala. Këtu e këndeje, kemi vrasjen me datën 2.11. Të gjitha vrasjet në Drenicë ishin me motive politike. Këtu ishte edhe qëllimi që t’i frikësojnë njerëzit, metoda të vjetra, metoda tashmë të vjetra, metoda partizane unë i quaj dhe ashtu islam. Më 2.11.99 kidnapohet Haki Ymeri, nga persona të autorizuar si pjesëtarë të ministrisë së rendit, pranë QPK. Pas disa orësh gjendet i vdekur në fshatin Açahevë. Pyes, policia me siguri do të na përcjellin, zotërinjt nga Policia e UNMIK-ut se çka kanë bërë për zbulimin e këtij rasti, shumë të rëndë. Familja e Hakiut akuzon drejtpërdrejt kryesinë e PDK-ës, jo pa adresë. Kemi shkrimet e Ymer Ymerit, vëllaut të tij, i cili ishte burgosur në Shqipëri plotë disa muaj, mandej një numër të madh intelektualësh, si Ismet Veliqi, kryetarit të nëndegës së Çubrelit Xhafer Behrami me të gjithë birin dhe me dy të familjes së tij. Më vonë më 2.8. plagoset Sejdi Koca, kryetar i degës së LDK-ës në Skenderaj në rrethana të pasqaruara. Hajrullah Oruçi, veprimtar i Lidhjes Demokratike. Më 19.10.2001, në një pritë të organizuar mirë vritet gazetari i Bota sot Bekim Kastrati, përkrahës i vijës institucionale të Kosovës, ish ushtar i UÇK-ës. Gjithashtu vritet truproja e Presidentit Besim Dajaku, ish ushtar i dalluar i UÇK-ës dhe plagoset Gani Geci. Çuditërisht në këtë rast KFOR-i, kreu i KFOR-it vlerëson gabimisht, ndërsa Policia e UNMIK-ut demanton deklaratën e KFOR-it. Nga kjo del se komandanti i KFOR-it ka qenë i manipuluar nga dikush që gjendet m’u këtu. Rasti tjetër është Jetullah Behramit, tentim vrasje me datën 21.6.2001 ku plagoset vajza e Jetullahut dhe kërcnimet e njëpasnjëshme tani e tutje.

Duke analizuar situatën e sigurisë në komunën time del se partia tjetër nuk kanë asnjë të plagosur apo të vrarë dhe të kërcnuar nga persona të panjohur. Kjo del se në mënyrë sistematike është ushtruar dhunë ndaj LDK-ës për të marrur pushtetin me dhunë. Pyes Policinë e UNMIK-ut deri kur do të ndodh kjo? Ne jemi duke pritur hetimet, por kemi të drejtën morale që të kërkojmë zbardhjen e këtyre rasteve para se situata të na dalë nga kontrolli.

Deputetë të nderuar. Pavarësinë e Kosovës po e ngulfatin disa kriminelë, jo pa adresë. Po vrasin në mënyrë të organizuar. Ne duhet që vrasësit t’i quajmë vrasës. Vrasjet politike – vrasje politike, krim – krim. Ndërsa vrasjet tjera që kanë ndodhur dhe ndoshta do të ndodhin edhe në të ardhmen në mënyrë të paorganizuar, ato janë të dëmshme por nuk rrezikojnë sigurinë e Kosovës. Pra, vrasjet me autorë nuk cenojnë sigurinë e Kosovës,

ndërsa vrasjet pa autorë cenojnë drejtpërdrejt edhe sigurinë tonë. Prandaj, sipas mendimit tim, konsideroj se çështja e sigurisë për shumë persona në Kosovë është jostabile, sepse e drejta e njeriut për të jetuar për një çast pushon nga një dorë kriminele e llojit të vet, e të cilën organet e sigurisë gjer më tani nuk po arrijnë t'i bien në gjurmë dhe të asgjësojnë këto banda gangsterësh që po i quajmë. Kërkojmë nga hetuesia që t'i zbardhin këto raste sa më shpejt dhe të bëjnë parandalimin e rasteve të mundshme që mund të rjedhin. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit. Bajrush Xhemajli, kurse replikë kanë kërkuar 3 vetë, por njëri mund të replikojë. Doni ta merrni fjalën më vonë. Në rregull, urdhëroni Bajrush.

### **BAJRUSH XHEMAJLI:**

Ju falemnderit. Të nderuar deputetë,  
Unë desha të prek një segment të sigurisë që mendoj se është shumë ndikuese në sigurinë e vendit dhe në situatën politike e që nuk u prek këtu. Mendova se do ta prekë dikush dhe të mos dal sepse s'jam ithtar i asaj vetëm dhe dalë, por meqë nuk u prak desha pak edhe unë të them disa fjalë. Kryesisht këtu u apeluva që të arrestohen kriminelë, të burgosen, të dënohen e tjera, që është shumë e drejtë po pikërisht dua të flas lidhur me këtë çështje: arrestimet, mënyrën e arrestimit dhe fatin e të arrestuarit.

Ne jemi dëshmitarë të asaj se nganjëherë njerëzit edhe në bazë të opinionit publik dhe linçohen dhe në këtë kontekst bëhen në bazë të dëshmimeve nuk kanë bazë dhe bëhen edhe arrestime të shumta. Unë jam ithtar i asaj që të burgoset çdo kriminel, madje të jetë një dorë e fortë që do t'i burgosë ata, por jam për t'u zbatuar procedura e arrestimeve dhe e dënimeve. Dua të them këtë se kemi qenë dëshmitarë të fushatave të arrestimeve dhe pas atyre fushatave njerëzit janë lëshuar dhe liruar si të pafajshëm pas disa ditëve, pas disa muajve, ka ndodhur edhe pas disa vitesh. Janë mbajtur në mënyrë të paligjshme sepse dihet që me vite nuk mbahet në mënyrë ligjore askush sepse ose dënohet ose lirohet. Këtë e ka bërë Përfaqësuesi special shumëherë me një vendim të veçantë, që ai e ka marrë këtë të drejtë apo e ka këtë të drejtë, sidoqoftë, por dua të them se nuk është së pari humane as njerëzore kjo mënyrë e të mbajturit nëpër burgje. Edhe zoti Novicki për këtë ka tërhequr vërejtjen dhe mendoj se ka sqaruar raste të ndryshme të shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut pikërisht në këtë drejtim. Pse lëshohen kaq shumë dhe qindra e qindra njerëz të pafajshëm. Mendoj se lëshohen për shkak se arrestimet apo fushatat e arrestimeve bëhen kryesisht mbi baza të rrejshme. Po të kishte argumente për t'i arrestuar, njerëzit nuk lëshohen ashtu. Mendoj se edhe këtu u fol me mocione, që mendoj se deputetëve nuk u kanë hije në këtë rast, por argumentet duhet të qiten e jo emocionet dhe mbi bazën e këtyre emocioneve po të fillojë një fushatë e arrestimeve sigurisht se do të ndodhë prapë ajo që të arrestohen dhe të lëshohen me qindra njerëz.



Unë kam dalur këtu edhe për një çështje pak humane, mund të them. Sa e sa njerëz merren të pafajshëm, familjet e tyre pësojnë trauma, sidomos fëmijët maltretohen, e tjera. Maltretim është veç po të shkojë ta rrethojë shtëpinë e le të tjerat që kanë ndodhur edhe rrahje, siç kanë qenë në shtyp. Mendoj se trajtimi në burg, zgjatja sa e sa vite në burg dhe të lëshohet prapë njeriu, sikur nuk ka ndodhur asgjë, të denigrohet dinjiteti i tij, morali i tij, integriteti moral i krejt familjes së tij, materialisht e psiqikisht të keqtrajtohen dhe prapë të lëshohet sikur nuk është bërë asgjë, mendoj që është tepër e padrejtë dhe mbi këtë duhet të ndikohet që s'paku këta njerëz që me vite rrijnë në burg të zhdëmtohen dhe vërtetë janë disa raste, po i potencoj 2-3, rasti i Merdarit, rasti i Zeqirit, Besimit apo si ishte ai i Cërnicës, apo Saramatit e tjera, të lirohen ashtu të pafajshëm dhe askush të mos ndiejë asgjë, mendoj se nuk është në rregull dhe për këtë mendoj se për atë që është bërë nuk mund të ketë dëmshpërblim por së paku një satisfaksion që është i pafajshëm do të ishte edhe si pranim i asaj që dëmshpërblehet. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Naim Jerliu dhe diskutuesi i fundit Xhavit Haliti.

### **NAIM JERLIU:**

Zoti kryesues, duke pa se këtu jemi mëse 5 orë këtu dhe duke konsideruar se ka pasur një debat për mua të frytshëm, të kësaj çështjeje që edhe nga diskutimi i sotëm u konsiderua esenciale për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës dhe duke mos dashur t'ju marr kohë dhe duke konsideruar se ka pasur një debat shterrues edhe me rekomandime, unë do ta dorëzhoj me shkrim diskutimin tim.

### **( Në vijim është paraqitur diskutimi me shkrim )**

Sot kur po diskutojmë për gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Kosovë, në fund të muajit të parë të këtij viti në të cilin kemi hyrë me shpresa dhe me bindjen se do të jetë vit i rëndësisë së veçantë për të ardhmen e Kosovës, sepse ky është tashmë viti i katërt në përpjekje që Kosova të konsolidohet e forcohet me institucionet e saj demokratike, nuk ka dyshim se ndër kukshtet qenësore – esenciale që përcaktojnë stabilitetin shoqëror e politik dhe progresin në drejtim të synimeve të saj, është situata e sigurisë.

Tashmë i dëgjuam raportet e përgjegjësive për sigurinë në Kosovë, përgjegjësve ndërkombëtar, që konsiderojnë se kemi bërë progres të kënaqshëm në drejtim të stabilitetit dhe sigurisë. Por duke pasur parasysh se megjithatë vrasje dhe akte të rënda kriminale kanë vazhduar të ndodhin, sigurisht që ka vend për pyetjet se çfarë mund të bëhet më tutje, çfarë mund të bëhet më shumë dhe ndryshe në mënyrë që siguria të përmirësohet dhe të ngritet në nivel më të lartë, në mënyrë që Kosova të mos vazhdojë të tronditet nga vrasje dhe akte dhune që, pa marrë parasysh parametrat dhe indikatorët që



sjellen nga policia për vlerësimin e përgjithshëm të situatës, vazhdojnë të shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë dhe së këndejmi cenojnë stabilitetin dhe sigurinë aq shumë të dëshiruar dhe të nevojshme në Kosovë.

Çështja e sigurisë në Kosovë është çështje fundamentale, e cila padyshim lidhet me të gjitha aspektet e jetës në Kosovë, e cila e kushtëzon dhe përcakton zhvillimin e Kosovës sot dhe nesër.

Fatkeqësisht në Kosovën e pasluftës, kanë ndodhur një varg i vrasjeve të njerëzve të shquar politik, të personaliteteve publike dhe përfaqësuese të cilat sot e kësaj dite nuk janë ndriçuar kurrë.

(Në mesin e këtyre personaliteteve publike janë vlarë veprimtarë të shquar politikë, komandantë e luftëtarë të lirisë, deputetë e udhëheqës të lartë në komuna, intelektualë e publicistë,...)

Vetë organet e ndjekjes e të gjyqësisë pranojnë që vrasjet më të rënda nuk janë sqaruar, pra fajtorët nuk kanë dalë para drejtësisë. Pavarësisht a janë quajtur apo nuk janë quajtur me motive politike deri tash vrasjet e shumta të personaliteteve politike e publike në Kosovë, ato deri tash nuk u ndriçuan, kriminelët nuk u kapën dhe policia nuk dha sqarime për motive të këtyre krimeve. Krimet serioze janë kryer – nuk dihen aktorët dhe nuk katë dyshuar... Kjo ka lënë hapësirë për spekulime dhe akuza. Kjo ka lënë gjithnjë hapësirë për spekulime për gatishmërinë, aftësinë dhe profesionalizmin e organeve policore, ndjekëse dhe hetuese që t'i kapian kriminelët, t'i ndëshkojnë dhe t'i ballafaqojnë me drejtësinë. Kjo ka lënë hapësirë për kërkesën e shpjegimeve se si është e mundur që deri tash autorët kriminelë të këtyre vrasjeve nuk u kapën nga policia ndërkombëtare dhe ajo vendëse që të sillëshin para drejtësisë ku do të mund të zbardheshin edhe motive nxitëse të krimeve të tilla.

Kanë kaluar periudha të gjata me vrasje jtë tilla sistematike për të cilat përveç konstatimeve të policisë se "këto akte janë të organizuara shumë mirë dhe prandaj janë të vështira për t'u zbuluar nuk është dhënë asnjëherë ndonjë hollësi tjetër, që të dihet se cilat ishin me të vërtetë motivet e këtyre vrasjeve.

Prandaj, duke mos pasur sukses të dëshirueshëm në kapjen e kriminelëve policia dhe organet e saj të ndjekjes dhe të hetuesisë, kanë krijuar hapësirë të pashpjegueshme që vetë qytetarët – populli, kur i vriten udhëheqësit dhe të zgjedhurit e tij, t'i emërojë këto vrasje ashtu siç i ndjen dhe i përjeton...

Prandja, unë mendoj, është krijuar edhe një hapësirë e pashpjegueshme e mosbesimit të qytetarëve në aftësitë profesionale të policisë (në kët rast, sidomos të asaj ndërkombëtare) dhe të organeve të saj hetuese dhe ndjekëse... Ç'po ngjet me aftësinë e policisë ndërkombëtare e cila lmbikëqyrë dhe policinë vendëse?

Prandaj, s'është e çuditshme që të gjithë ata që vranë deri tash personalitete të rëndësishme, të cilët s'u kapën kurrë të ndihen sot mbi ligj dhe mbi institucione vendëse e ndërkombëtare...

Prandaj, ende ka vend për pyetjen: deri kur të pritët fjala shpjeguese e policisë e jo vetëm të deklarohet "hetimet vazhdojnë" (edhe pas tre vjetësh). Kur do të mund të pritët realizimi i asaj formulës kuptimplotë "zero tolerancë ndaj krimit të organizuar"...

Prandaj, rritja e efektivitetit të ndriçimit të rasteve, do të ishte kontributi i konsiderueshëm në luftën kundër krimeve të mëtejme, në krimin e ambientit në të cilin qytetari i Kosovës sot nuk guxon të ndihet më i pasigurt se dje...

Edhe në këtë ndriçim, përgjegjësinë numër një e kanë organet qeverisëse ndërkombëtare në Kosovë që i kanë marrë kompetencat në këtë fushë.

Por është e padiskutueshme se edhe ne që jemi sot këtu i kemi përgjegjësitë duke qenë përfaqësues të qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, në këtë kontekst mendoj se duhet të jemi të vendosur që të veprojmë që të mos rëshqasim në një shoqëri të krimit.

Duke parë çështjen e sigurisë si çështje ekzistenciale e politike të Kosovës sot, ne sot dëgjuam këtu përgjegjësit për siguri e drejtësi në Kosovë, biseduam e po bisedojmë për fenomenin-gjendjen e sigurisë për të nxjerrë rekomandimet për veprimet konkrete.

Ne të gjithë e kemi përgjegjësinë që të angazhohemi fuqishëm e të veprojmë të vendosur që duke mos u cenuar siguria dhe qenia fizike e qytetarit të Kosovës, që duke mos u

cenuar siguria dhe duke mos u vrarë figurat publike e politike, të mos cenohet dhe vritet e ardhmja dhe perspektiva e vendit tonë.

Prandaj, duke iu qasur edhe një herë asaj që është thënë qysh në kërkesën që në emër të grupit parlamentar të LDK e kak bërë kryetgari i grupit, profesor Hamiti, dua jte ritheksoj se në suaza të veprimeve të vendosura të faktorit ndërkombëtar dhe vendës duhet zhvilluar një fushatë të gjerë dhe të vendosur për t'i gjykuar këto krime:

1. Që në institucionet përfaqësuese të qytetarëve të Kosovës të ngriten në nivel që duke kërkuar besimin e tyre, që dhuna e krimi të ndalen e të izoloohen, të përdorim gjithë fuqinë e vet të veprimit;
2. Kërkohet nga partitë, si organizime të mëdha politike, që ta ushtrojnë tolerancën, të kuptojnë konkurrencën si procedurë demokratike të shfaqjes së kualitetit, të kuptojmë që qeverisja fitohet vetëm me votë, që grindja nuk është metodë e marrëveshjes, por dialogu dhe të bëhen të vetëdijshme për përgjegjësitë që kanë për të krijuar qëndrimin e përbashkët kundër dhunës e krimit, veçanërisht kundër dhunës politike;

3. Thërrasim intelektualët, dijetarët e të tjerët, të mundin frikën dhe me autoritetin e tyre të flasin e të punojnë kundër dhunës. Ndoshta këtu më të fortit e më të zëshmsit mund të jenë të rinjtë;
4. Presim nga mediat e shkruara e elektronike, të cilat lushtrojnë ndikim duke marrë opinione e duke krijuar opinione, që të kërkojnë të vërtetën e të maten me të vërtetën. Ky kërkim i të vërtetës gjithnjë bëhet me ligjën universale të komunikimit: mendimi dhe fjala janë të lira, por rrena dhe shpifja publike janë të dënjeshme. Presim, pra, nga mediat të lirohen nga gjuha e egër e agresive, të pushojnë nga propaganda e trashë, më në fund të pushojnë së prodhuari "atdhetarë" e "tradhtarë". Sepse, fuqia e këtyre mediave rritet duke krijuar vlerat dhe jo duke i përbaltur vlerat;
5. I thërrasim qytetarët të denoncojnë dhunën e krimin në secilin hap, se vetëm kështu do të fitojnë edhe lirinë personale. (Pason nënshkrimi)

### KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Shumë falemnderit Naim. Xhavit Haliti dhe nuk ka diskutues më.

### XHAVIT HALITI:

Të nderuar kolegë,  
 Realisht jam përmbajtur që të mos diskutoj dhe të pres jo për fund, me menduar dikush se po don me ia lënë dikujt ngile ose me trajtuar ndonjë problem ku ta dij se çfarë. Mendoj se jam në këtë Parlament njeriu më i përfolur në Kosovë si organizator i krimit të organizuar, si njëri ndër vrasësit më të mëdhenj, se bënë atë pyetjen rastësisht përfaqësuesve ndërkombëtar këtu, si njëri nga ata që furnizoj me armë IRA-n, që kam luftuar në anën e IRA-s, që jam në krye të kontrabandave të llojeve të ndryshme në Kosovë. Dhe, mendoj që para jush është mirë ta them dhe para qytetarëve të Kosovës që asnjëra e as tjetra nga këto nuk është dhe nuk qëndrojnë dhe duke ju thirr edhe juve dhe duke kërkuar edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë këtu që mos t'i quajnë të paligjshme, do të kërkoja, një komision hetimor dhe prej policive dhe organeve të ndjekjes kam kërkuar dhe nga ky Parlament që të hetojë sinqerisht aktivitetin tim ekonomik, politik, kriminal dhe cilindoqoftë atë dhe në krye të këtij komisioni të jetë vetë Fadil Geci ose kushdoni ju këtu të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe subjektet tjera të jenë vetëm vëzhgues në këtë rast. Sepse, duke qenë anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës mendoj se akuza është shumë e rëndë dhe nuk i takon kjo. Ne kemi kaluar një luftë dhe luftë nuk kemi bërë për qef. Dikush ka qenë i inkukadruar më shumë, dikush më pak, dikush hiq. Dikush ka qëndruar këtu, dikush s'ka qëndru. Nuk kemi kohë të merremi me analiza të njëri-tjetrit kush ka qitë pushkë më shumë për Kosovën dhe kush më pak, kush ka qenë më pak i mençur ose më shumë i mençur. Mendoj se kemi marrë përgjegjësitë tona si deputetë dhe mendoj dhe jam i bindur dhe secili që është këtu do të duhej të orientohet në

drejtim të qetësisimit të situatës dhe realisht t'i bëjë thirrje pikërisht ashtu siç e thanë edhe ndërkombëtarët qytetarëve të Kosovës që të denoncojnë krimin qoftë ai që s'kam qef të jetë ashtu që po akuzojmë drejtpërdrejt si parti po them politik dhe publikisht nga njerëzit me përgjegjësiu të lartë dhe mua më vjen keq që këtu kam shumë njerëz, anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që vërtetë kam respekt shumë të madh, kam pasur gjatë gjithë jetës për ta sepse kam qenë edhe nxënës i tyre, kam qenë edhe student i tyre dhe realisht kur kemi vepruar edhe ilegalisht kemi emra të përveqshëm këtu në këtë sallë që i kemi respektue dhe pse s'kemi pasur ndonjëherë rast me folë me ta.

Prandaj, duke i quajtur kriminelë kryesinë e Partisë Demokratike të Kosovës, mendoj se në këtë rast bëhet një sulm flagrant, i hapët, në Parlamentin e Kosovës dhe mendoj se ky parlament do të duhej në një formë ose tjetër të distancohej ose tani të fillojmë procedurën parlamentare për ndjekjen e anëtarëve ose të kreut të PDK-ës që qenkan në këtë Parlament dhe t'ua marrim imunitetin si deputetë. Mendoj se kjo është rruga e vetme jona. Me përgjegjësinë e njërit nga organizatorët dhe themeluesit e UÇK-ës e them me gojëplotë – kurrë Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka pasë orientim me bë vrasje të shqiptarëve; kurrë nuk ka pasur ndonjë orientim të bëjë vrasje të civilëve serbë; kurrë nuk ka pasur orientim të bëjë diferencim as distancim politik në hapësirën kombëtare dhe të Kosovës në përgjithësi. Mbase mund të jenë bërë gabime të natyrave të ndryshme, lëshime të natyrave të ndryshme. Koha është e jona dhe mendoj se së bashku mund të ecim përpara. Në qoftë se fillojmë të akuzohemi me njëri-tjetrin, unë them se nuk jemi të denjë të përfaqësojmë Kosovën. Ju lutem që në përgjithësi deputetët e Kuvendit të Kosovës do të duhej të distancohen nga akuzat tepër të rënda tani në Parlamentin e Kosovës, përveç atyre që u dëgjuan në rrugë dhe në gazeta. Ju falemnderit.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju kisha lutur. Një moment, Fadil. Prit do ta japi fjalën unë. Ta jap radhën unë. Të nderuar deputetë, ka për replikë, janë lajmëruar disa vetë, jo për diskutime. Janë kryer diskutimet. Fatmir Limaj është lajmëruar për replikë dhe Fadil Geci. Kam një kërkesë për ju deputetë dhe ju kisha lutur që të mos dalim për të replikuar. Diskutimet kanë qenë të mira, pavarësisht nga ndonjë që ka zgjuar emocione. Miratimi i një dokumenti që paraqet qëndrimet e këtij Parlamenti për këtë temë është përgjigja më e mirë edhe ndaj atyre diskutimeve emocionale. Unë ju lus të mos dilni të replikoni, por nëse ju doni, është e drejtë e juaj, njëherë Fatmir Limaj – 3 minuta është replika, pastaj është Fadil Geci. Unë prapë ju kisha lutur edhe njëherë që më mirë është të mos replikoni, dokumentin do ta miratojmë sot, në atë dokument paraqesim qëndrimet e Kuvendit dhe përfundojmë punën me kaq.



### **FATMIR LIMAJ:**

Zoti kryesues, unë nuk dua të replikoj se s'kam më kë me replikue dhe s'kam për çka me replikuar. Është e barabartë sikur të replikojsh me botën sot, por kërkoj seriozisht nga shefi i Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe shefi i Grupit të Aleancës për Adhmërinë e Kosovës të distancohet nga ai diskutim. Ne këtu publikisht e marrim si kërcnim ndaj Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës dhe çdo gjë çkado që ndodhë adresë është e qartë. Kërkoj distancim nga fjala e parafolësit më herët. Në qoftë se dyshefat e grupeve parlamentare nuk distancohen nga kjo atëherë praktikisht ky Parlament del dhe bëhet në funksion të rrugaçëve të rrugës nëpër qytetet e Kosovës. Është kërcnim i drejtpërdrejt. Ne marrim këtë si kërcnim të drejtpërdrejtë ndaj udhëheqjes së Partisë Demokratike të Kosovës dhe atëherë duhet të dalim nëpër organet hetimore. Kurgjë tjetër s'dua.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit. Fadil Geci le të urdhërojë.

### **FADIL GECI:**

Unë desha vetëm t'i përgjigjem Xhavit Halitit. Nuk do të merrem shumë me të, sepse është një person që është në listën e Bushit dhe ai e din sa është i vlefshëm për shqiptari e të Evropës dhe i din punët tua – Xhavit Haliti, po edhe zotërinjt tjerë i dinë punët e veta, e dinë ku janë dhe nuk kanë ku me u marrë, me shkue më andej. Kemi argumente me folë sa të doni. Jam i gatshëm. Atë që e thoni - jam pasardhës i luftës, keni harrue se Ushtria Çlirimtare u dalë në Llaushë. Ajo ka pasë zotshtëpie, ka pasë kryetar, ka pasë njerëz. Ju jeni të Zvicres atje që jeni lajmërue që jemë, dhe pas të gjitha mundeni me qëndrue pas të këqiave e jo pas atyre që janë vlera të luftës.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. E përfundojmë debatin. Më falni, urdhëroni.

### **SABRI HAMITI:**

Nën një, unë konsideroj si kërkesë iniciale interesante këtë qysh më drejtohet kolegu im Limaj, por menjëherë i them – as sot, e as kurrë nuk distancohem nga asnjë mendim që thuhet në Parlament. Ky është Parlament. Njeriu që flet fjalën e ka autorsinë e vet. Unë nuk jam shef politik i tij që të merrem me fjalën e tij. Ai ka argumentet, le të qiten kundërgargumentet. Pra, nuk konsideroj se duhet të distancohemi, pa marrë parasysh a ka

argumente a s'ka, ai le të gjendet dhe le t'i gjejë vetë argumentet. Domethënë kjo në princip dhe nuk do të kërkoja kurrë as nga kolegu im Limaj që ky të distancohet nga një deputet që e përfaqëson këtu partinë e tij dhe të distancohet nga ajo, sepse nuk më duket hiq parlamentare. Këtu jemi në vend ku diskutohet me argumente dhe mosargumente e tjera. Ndërsa, sa i përket adresimit. Gabim e ka, zotri Xhavit Haliti - diskutimin e një njeriu që ia adreson partisë. Këtu veç menjëherë mund të flas që s'ka të bëjë me qëndrimet e një grupi parlamentar. Replikat që ndodhin në mes dy vetëve, sot me ty, nesër me mua e me atë tjetrin dhe unë nuk do t'i marrë kurrë ashtu edhe nëse ma bën një replikë dikush i një partie tjetër. Gabim është nëse i gjeneralizojmë... Dhe unë dola këtu të them: Një, që s' do të distancohem prej mendimeve autoriale që jan në Kuvend, dhe Dy, ju lutem shumë mos i adresoni tërësisë partisë mendimet që shfaqen këtu. Nuk kam kurgjë tjetër me thënë, ju falemnderit.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të falemnderit zoti Sabri. Bujar a dëshironi ta merrni fjalën? Urdhëroni.

#### **BUJAR DUGOLLI:**

Unë si duket kam pasur drejtë me i kërkuë kryetarit Daci që tek e fundit të mos vazhdojë kjo seancë pasi shkuan ndërkombëtarët por sido që të jetë mendojs e diskutimet që ishin në fund nuk i kontribuojnë aspak situatës së përgjithshme në Kosovë dhe duhet të dijmë t'i dallojmë dhe ta kemi atë kulturën elementare politike si deputetë dhe tekefundit janë organet të cilat i hulumtojnë këto dhe të mos bëjmë akuza se nuk na ndihmo të dalim nga kjo situatë. Normalisht ato diskutimet siç kenë në fund duke etiketuar njerëz e sende jan të papranueshme për ne, por mendojmë se duke ruajt klimën politike që kemi si grupe, si shefa të grupeve, ne mund të kontribuojmë me të mirën e vendit, të mirën e Kosovës dhe Parlamenti, as foltorja, të mos shfrytëzohet për etiketime të individëve të ndryshëm pa marrë parasysh nga cilat parti vijnë. Ne nuk pranojmë format e diskutimeve të tilla, dhe kërkojmë që çdoherë si deputetë të jenë konform, të jenë të harmonizuar me grupet e tyre parlamentare dhe me shefat e tyre parlamentarë. Mendoj se kemi bazë për të vazhduar bashkëpunimin si shefa të grupeve, si grupe parlamentare dhe t'i anashkalojmë ato probleme që dikush ndoshta don t'i kthejë nga e kaluara në ditë të sotme. Ju falemnderit.

#### **REMZIJE NIMANI: (diskutim i paraqitur me shkrim)**

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,  
Kur sot në këtë seancë po shqyrtojmë çështjen e sigurisë në Kosovë, dua të shpreh opinionin dhe mendimin tim se përkundër deklarimeve se në Kosovë mbretëron situatë stabile e sigurisë, nuk mund të pajtohem me këtë, për vetë faktin se në Kosovë kemi njëpasiguri të të gjitha formave dhe veprimeve destruktive dhe destabilizuese.

Vlersësoj se nuk është e mjaftueshme dhe frytdhënëse, që vetëm ta përshkruajmë pasigurinë, por me vlerë do t ishte se si të sigurojmë dhe të garantojmë sigurinë për të gjithë qytetarët pa dallim kombi, feje, race dhe gjinie.

Për çfarë sigurie dhe stabiliteti mund të flitet në Kosovë, kur një pjesë e territorit të saj është jashtë kontrollit dhe mbikëqyrjes së organeve legjitime të Kosovës. Kur ne sot debatojmë këtu në Kuvend për çështjen e sigurisë, në pjesën veriore të Mitrovicës para organeve legjitime dhe faktorit ndërkombëtar, që është përgjegjës për çështjen e sigurisë dhe mbrojtjen e tërësisë territoriale të Kosovës, sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB, na formohet "bashkëisa e komunave serbe të Kosovës".

Për çfarë sigurie mund të flitet në Kosovë, kur janë krijuar enklava serbe në të cilat punohet e veprohet me këmbëngulje për bllokim dhe sabotim të çdo iniciative dhe procesi pozitiv të ndërmarrë nga organet legjitime të Kosovës dhe nga faktori ndërkombëtar.

Duhet theksuar se me të madhe punohet nga qarqet e caktuara për destabilizimin e Kosovës. Pasiguria më e madhe refletkohet në regjionin e Mitrovicës. Të gjitha strukturat në nivelin komunal të Mitrovicës janë të angazhuar maksimalisht që të zgjidhet problemi i Mitrovicës, i cili e rëndon me të madhe situatën e sigurisë në tërë Kosovën. Për sigurinë në Mitrovicë do të prezentoj disa fakte dhe të dhëna shqetësuese që e argumentojnë këtë.

1. Pas lufte, që nga hyrja e forcave paqëruajtëse në Mitrovicën me rrethinë janë vrarë mëse 33 qytetarë, me emër e mbiemër vendbanim dhe datëlindje dhe këtu e kam listën e të dhënave dhe po-qe-se është nevoja do t'ua prezentoj. Këto të dhëna janë marrë nga KLDNJ.

Për këto vrasje qëllimisht, procedura e hetimeve nuk ka përfunduar e dihet se krkyerësit dhe ekzekutuesit e veprave kriminele kanë qenë paramilitarët dhe kriminelët serbë.

Nga këta të vrarë vetëm me datën 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000 në lagjen Ibri nga rebelimi i paramilitarëve serbë janë ekzekutuar 11 persona, prej tyre 5 gra dhe një fëmijë 13 vjeçar.

2. Po ashtu me këtë datë (3-4.02.2000) janë plagosur 10 shqiptarë, për të cilët akoma edhe sot e kësaj dite nuk jipen informata të duhura për kryerësit e veprave penale.
3. Janë po ashtu evidente dhe të pamohueshme edhe sulmet që janë bërë kundër forcave ndërkombëtare në Mitrovicë dhe për akte e veprime të tilla nuk janë ndërmarrë masa adekuate.

Kjo pasiguri në pjesën veriore të qytetit vazhdon edhe më tutje. Ishtge shumë shpresëdhënës për qytetarët e kësaj pjese fakti se pat fillukar patrullimi i pjesëtarëve të SHPK, mirëpo ishte shumë dëshprues fakti se dikush urdhëroi pa kaurrfarë arsye dhe motivi që këto forca të tërhiqen nga ajo pjesë. Qytetarët e Mitrovicës, pyesin pse ndodhi

kjo? Popullata është shumë e indinjuar me këtë veprim. Mjetet e finromimit raportuan se kjo u bë me kërkesë të N. Çoviqit, konform të një marrëveshjeje paraprake të nënshkruar

nga organet e UNMIK-ut dhe të Beogradit, gjë që kjo u demantua më vonë nga Sajmon Hazellok. Nuk mund të tolerohet që një pjesë e vogël e banorëve shqiptarë, sa kanë mbetur, të terrorizohen nga bandat dhe grupet terroriste serbe.

Për çfarë sigurie mund të flitet, kur popullata e kësaj pjese të qytetit, për të kaluar në pjesën jugore duhet të bëjnë këtë rrugtim, vetëm nën përcjelljen e forcave të KFOR-it dhe të Policisë së UNMIK-ut, ndërsa për t'u kthyer me të njëjtën përcjellje, duhet të presin deri në mbrëmje. Ju falemnderit për mirëkuptim. **(Pason nënshkrimi).**

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Atëherë ju falënderoj dhe më lejoni ta rrumbullakësoj këtë pikë të rendit të ditës. Mendoj se duke pasur parasysh disa fakte, faktin që ne nuk jemi përgjegjës, do të thotë nuk kemi kompetenca, institucionet e pushtetit në Kosovë nuk kanë kompetenca dhe as informacione për gjendjen e sigurisë. Duke pasur parasysh se referimet që i bënë edhe zoti Caddy edhe zoti Feller i kanë përngja bukur shumë një konference shtypi, kanë dhënë numra informacioni që mund t'i gjeni në internet e në kompjutera dhe nuk ka pasë ndonjë analizë serioze për çështjen e sigurisë. Duke pasur parasysh që kjo seancë nuk ka mund të përgatitet shumë mirë për shkak të mungesës së këtyre informacioneve, unë jam i bindur se ne do të jemi të kënaqur nga debati që është bërë këtu, pavarësisht, them, nga ndonjë diskutim, përkrahu fuqimisht zotin Hamiti se këtu janë të gjithë deputetë dhe secili diskutim është autor i fjalës së vet. Unë tash do t'ju them dy çështje. Ne do të bëjmë tani një pauzë për tri arsye, një jemi lodhur, e dyta – shefat e grupeve parlamentare janë marrë vesh me kryetarin që të bëjnë një dokument, unë nuk di saktësisht si do të titullojnë atë dokument, që do të paraqesë qëndrimet e Kuendit në çështjen që u diskutua.

Në rend të ditës kemi tani Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financat publike.

Sot jam i njoftuar, kanë ardhur edhe disa amendamente nga Qeveria. Prandaj, duhet ta bëjmë një pauzë gjysmëorëshe. Shefat e grupeve parlamentare të ulen ta bëjnë dokumentin, ndërsa komisionet që janë obligative për t'i shqyrtuar amendamentet të mbliidhen menjëherë në sallën 301C dhe pas gjysmë ore, ndoshta pak më tepër, në ora 4 të jemi këtu në sallë. Ju falemnderit.

**(Vijon pauza)**

**(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)**



### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Të shikohet a kemi kuorum. Po ju informoj se tani jemi në pikën e dytë të rendit të ditës. Do ta bëjmë **Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.**

Më lejoni t'ju them se konform rregullave të punës në Kuvendin e Kosovës, për shqyrtimin e dytë janë propozuar amendamente në Projektligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nga komisionet parlamentare: Komisioni për ekonomi e financa, Komisioni për buxhet, nga deputeti zoti Gani Koci dhe nga Qeveria. Të gjitha projektligjet kanë shkuar me procedurë të rregullt edhe konform rregullave të punës dhe janë shqyrtuar konform rregullave të punës, gjë që mund të konstatojmë se mund të hyjmë tash në shqyrtimin e amendamenteve. Fillimisht kërkoj nga kryetarët e komisioneve që janë përgjegjëse për këtë Projektligj që të raportojnë, nëse duan edhe gojarisht për amendamentet e tyre. U njoftova se në emër të tre kryetarëve të komisioneve do të raportojë zoti Haki Shatri. Urdhëroni zoti Haki.

### **HAKI SHATRI:**

Kryesi e nderuar, të nderuar kolegë deputetë,  
U ngarkova nga tri komisionet që të paraqes raportin për punën që bëmë në mbledhjen e fundit, në shqyrtimin e amendamenteve të Qeverisë në Projektligjin që po e diskutojmë dhe njëkohësisht po shfrytëzoj rastin që të them mendimin tim lidhur me këtë Projektligj i cili nuk është shumë i gjatë dhe nuk na merr shumë kohë.

Para nesh për diskutim dhe miratim është një ndër dokumentet më të rëndësishme me të cilin rregullohen procedurat në sferën e financimit, buxhetit, pra Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Duke pasur parasysh se materia e këtij dokumenti është komplekse dhe delikate, në njërën anë, dhe rrethanat specifike të jetës institucionale në Kosovë, në anën tjetër, këtu kam parasysh faktin e ekzistimit të dy institucioneve ligjdhënëse paralelisht në të njëjtën kohë në Kosovë, pra Kuvendi dhe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. E tërë procedura e aprovimit të këtij Ligji ka qenë shumë delikate dhe e ndieshme. Faza e shqyrtimit të këtij projektligji pas aprovimit në parim ka qenë një periudhë pune intensive dhe shumë serioze të dy komisioneve, të Komisionit për financa dhe ekonomi dhe të Komisionit për buxhet, të cilët një pjesë të madhe të punës e kanë bërë së bashku.

Amendamentet e prezentuara para jush, janë amendamente të përbashkëta e po ashtu edhe vlerësimi për amendamentet e propozuara nga zoti Gani Koci, janë vlerësime të përbashkëta të dy komisioneve. Në materialin që janë të renditura amendamentet i keni përgjigjet e dy komisioneve në çdo amendament të propozuar.

Në kushte normale, ky Projektligj do të dukej shumë më ndryshe. Në këtë Projektligj do të ishte dashur të përfshihej, përveç tjerash, edhe materia që rregullon fushëveprimtarinë e administratës tatimore dhe të doganave. Meqenëse deri më tani kompetencat në fushën e buxhetit dhe të financave nuk janë transferuar në tërësi dhe duke u bazuar edhe në dispozitat e Kornizës kushtetuese, këto dy njësi aktualisht nuk përfshihen dhe nuk janë në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave. Kjo e kufizon dukshëm mundësinë për veprim të institucionet e përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë, pra edhe të Ministrisë së Ekonomisë e të Financave.

I hartuar për këto rrethana, ky Projektligj vlerësoj se është i pranueshëm dhe me inkorporimin e amendamenteve të propozuara do të jetë një dokument bazë i shkëlqyeshëm për realizimin me sukses të punës dhe detyrave të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe obliguesve që kanë organizatat buxhetore.

Tash kam për obligim që t'u them diçka lidhur me amendamentet e Qeverisë të cilat i kemi marrë sot gjatë seancës plenare. Iniciativa për hartimin e këtyre amendamenteve nuk ka dalë nga vullneti i Qeverisë që të na bjen amendamente në momentin e fundit. Por, në mbledhjen e fundit të Këshillit Ekonomik Fiskal, është debatuar rreth mosnënshkrimit të ligjeve të miratuara në Kuvend dhe zhagjitjes për 7 muaj të këtij Projektligji në procedurë deri sa ka ardhur në Qeveri dhe në Kuvend dhe duke u nisur nga një disponim pozitiv për të harmonizuar dhe për të mos penguar në procedura, në Këshillin Ekonomik Fiskal është marrë qëndrim që këshilltari juridik i Përfaqësuesit Special për një kohë shumë të shkurtër deri në mbledhjen e parë të Qeverisë të bëjë komentet e veta në këtë Projektligj dhe ato komente Qeveria t'i shqyrtojë dhe eventualisht për ato që pajtohet t'ia orientojë dhe dërgojë Kuvendit në formë të amendamenteve sepse ajo është forma e vetme e mundshme që mund të shqyrtohen dhe miratohen në Kuvend. Këto amendamente që sot i kemi marrë janë një pjesë e komenteve të këshilltarit juridik të Përfaqësuesit Special, të cilat i ka marrë Qeveria dhe i ka pranuar. Pjesën tjetër i ka shqyrtuar por nuk janë pranuar nga Qeveria sepse kryesisht nuk kanë qenë në pajtim me qëndrimet të cilat ky Kuvend i ka marrë në mbledhjen e fundit të dhjetorit lidhur me nxjerrjen e Ligjit për përvetësimet buxhetore për vitin 2003. Ju kujtohen qëndrimet që i kemi pasur në 5 pika. Arsyeja e vetme pse janë refuzuar janë sepse ato propozime nuk kanë qenë në pajtim me qëndrimet e Kuvendit të datës së lartpërmendur dhe këto konsistojnë kryesisht në ndarjen e buxhetit në dy dokumente, gjegjësisht në heqjen e organizatave buxhetore nga ligji dhe nga ligji për përvetësimet buxhetore, të organizatave buxhetore që janë në kompetencë të rezervuar. Kjo për Qeverinë ka qenë e papranueshme dhe Qeveria nuk i ka dërguar më tutje te Kuvendi si amendamente. Këtë që i kemi harmonizuar amendamentet nga Qeveria të tri komisionet i kanë diskutuar dhe kanë përkrahë, domethënë për komisionet janë të pranueshme dhe mund të hyjnë në procedurë të mëtejshme në këtë mbledhje plenare. Ju bëj me dije se edhe amendamentet e aprovuara nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për ekonomi e financa janë përkrahur nga Komisioni për interesat e minoriteteve, në mbledhjen që patëm së bashku. Prandaj është çështje e deputetëve në procedurën e mëtejshme. Ju falemnderit.

## **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit zoti Shatri. Më lejoni t'ju njoftoj se në Seancë janë të pranishëm 65 deputetë, do të thotë kemi kuorum dhe kërkoj falje që s'ju thash në fillim. Ne kaluam në pikën e dytë sepse dokumenti që janë duke e përgatitur kryetarët e grupeve parlamentare ende nuk është gati dhe ne po i presim dhe po punojmë me pikën e dytë e kur të vijmë ata vazhdojmë.

Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale në bazë të rekomandimeve të Komisionit funksional dhe Komisionit për buxhet ka përgatitur listën e radhitjes së amendamenteve të propozuara. Ju e keni përpara listën, ju lutem hapne sepse tash do të hyjmë në miratimin një nga një të amendamenteve.

**Amendamenti 1.** Komisioni për buxhet dhe Komisioni për Financa dhe Ekonomi.

Ju ftoj që të votoni.

Kush është për këtë amendament? Shumica.

Kush është kundër? Askush.

Kush abstenon? Askush.

**Amendamenti 2.** Deputeti Gani Koci, pa përkrahje nga Komisioni për buxhet Komisioni për financa dhe ekonomi

Kush është për? 24.

Kush është kundër? 25.

Kush abstenon? Dy abstenime.

Pranda, nuk miratohet amendamenti.

**Amendamenti 3.** Deputeti Gani Koci, i përkrahur nga Komisioni për buxhet Dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për amendamentin? Shumica dërmuese. Ju falemnderit.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti 3.

**Amendamenti 4.** Deputeti Gani Koci, i përkrahur nga Komisioni për buxhet Dhe Komisioni për financa dhe ekonomi

Kush është për amendamentin? Shumica.

Kush është kundër? Askush.  
A abstenon ndokush? Askush.  
Miratohet amendamenti 4.

**Amendamenti 5.** Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe  
Ekonomi.

Kush është për amendamentin? Shumica.

Urdhëroni, keni të drejtë të paraqiteni për diskutim.

### **HYDAJET HYSENI:**

Tërheq vërejtjen që nganjëherë amendamentet po aprovohen pa i lexuar dhe pa i krahasuar çka po aprovohet. Në rreshtin e dytë të amendamentit të propozuar thuhet: “shkeljeve penale apo civile që përfshin përgënjeshttrimin”, kurse në tekstin anglisht është do të thotë “gënjeshtër”. Përgënjeshtrimi është e kundërta e gënjeshtres dhe praktikisht në këtu sanksionohet të kundërtën e asaj që në fakt po duam ta sanksionojmë.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Për cilin amendament e keni fjalën, ju lutem? Ky është amendamenti 5.

### **HYDAJET HYSENI:**

Për amendamentin 8, apo jo. Atëherë më falni. Gabim e paskna paraqitur.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Unë kërkoj falje që lejova pasi u votua. Ka të drejtë sipas rregullores kush e propozon amendamentin ose e kundërshton por para se të votohet. Vazhdojmë aty ku mbetëm.

Kush është kundër amendamentit 5? Asnjë.  
Kush abstenon nga votimi? Askush.  
Kalon amendamenti 5.

**Amendamenti 6.** Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe  
Ekonomi.

Kush është për amendamentin? Falemnderit.



Kush është kundër? Askush.  
A abstenon ndokush? Askush.  
Miratohet amendamenti 6.

**Amendamenti 7.** Deputeti Gani Koci, pa përkrahje nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për amendamentin? 22.  
Kush është kundër? 25.  
A abstenon kush? Dy abstenime.  
Nuk miratohet amendamenti 7.

**Amendamenti 8.** Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe Ekonomi.

Kush është për amendamentin?

Kush dëshiron të marrë fjalën? Hydajet për këtë amendament e kishe parës fjalën? Domethënë për fjalën “përgënjeshttrim” të zëvendësohet me “gënjeshtër”. Urdhëroni Nekibe.

#### **NEKIBE KELMENDI:**

Mendoj se ky amendament duhet të riformulohet jo në pikëpamje përmbajtësore por në pikëpamje të radhitjes së fjalëve dhe të mospërsëritjes së fjalëve. “Keqpërdorim” dhe “keqpërvetësim” nuk di çka është. Nëse keqpërdoren - keqpërdoren për qëllim të përvetësimit fondet. Njëra apo tjetra, nën një. Nën dy, “vendosur nga gjykata me juridiksion kompetent të ketë bërë vepër penale”, jo “me shkelje penale” se s’ka shkelje penale. Ka vepër ose s’ka vepër penale,”apo civile”. Vepër civile nuk ka. S’e di çka ka dashur me thënë këtu këto dy komisione prandaj ishte dashur një përmirësim të bëhet i këtij amendamenti. Ose përkthimi është i dobët por diçka nuk është në rregull.

#### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Falemnderit zonja Nekibe. Komisioni a ndien nevojën me thënë për këto sygjerrime apo mbeten çështje teknike? Në rregull. Urdhëro.

#### **HAJREDIN KUQI:**

Unë mendova se kolegja do t’i japë dhe kjo i dha me plotë të drejtë. Nuk është përmbajtja, është aspekti juridik. Traktat dhe konventë është e njëjtë edhe është pahijshëm me dalë prej Kuvendit “Traktati dhe konventa”. Tjetër, te “mitosja dhe

ryshfeti" dallojnë. Nuk mund i njëjti person me qenë në pozitë të mitosjes dhe të ryshfetit. Mendoj se juridikisht ka nevojë për një formulim pak më ndryshe. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Në rregull. Atëherë, nuk tërheqim amendamentin por e vëjmë në votim, duke pasur parasysh këto çështjet gjuhësore dhe të shprehurit të përmirësohen.

Kush është për, me këto plotësime? Falemnderit.

Kush është kundër? Asnjë.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti 8 me korrigjimet teknike dhe gjuhësore.

### **Amendamenti 9.**

Janë dy formulime të ndryshme. Formulimi i parë është i Komisionit për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi, kurse formulimi i dytë është i deputetit Gani Koci.

I vë në votim një nga një që të dy formulimet:

Kush është për formulimin e Komisionit për buxhet dhe Komisionit për financa dhe ekonomi? Për janë 47 deputetë.

Kush është kundër? Kundër janë 9.

Formulimin e dytë nuk hedhim fare në votim sepse shumica janë që në start për.

Miratohet amendamenti 9.

### **Amendamenti 10.**

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe Ekonomi

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Asnjë.

A abstenon kush? Asnjë.

Miratohet amendamenti 10.

### **Amendamenti 11.**

Deputeti Gani Koci, i përkrahur nga Komisioni për buxhet Dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Urdhëroni, doni ta sqaroni.

### **FATMIR REXHEPI:**

Komisioni për ekonomi e financa dhe Komisioni për buxhet, në takimin që patëm pak më herët, tërheq përkrahjen që ka dhënë propozimit të mëhershëm dhe mbështet propozimin

e ri që ka ardhur nga Zyra e kryeministrit lidhur me amendamentin 11 gjegjësisht nenin 17.3. Prandaj dy komisionet japin përkrahje amendamentit të ofruar nga Qeveria e Kosovës. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Në rregull. Do të thotë Komisioni për ekonomi e financa dhe Komisioni për buxhet e përkrahin tash amendamentin e Qeverisë, që janë dy amendamente. I pari është amendamenti i deputetit Gani Koci.

Kush është për amendamentin e Gani Kocit? Falemnderit. 8 për.

Kush është për amendamentin e Qeverisë? 41.

A abstenon ndokush? Tre abstenime.

Kalon amendamenti i Qeverisë.

**Amendamenti 12.**                      Deputeti Gani Koci, pa përkrahje nga Komisioni për buxhet  
Dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për? 15 për.

Kush është kundër amendamentit? 37.

A abstenon ndokush? 4.

Nuk miratohet amendamenti.

**Amendamenti 13.**                      Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe eko-  
nomi.

Kush është për? Falemnderit.

Kush është kundër?

A abstenon ndokush? Një.

Urdhëroni, zoti Hilmo.

### **HILMO KANDIQ:**

Hvala gospodine predsedavajući. Ja ću biti kratak. U pitanju je da se ne bi dešavale ponovo greške, sigurno nijesu namjerne. U pitanju i prijete, kada smo glasali za amandman 6, ja ovde na bosanskome taj amandman nijesam ima bio a glasao sam. I sada kada je predsedavajući kazo isto da, 12 amandman, da nije podržan gospodin Koci od strane

Budžetske komisije, ovdje kod mene isto stoji da je podržan. Znači dolazimo čisto u jednoj situaciji stvarno da ne znamo da li da podržimo ili da ne podržimo. Samo toliko. Hvala.

**KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Besoj se administrata do ta ketë parasysh këtë.  
Amendamenti 13 miratohet me shumicë të votave.

**Amendamenti 14.** Deputeti Gani Koci, pa përkrahje nga Komisioni për buxhet  
Dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për amendamentin?

Të drejtë kanë sponsoruesi i amendamentit dhe kundërshtuesi, nga një fjalë ta thonë. A  
dëshiron komisioni të thotë diçka. Udhëroni.

**HAKI SHATRI:**

Hajredini sigurisht e din që nuk është ashtu, por po mahitet. Fjala këtu është për një ligj  
vjetor – ligji për përvetësimet buxhetore është ligj vjetor dhe nxirret çdo vit. Në qoftë se  
thomë rregullore atëherë e nxjerr UNMIK-u e jo Kuvendi. Ju falemnderit. Është fjala për  
ligjin për përvetësimet për vitin 2003. Ligji për përvetësimet për vitin 2004 e me radhë,  
çdo vit nxirret dhe vlenë vetëm për atë vit buxhetor. E tash pse është shkurtuar – ligj  
vjetor, ajo është tjetër gjë.

**KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Sponsoruesi Gani Koci jep sqarime. Udhëroni.

**GANI KOCI:**

Unë konsideroj se nuk është fjala për ligjin që nxirret nga Kuvendi por është rregullorja  
që nxjerrin njësitë buxhetore dhe është fjalë për njësitë buxhetore e jo për ministrinë e  
financave dhe për Qeverinë në përgjithësi ose për Kuvendin që nxjerr. Prandaj, njësitë  
buxhetore nxjerrin rregullore vjetore ose bëjnë raporte vjetore të shfrytëzimit ose  
përvetësimet të buxheteve që kanë. Këtu është fjala për njësitë, nuk është fjala për ligjin  
në përgjithësi për përvetësimet buxhetore. Ne po nxjerrim një ligj mbi përvetësimet  
buxhetore dhe ky ligj vitin e ardhshëm a do të ndryshojë dhe ta nxjerrim një ligj tjetër.



### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Falemnderit zoti Gani. Ndoshta ka nevojë dikush prej ekspertëve, zonja Nekibe apo zoti Hajredin Kuqi me dhënë ndonjë sqarim për këtë që të pozicionohen deputetët. Urdhëro Hajredin.

### **HAJREDIN KUQI:**

Unë mendoj se jo vetëm këtë nen por edhe amendamentet tjera që bëme, se s'kam dëshirë me dalë kujdestar i përmirësimeve, unë mund të dal për juridike, dikush gjuhësore e kështu me radhë. Edhe neni që u përmend paraprak, po them janë disa absurde juridike. Thuhet – “sipas rregullave dhe ligjeve që janë në Kosovë dhe në vendet tjera”. Gjyqtarët e mirë gjykojnë sipas atyre që janë në Kosovë. Për vendet tjera, në Zimbabve, qysh është nuk e din kërkush. Tjetra, këtu Komisioni për buxhet s'e ka pasur parasysh trajtimin juridik, por më shumë duket, edhe amendamentet, kanë trajtim politik. Politikisht mund të mendojmë secili nga ne por harmonizimin juridik duhet ta bëjë Sekretaria e Kuvendit dhe në rastin konkret nuk mund të thirremi me ligj që është ligj vjetor. Unë mendoj se është absurd ky Kuvend me çua dorën se është ligj vjetor, me përjashtim që mund të caktohet për afatet e caktuara. E kundërta, me dispozitë po e zëmë thuhet, ky ligj hyn me datën në këtë datë edhe vleën deri me këtë datë. Tjetra, Kuvendi ka të drejtë që tha Hakiu, që të nxjerrë rregullore, të nxjerrë rezoluta, të nxjerrë deklarata dhe rregulloret të mos kuptohen se janë vetëm rregullore të UNMIK-ut. Rregulloret e UNMIK-ut kanë fuqinë e ligjit. Me fjalë tjera, në përpara e kemi quajtur dekretligj ose forma tjera. Po ky Kuvend ka të drejtë edhe në rregullore edhe në raporte, edhe deklarata. Mos t'i ikim asaj që rregullore çka është apostrofohet edhe UNMIK-u. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit. Atëherë vë në votim amendamentin 14 të deputetit Gani Koci.  
Kush është për amendamentin? 28 për.  
Kushë është kundër amendamentit? 30.  
A abstenon kush nga votimi? Katër.

Nuk miratohet amendamenti.

Sqarimet, ju lutem, u dhanë. U thirr sponsoruesi i amendamentit, u thirr kundërshtuesi, u thirrën dy ekspertët dhe thanë se duhet... dhe votuam kështu. Procedojmë më tutje.

**Amendamenti 15.** Deputeti Gani Koci, i përkrahur nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për amendamentin? Falemnderit.  
Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.  
Miratohet amendamenti 15.

**Amendamenti 16** Deputeti Gani Koci, pa përkrahje nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kemi të bëjmë me të njëjtin rast.  
Kush është për amendamentin? 17 për.  
A ka kush kundër? 36.  
A abstenon ndokush? 5.  
Prandaj, nuk miratohet amendamenti.

**Amendamenti 17.** Deputeti Gani Koci, pa përkrahje nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për këtë amendament? 20 për.  
Kush është kundër amendamentit? 36.  
A abstenon ndokush? 6 abstenime.  
Nuk miratohet amendamenti.

**Amendamenti 18.** Deputeti Gani Koci, pa përkrahje nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për amendamentin? Për janë 19.  
Kush është kundër? 35.  
A abstenon kush? 6 abstenime.  
Nuk miratohet amendamenti.

**Amendamenti 19.** Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për? Falemnderit.  
Kush është kundër? Askush.  
A abstenon ndokush? Askush.  
Miratohet amendamenti.

**Amendamenti 20.** Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Udhëro, dil në foltore, nëse don ta kundërshtojsh. Hajredin Kuqi e ka fjalën.

### **HAJREDIN KUQI:**

Unë mendoj se paksa në shaka kaloi e gjithë kjo, por seriozisht jam duke menduar se a po e dijmë për çka po çojmë dorën shpeshherë. Unë për veti nuk po e di. Mendojs e është shumë serioze, mund të qeshet ndokush, por marr vesh mos u bëni merak. Po është shumë serioze me ardhë me dhënë, që tha dikush larg, por unë e mësoj dikë. Personalisht mund ta them, një – raportet që na vijnë nga sekretariatet, nga Sekretaria e Kuvendit, nga ana juridike, duhet të shqyrtohen në atë mënyrë që raportet tremujore, çerekviti, lojë fjalësh, ose e drejta në Kosovë dhe e drejta kudo në botë, ose këto tjera, mendoj se nuk janë çështje që ne duhet të votojmë ose të mos votojmë, por janë çështje për të cilat paraprakisht duhet të rregullohen teknikisht; ndërsa ne të mos humbim kohë pa lidhje. Ju falemnderit.

### **KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Lidhur me këtë, a dëshiron Komisioni fjalën? Atëherë, kush është për amendamentin kështu siç është. 41 janë për.

Kush është kundër? 11 kundër.

A abstenon kush nga votimi? 3 abstenojnë.

Miratohet amendamenti.

**Amendamenti 21.** Deputeti Gani Koci, i përkrahur nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për? Falemnderit.

Kush është kundër? Një.

Kush abstenon? Asnjë.

Miratohet amendamenti.

**Amendamenti 22.** Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Asnjë.

A abstenon kush? Askush.

Miratohet amendamenti.

**Amendamenti 23.** Komisioni për buxhet dhe Komisionin për financa dhe ekonomi.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Asnjë.

A abstenon kush? Një.  
Miratohet amendamenti.

**Amendamenti 24.** Deputeti Gani Koci, pa përkrahjen e Komisionit për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për? 20 për.  
Kush është kundër? 36.  
A abstenon kush? Dy.  
Nuk miratohet amendamenti.

**Amendamenti 25.** Deputeti Gani Koci, i përkrahur nga Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për? Falemnderit.  
Kush është kundër? Askush.  
A abstenon kush? Askush.

**Amendamenti 26.** Deputeti Gani Koci, i përkrahur nga Komisionet.

Kush është për? Falemnderit.  
Kush është kundër? Asnjë.  
Abstenim? Asnjë.  
Miratohet amendamenti 26.

**Amendamenti 27.** Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi.

Kush është për? Ju falemnderit.  
Kush është kundër? Askush.  
Kush abstenon? Askush.  
Miratohet amendamenti 27.

Haki, ju i miratuat edhe këto amendamentet e Qeverisë? Atëherë, ju lutem të kemi durim edhe dy faqe janë, s'janë shumë. Kemi amendamentet e Qeverisë para veti. Nuk shkruan amendamente, por janë me numra 1, 2, 3, 4, propozimamendamente të cilat tri komisionet i kanë miratuar dhe përkrahur. A janë të një natyre Haki - dhe a mund të shkojnë në mënyrë paketore? Atëher, me sygjërimin e Komisionit, po i vë në votim në paketë, sepse këto amendamente qenkan të një natyre dhe sipas rregullores kemi të drejtë t'i votojmë të gjitha përnjëherë.



Kush është për propozimamendamentet e Qeverisë? Ju falemnderit.  
Kush është kundër? Një.  
A abstenon kush? Dy.  
Miratohen amendamentet e Qeverisë.

Më lejoni që, sipas praktikës së deritashme në Kuvend, ta vë në votim Projektligjin për financat publike dhe përgjegjësitë në tërësi me amendamentet e miratuara.

Kush është për Projektligjin? Për janë 63 deputetë.  
A ka kush kundër? Askush kundër.  
A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

**(Duartrokitje)**

---

<b>Votimi – Glasanje – Voted:</b>	
<b>Për – Za – For.....</b>	<b>63</b>
<b>Kundër – Protiv – Against.....</b>	<b>00</b>
<b>Abstenuan - Uzdržanih – Abstened.....</b>	<b>00</b>

---

Ju falemnderit zotri deputetë.

Kemi edhe pikën e fundit të rendit të ditës që ka mbetur nga seanca e kaluar dhe është shumë e shkurtër – Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë për emërimin e një anëtari në Komisionin për peticione dhe kërkesa publike nga radhët e AAK. Do të thotë është një punë që nuk është kryer më herët. AAK ka emëruar deputetin Mahmut Bakalli në Komisionin për peticione dhe kërkesa publike. Duhet një votë formale e Kuendit.

Kush është për këtë propozim? Ju falemnderit.

Tani t'i kthehemi pikës së parë dhe thërras të ngarkuarin e grupit që ka punuar dhe ta lexojë deklaratën. E ka fjalën zoti Sabri Hamiti.

**SABRI HAMITI:**

## KUVENDI I KOSOVËS

Më 23 janar 2003

Kuvendi i Kosovës, në seancën e vet të datës 23 janar 2003, shqyrtoi gjendjen e sigurisë në Kosovë duke konsideruar si temë të rëndësisë së veçantë dhe të shtruar për diskutim në kohën e duhur.

Pas referimeve të përgjegjësve të UNMIK-ut Zhan Kadi, përgjegjës i Shtyllës së Parë të UNMIK-ut dhe Komisarit të Policisë Shtefan Feller, lidhur me gjendjen e sigurisë në Kosovë, deputetët e Kuvendit të Kosovës, shtruan pyetje e komente rreth referimeve të tyre dhe morën përgjegje dhe komentime të tyre. Përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe deputetët dënuan njëzëri dhe fuqishëm sulmin e mbrëmshëm në Stacionin e Policisë në Pejë.

Në seancë plenare, 3 udhëheqësit e grupeve parlamentare: Sabri Hamiti, LDK, Fatmir Limaj, PDK dhe Bujar Dugolli AAK, diskutuan çështjen e shtruar duke shfaqur pikëpamjet, argumentet dhe rekomandimet e veta lidhur me sigurinë në Kosovë dhe udhët e përmirësimit të saj.

Në diskutimet, ku morën pjesë 39 deputetë të Kuvendit të Kosovës, çështja u shtrua nga pikëshikime dhe argumentime të shumanshme. Në bazë të trajtimeve që kishte çështja e sigurisë në Kosovë, në këtë seancë, Kuvendi i Kosovës nxjerr këto:

### PËRFUNDIME E REKOMANDIME

1. Kuvendi i Kosovës është fuqimisht kundër dhunës, çfarëdo krimi dhe krimi të organizuar në Kosovë dhe mbështet fuqimisht luftën e përgjegjësve institucional kundër krimit dhe krijimin e sigurisë në Kosovë për të gjithë qytearët e saj;
2. Kuvendi i Kosovës është i përcaktuar që të bashkëpunojë me KFOR-in dhe UNMIK-un për çështjet e sigurisë dhe për zhvillimet e tjera në Kosovë;

3. Kuvendi i Kosovës kërkon që së paku një herë në muaj të jetë i informuar nga institucionet përgjegjëse për gjendjen e sigurisë në Kosovë;
4. Kuvendi i Kosovës konsideron se zgjidhja e statusit politik të Kosovës, sipas vullnetit të qytetarëve, krijon siguri në vend dhe në rajon;
5. Kuvendi kërkon dhe sygjeron që institucionet vendëse të marrin sa më shumë kompetenca dhe përgjegjësi rreth problemeve të sigurisë dhe të kenë një bashkëpunim më të madh me institucionet ndërkombëtare;
6. Kuvendi i Kosovës kërkon që të krijohen dhe strukturohen institucionet e rendit, mbrojtjes, drejtësisë dhe të përfaqësimit të jashtëm nga ana e institucioneve të Kosovës dhe të kenë kontroll civil;
7. Kuvendi i Kosovës i thërret të gjithë qytetarët që të denoncojnë krimin dhe të ndihmojnë në parandalimin dhe zbulimin e tij nëpërmjet dëshmimeve duke konsideruar këtë si detyrë qytetare dhe si domosdo jetësore individuale;
8. Kuvendi i Kosovës konsideron se ka edhe implikime të jashtme për prishjen e sigurisë në Kosovë me qëllim të pengimit të zhvillimit demokratik të saj;
9. Kuvendi i Kosovës i fton mediat e shkruara dhe elektronike që të trajtojnë problemet e sigurisë në Kosovë me profesionalizëm duke iu përmbajtur të dhënave, duke iu ikur gjuhës së egër të urrejtjes, në mënyrë që të ndihmojnë për sqarimin e situatave dhe të ndihmojnë në krijimin e opinionit pozitiv në Kosovë.

**KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:**

Ju falemnderit zoti Hamiti. Ftoj deputetët e Kuvendit që me një votë formale të përkrahin rekomandimet që ka hartuar grupi.

Kush është për? Ju falemnderit.

Më lejoni të përbyll seancën. Ju falemnderit dhe mirëupafshim në seancën e radhës.

**Seanca përfundoi në orën 17.10.**

